Komuna Suharekë	03.07.2018	Drejtorja për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër	
Komuna Suharekë	03.07.2018	Drejtorja për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë	
Komuna Suharekë	03.07.2018	Drejtorja për Inspektion	
Komuna Suharekë	24.07.2018	Takim me Kryetarin e Komunës dhe Ekipin Komunal për Planifikim	Diskutim rreth punës që kemi kryer deri tani dhe fazat të cilat do të pasojnë
Salla e Asamblesë Komunale	23.08.2018	Banorët e Komunës	Diskutim Publik për VSM
Komuna Suharekë	24.09.2018	Ekipi Komunal për Planifikim	Drafti i PZhK-së, kërkesë për kontrollim dhe dorëzim të raporteve
Komuna Suharekë	24.10.2018	Ekipi Komunal për Planifikim, INSI	Prezantim i Draftit PZhK-së
Komuna Suharekë	06.11.2018	Ekipi Komunal për Planifikim	Inkorporimi i propozim ndryshimeve nga prezantimi i draftit
Komuna Suharekë	05.12.2018	Ekipi Komunal për Planifikim, Kryetari	Zgjerim, plotësim i Ekipit Komunal për Planifikim
Prishtinë	24.01.2019	Perfaqësues nga Ekipi Komunal, INSI	Koordinim i aktiviteteve për plotësimet në PZhK
Komuna Suharekë	05-06.02.2019	Ekipi Komunal për Planifikim, Drejtorite	Takime me Drejtorite Komunale për diskutim



			ne fusha tematike
Komuna Suharekë	13.03.2019	Ekipi Komunal për Planifikim, INSI	Diskutim rreth punimit te hartave planifikuese
Komuna Suharekë	25.03.2019	Ekipi Komunal për Planifikim	Ndryshim plotësimi i draftit
Komuna Suharekë	11.05.2019	Ekipi Komunal për Planifikim	Verifikimi i te dhenave tekstuale dhe grafike
Prishtinë	18.06.2019	Ekipi Komunal për Planifikim, INSI	Takim
Solid, Suharekë	25.06.2019	Përfaqësues të Ministrive të Qeverisë së Kosovës Këshilli i ekspertëve të Planifikimit hapësinor në nivel Komunal; Përfaqësues të Asamblesë Komunale Përfaqësuesit e vendbanimeve; Drejtorët e Drejtorive Komunale; Grupi Komunal për Planifikim; Kompania Konsulente “Insi; Përfaqësues të ndërmarr. Publike; Përfaqësues të Partive Politike; Përfaqësues të Qendrës së Biznesit; LMT.	Punëtori gjithëpërfshirëse për: -Kornizën e Zhvillimit Hapësinor; -Prioritetet Strategjike; -Planin e Veprimit.
Komuna Suharekë	10.07.2019	Ekipi Komunal për Planifikim	Pergatitja e Draft dokumentit për Kërkesë MPMPH për marrjen e pëlqimit për Hapjen e Diskutimit Publik
Komuna Suharekë	16.09.2019	Ekipi Komunal për Planifikim	Punimi ne dokument pas rekomandimeve nga MPMPH
Prishtinë	11.02.2020	Perfaqesues nga Ekipi Komunal, dhe përfaqësues te MIA	Diskutim per rreth rekomandimit ndryshim plotësime te Propozimit Planit Zhvillimor Komunal
Komuna Suharekë	26.02.2020	Ekipi Komunal për Planifikim,	Diskutim rreth punimit te hartave planifikuese
Komuna Suharekë	4-9.03.2020	Koordinatorët e Ekipi Komunal për Planifikim, & Lista e Grupit te kontribuesve komunal të përfshirë në planifikim DSHPM	Punetori rreth punimit te hartave dhe plotësimeve tekstuale
Komuna Suharekë	01.06.2019	Ekipi Komunal për Planifikim, Kryetari, Bordi i Drejtorëve,	Diskutim per ndryshim plotësime te Draftit për dorëzim në MPMPH.
Komuna Suharekë	03.06.2019	Ekipi Komunal për Planifikim, Kryetari, Bordi i Drejtorëve,	Plotësime te Draftit për dorëzim në MPMPH.



1.5. Raporti i Shqyrtimit Publik

Të dhënat e marra nga qytetarët dhe mënyra e trajtimit të tyre gjatë procesit të planifikimit.

1.5.1. Sfidat përkatëse

Suhareka ballafaqohet me shumë sfida në menaxhimin e territorit dhe burimeve të saj. Këtu hyjnë zhvillimi ekonomik, papunësia, mungesa e prodhimit bujqësor si dhe mungesa jo e mjaftueshme e investimeve në infrastrukturën përcjellëse në zonat e përcaktuara me Planin Zhvillimor paraparak.

Sa i përket përgatitjes së këtij Plani Zhvillimor Komunal janë identifikuar shumë sfida, siç janë:

- Mungesa e të dhënave dhe sistemimi i tyre në rrjet të përbashkët teknologjik;
- Sigurimi i të dhënave sipas kërkesave të reja ligjore nga disa institucione të nivelit qendror;
- Krijimi i hartave sipas kërkesave të reja ligjore në GIS;
- Mungesa e Hartës Zonale të Kosovës;
- Përdorimi i pamjaftueshëm dhe joracional i burimeve natyrore;
- Tjetërsimi i tokës bujqësore për qëllime ndërtimi dhe mungesa e rrjetit të ujitjes;
- Zonat e rrezikuara nga vërshimet;
- Zgjerimi i pakontrolluar dhe i paplanifikuar urban;
- Migrimi i brendshëm ndërkomunal nga viset malore në pjesën urbane;
- Mungesa e investimeve në pjesët e dalluara natyrore me potencial zhvillimi turistik;
- Numri i lartë banorëve jetojnë jashtë vendit;
- Mungesa e prodhimit të organizuar bujqësor në Agrozona;
- Mungesa e punëtorëve të kualifikuar.
- Etj.

1.5.2. Mundësitë për zhvillim

Komuna e Suharekës ka një mjedis shumë të pastër. Kjo përparësi duhet të paraprijë mundësive të zhvillimeve që nuk ndotin mjedisin rrethues. Ky Plan Zhvillimor Komunal ka paraparë zhvillimin e projekteve madhore:

1. Në prodhimin e energjisë përmes burimeve të ripërtëritshme, si:

- Ndërtimi i liqenit akumulues dhe hidrocentralit në Dragaqinë;
- Ndërtimi i parkut të energjisë së ripërtëritshme:
 - Turbina e erës në Duhël dhe Budakovë;
 - Panela solar;
 - Biomasa;

2. Në zhvillimin e turizmit malor në:

- Delloc;
- Gradancë;
- Kreun e Ahishtës;
- Javor – Luzhnicë

3. Në zhvillimin dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore, si:

- Kultura Bujqësore si: frutat, perimet, bimë mjekësore, erëzat, etj.
- Blegtoaria si: bletaria, shpezët, bagëtia, etj.
- Si dhe prodhimet bujqësore si: pijet alkoolike dhe jo-alkoolike, produktet e blegtorisë, produktet e bletarisë, etj.



1.5.3. Qëllimet dhe objektivat e planifikimit të zhvillimit

Gjatë hartimit të këtij Plani është bërë profili dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese, është vlerësuar zbatimi i PZhK-së 2008-2018, dhe në bazë të tyre janë identifikuar qëllimet dhe objektivat për fushat tematike si në vazhdim:

1.5.4. Zhvillimi ekonomik

Bazuar në gjendjen ekzistuese në identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të zhvillimit ekonomik, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

Qëllimet dhe objektivat zhvillimore për ekonominë lokale

QËLLIMI 1: Agrikulturë me prodhimtari primare dhe përpunim të produkteve kualitative bujqësore.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Mbrojtja e 100% të tokës bujqësore.
2. Nxitja dhe përkrahja për riaktivizimin e tokave ekzistuese bujqësore për 50% deri në vitin 2026;
3. Nxitja dhe përkrahja e bio-agrikulturës (bujqësia ekologjike), në përvetësimin e njohurive përkatëse deri në vitin 2022;
4. Mbulueshmëria e 50% të sipërfaqes të së destinuar të Agro-Zonës, për objekte industriale për përpunimin e prodhimeve bujqësore deri në vitin 2026;
5. Ndërtimi i rrjetit të sistemit të ujitjes për 40% të sipërfaqeve të tokave bujqësore deri në 2022;
6. Marketing aktiv rajonal dhe ndërkombëtar për prodhimet vendore bujqësore.

QËLLIMI 2: Turizëm dhe aktiviteteve rekreative - sportive në natyrë

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Krijimi i një bordi lokal të turizmit dhe pikave informuese turistike deri në vitin 2020.
2. Krijimi i hapësirave adekuate rekreative - sportive për turizëm deri në vitin 2026.
3. Zhvillimi dhe zbatimi i veprimeve për përmirësimin e peizazhit të qytetit dhe ruajtjen e peizazheve natyrore deri në vitin 2024.

QËLLIMI 3 Suhareka vend potencial në Kosovë për energji të ripërtëritshme

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore të erës për prodhim të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2023.
2. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore solare për prodhim të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2021.
3. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore ujore për prodhim të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2026.
4. Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme nga mbetjet e biomasës deri në vitin 2026.

1.5.5. Infrastruktura teknike

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës teknike, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:



Qëllimet dhe objektivat zhvillimore për infrastrukturë teknike

QËLLIMI 1: Furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm me ujë të pijes për të gjithë banorët e Komunës.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Ngritja e kapaciteteve të prodhimit të ujit të pijshëm në 800l/s dhe siguri i qëndrueshmërisë së sistemit deri në vitin 2026.
2. Eliminimi i humbjeve të ujit të pijshëm përmes ndërrimit dhe përmirësimit të rrjetit ekzistues, deri në vitin 2022.
3. Ndërtimi dhe ri-ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe drenazhimit në vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në rrjet deri në vitin 2024.

QËLLIMI 2: Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Përmirësimi i nënstacioneve furnizuese deri në vitin 2021.
2. Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të energjisë elektrike deri në vitin 2025;

QËLLIMI 3: Përkrahje në ofrimin e qëndrueshëm të të gjitha shërbimeve telekomunikuese

(TEL+DATA+VIDEO) për të gjithë qytetarët, bizneset, institucionet dhe ekonominë familjare

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Avancimi teknologjik i pajisjeve ekzistuese në përkrahje të shërbimeve telekomunikuese 4G dhe 5G LTE deri në vitin 2023;
2. Mbulueshmëria 100% me rrjet të ri optik kabllorë të avancuara FTTH (Fiber To The Home) në zonat e pambuluara në periudhën kohore trevjeçare deri në vitin 2023;

QËLLIMI 4: Ofrimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për të gjitha vendbanimet.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Zgjerimi i rrjetit për grumbullimin e mbeturinave për të gjitha vendbanimet deri në vitin 2024.
2. Krijimi i sistemit nëntokësor për hedhjen e mbeturinave deri në vitin 2027.

1.5.6. Transporti dhe transporti publik

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të transportit dhe transportit publik, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

Qëllimet dhe objektivat zhvillimore për transportin dhe transportin publik

QËLLIMI 1: Zhvillimi i një infrastrukture të integruar funksionale dhe shërbimeve të përshtatshme të transportit publik për të gjitha zonat.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Krijimi i infrastrukturës rrugore që ndërlidh vendbanimet deri në vitin 2024;
2. Zgjerimi i rrjetit të transportit të rregullt publik për të gjitha vendbanimet me mbi 750 banorë deri në vitin 2023;
3. Ndërtimi i rrugëve alternative që do të lirojnë trafikun në qytet deri në vitin 2022.

QËLLIMI 2: Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe i sigurisë publike në infrastrukturë të transportit **Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:**

1. Hartimi i Planit të Mobilitetit deri në vitin 2020.
2. Zbatimi i Planit të Veprimit të Planit të Mobilitetit deri në vitin 2024.



QËLLIMI 3: Promovimi i lëvizshmërisë rekreative.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Ndërlidhja e vendbanimeve rurale jug-lindore me qytetin përmes shtigjeve për çiklistë deri në 2024.
2. Ndërlidhja e vendbanimeve turistike malore përmes shtigjeve për çiklistë dhe kalërim deri në 2027.

1.5.7. Infrastruktura publike

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës publike, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

Qëllimet dhe objektivat zhvillimore për infrastrukturën publike

QËLLIMI 1: Krijimi i hapësirave të reja shëndetësore dhe shërbimeve sociale sa më afër banorëve

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Ndërtimi i AMF-ve për vendbanimet në +6000 banorë dhe i QMF-ve për vendbanimet me +10000 banorë deri në vitin 2026;
2. Përfundimi dhe funksionalizimi i shtëpisë së pleqve deri në vitin 2026;
3. Përmirësimi i kushteve të ofrimit të shërbimeve sociale deri në vitin 2022

QËLLIMI 2: Krijimi i infrastrukturës arsimore publike para-universitare

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Plotësimi i kriterëve hapësinore të MASHT deri në vitin 2025;
2. Ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve në lagjet urbane me mbi 2000 banorë deri në 2026.

QËLLIMI 3: Krijimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve.

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Vendorsja E-kioskave deri në vitin 2020.
2. Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe efikase përmes teknologjisë moderne të telekomunikimit në 2024.
3. Ndërtimi i Objektit të ri të Komunës deri në vitin 2023.

1.5.8. Infrastruktura sociale

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës sociale, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit sipas U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

Qëllimet dhe objektivat zhvillimore për infrastrukturën sociale

QËLLIMI 1: Sigurim i hapësirave për kulturë nëpër vendbanime sipas funksionit dhe hierarkisë

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Ndërtimi i një qendre të re multi-kulturore deri në vitin 2026.

QËLLIMI 2: Sigurimi i hapësirave për aktiviteteve sociale, sport dhe rekreacion sipas funksionit dhe hierarkisë

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Krijimi i fushave të reja rekreative sipas normave teknike deri në vitin 2024.



2. Ndryshimi i fushave ekzistuese sportive të institucioneve arsimore, për të u shfrytëzuar nga banorët e lagjeve, jashtë orarit mësimor deri në vitin 2024.
3. Ndërtimi i sheshit publik në qendër të qytetit deri në vitin 2021.

QËLLIMI 3: Sigurimi i hapësirave për aktiviteteve sociale, sport dhe rekreacion sipas funksionit dhe hierarkisë

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Plotësimi i normave hapësinore për varreza prej 1.50m² për banor për të gjitha vendbanimet deri në vitin 2024.

1.5.9. Mjedi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

Qëllimet dhe objektivat zhvillimore për mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

QËLLIMI 1: Parandalimi i ndotjes së mjedisit

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Ndarja e rrjetit të kanalizimit të ujërave fekal dhe atmosferik në të gjitha vendbanimet me mbi 1500 banorë dhe deri në vitin 2026.
2. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza deri në vitin 2026.
3. Përgatitja e studimit të fizibilitetit për sistemin e integruar të ngrohjes qendrore deri në vitin 2026.
4. Zvogëlimi i hapësirave të gurthyesve dhe kthimi i tyre në gjendjen e mëparshme.

QËLLIMI 2: Parandalimi i ndotjes së mjedisit nga Parqet Ekonomike (Agro-Zona dhe Zona Industriale)

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave dhe mbetjeve industriale në Agro-Zonë deri në vitin 2026.
2. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave dhe mbetjeve industriale në Zonë Industriale deri në 2023.
3. Mbjellja e drunjtëve shtatlartë gjethe mbajtëse përgjatë perimetrit të Agro-Zonës dhe Zonës Industriale 2020.

QËLLIMI 3: Mënjanimi i fatkeqësive natyrore

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur PZhK përcakton objektivat vijuese:

1. Në objektet e veçanta si dhe në objektet shumëkatëshe, duhet të punohen me arkitekturë a-sizmike;
2. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve;
3. Pastrimi i pyjeve nga mbetjet e druve, si masë parandaluese për rrezikun e zjarrit në pyje;
4. Ndërtimi i tarracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese;
5. Ndërtimi i argjinaturave dhe mbjellja e fidanëve pyjore përgjatë brigjeve të lumenjve deri në vitin 2022;



2. PROFILI KOMUNAL

2.1. Historia e zhvillimit

Lokaliteti i Suharekës daton nga parahistoria-koha e neolitit. Dëshmi për këtë janë gërmadhat e shumta që gjenden në lokalitete të ndryshme të komunës. Më karakteristike janë gërmadhat ende të pa hulumtuara në lokalitetin e quajtur Dybiqak. Lokaliteti i pasur arkeologjik është edhe vendi i quajtur Hisar. Gjatë luftërave të gjata kundër ilirëve, romakët shkatërruan shumë vendbanime ilire. Në këtë drejtim pësuan vendbanimet posaçërisht ato të fortifikuara, që ishin të njohura në atë kohë si dhe fortifikatat mbrojtëse të popullatës iliro-dardane siç është kështjella e Kastercit

Gjatë periudhës së Mesjetës, vendbanimi i Suharekës (Theranda) ka shërbyer si ndalesë për Karvanet tregtare pasi që është e njohur nga burime të ndryshme se në Suharekë janë kryqëzuar dy rrugë të rëndësishme tregtare, rruga Egnatia që lidhte Durrësin me Kostandinopojën dhe rruga Lisus-Nisus (Lezhë-Nish).

Në periudhën e re, për nga veprimtaria ushtarake, Suhareka është konsideruar, vend strategjik e njohur kjo nga Gryka e Carralevës si vend gjeostrategjik për mbrojtjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si Qendër Administrative e kohës dhe kryengritjeve të mëvonshme që quan deri në Pavarësinë e Shqipërisë.

Me vendimet e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Suhareka si lokalitet mbetet nën sundimin e Serbisë. Kjo periudhë shënon një faqe të re të historisë së trevës sonë ngase represioni serb ishte shumë i theksuar me qëllim të spastrimit etnik dhe sllavizimit të kësaj treve edhe me masakra të mëdha si rasti i Nishorit i cili në atë kohë numëronte rreth 60 shtëpi, ku u rrënua i tëri me topa dhe u ekzekutuan 42 burra dhe të rinj të këtij fshati.

Periudha nga viti 1913–1918, njihet si periudha më e vështirë e kësaj treve ngase përveç pasojave të Luftës së Parë botërore njihet edhe si periudha e zisë së bukës e cila u shkaktua edhe si pasojë e luftës edhe si pasojë e thatësisë e njohur si Koha e Bugarit.

Vitet 1919 -1939 represioni serb e aplikoi edhe një metodë të re e njohur si reforma agrare dhe kolonizimi i kësaj treve me kolonë serbo – malazez nga vise të ndryshme të mbretërisë serbo kroate sllovene duke shkaktuar edhe varfëri të skajshme të popullatës shqiptare e cila merrej kryesisht me bujqësi primitive dhe blegtori. Gjatë kësaj periudhe popullata shqiptare u orientua në kultivimin më të madh të vreshtarisë.

Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimit nga nazifashtët italian dhe gjerman nga 1941-1945 përveç pasojave që krijoj lufta e dytë botërore në historinë e trevës sonë është e njohur edhe si periudhë kur u hapën shkollat e para shqipe, e njohur si Koha e Italisë.

Në periudhën pas Luftës së dytë botërore shkak i moszhvillimit të kësaj treve ishte Reforma agrare e zbatuar nga pushteti komunist serbosllav, e cila la pasojë të rënda për banorët e Suharekës duke shkatërruar bazën ekonomike të familjeve të fuqishme shqiptare të cilësuar si kullak, sepse nuk përshtateshin me ideologjinë komuniste.

Kthesë në aspektin e zhvillimit ekonomik, arsimor e kulturor, Komuna e Suharekës filloi ta ndiejë pas viteve të 60^{ta} deri në fund të viteve 80^{ta} të shekullit të kaluar kur filluan të zhvillohen disa veprimtari zejtare dhe tregtare, hoteliere dhe ndërtimi i shkollave për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimin e obligueshëm dhe arsimin e mesëm. Nxitje më ta madhe të zhvillimit fillon me ndërtimin e fabrikës për përpunimin e gomës “Ballkan”, duke vazhduar edhe me ndërtimin e industrisë së pijeve alkoolike dhe joalkoolike, Bodrumi i Verës si edhe të fabrikave tjera. Kjo gjendje reflektoi në ngritje të zhvillimit të bujqësisë dhe



blegtorisë. I tërë ky zhvillim ekonomik, kulturor e arsimor u përmbys pas vitit 1989 e njohur si periudhë e riokupimit të Kosovës nga pushteti serbo sllav.

Lufta e fundit 1998 – 1999 nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me ndihmën e vendeve të Paktit Verioatlantik e përfundon sundimin e territoreve tona nga pushtuesi serbosllav duke hapur një dritare të historisë më të re Kosovës dhe me këtë të Suharekës. Dita e çlirimit të Suharekës është 13 Qershor 1999

Lufta 1998-1999 në komunën e Suharekës ka shkaktuar humbje të mëdha në njerëz dhe dëme të bazës ekonomike e materiale të familjes shqiptare si dhe dëmet në objektet industriale, të bizneseve dhe bujqësisë, dëmet në objektet shkollore dhe të shëndetësisë, trashëgimisë kulturore, objektet fetare, etj.. Nga gjithsej 11,855 shtëpi të evidentuara para luftës, gjatë luftës janë djegur 9,893 apo 83.45% e objekteve të banimit dhe të tjera, komuna ka pësuar një humbje të mëdha në njerëz duke përfshirë të gjitha grupmoshat dhe gjinitë pa dallim fëmijë, gra dhe pleq. Këto humbje reflektohen edhe në zhvillimin ekonomik, pasi që policia dhe ushtria serbe ka qenë e përqëndruar në shkatërrimin e klasës intelektuale dhe asaj ekonomike të aftë gjë që ka zvogëluar mundësitë reale të përparimit të shpejtë ekonomik të komunës së Suharekës, duke zbatuar planin e tokës së djegur.


2.2. Gjendja ekzistuese e komunës

2.2.1. Pozita gjeografike e Komunës së Suharekës

Komuna e Suharekës gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Shtërpçës.

Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 42°15' – Parku Nacional "Sharri" (jugu), 42°30' – Malet e Berishës dhe Javori (veriu). Gjatësia gjeografike lindore: 20°45' - komuna e Rahovecit (perëndim), 21°00' - Malet e Jezercit, Guri i Dellocit (lindje).

Harta 3. Pozita gjeografike e komunës së Suharekës





Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta dhe atë në veriperëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1048m, në lindje me malet e Jezercit 1677m (Kryet e Ahishtës) dhe në jug-lindje me malet e Sharrit 2092m (Dera e Pashës) derisa në perëndim shtrihet rrafshina (ultësira) e Prizrenit.

Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455m. Sipërfaqja e kësaj komune është 361.78km² (që mbulon 3.3 % të territorit të Kosovës. Nga sipërfaqja e komunës (prej 36099ha) 15,074ha ose 41.7% janë të mbuluara me pyje, 19,373ha ose 53.7% janë tokë bujqësore dhe 1652ha ose 4.6% sipërfaqe tjetër.

Tabela 1. Gjatësia (km) e vijës kufitare me komunat fqinje

Perimetri i Suharekës	Prizren	Mamushë	Rahovec	Malishevë	Lipjan	Shtime	Ferizaj	Shtërpce
105.24	19.36	5.66	6.49	25.38	5.70	25.60	8.48	14.23

2.2.2. Demografia

Komunën e Suharekës, si njësi territoriale, e përbëjnë: qyteti i Suharekës, lagjet urbane dhe fshatrat. Territori i Komunës përfshin² Suharekën dhe këto 42 vendbanime: Bllacë, Budakovë, Bukosh, Breshanc, Delloc, Dobërdelan, Dragaqinë, Dubravë, Duhël, Dvoran, Greikoc, Greçec, Gelancë, Gjinoc, Javor, Kastërc, Krushicë e Epërme, Krushicë e Poshtme, Leshan, Luzhnicë, Maqitevë, Mohlan, Mushtisht, Neprebisht, Nishor, Papaz, Peqan, Popolan, Qadrak, Reshtan, Reqan, Savrovë, Samadrexhë, Sallagrazhde, Semetisht, Sllapuzhan, Sopijë, Stravuçinë, Studençan, Tërrnje, Vërshëc dhe Vraniç.

Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës³ të vitit 2017, Komuna e Suharekës ka 41 vendbanime⁴, ku jetojnë 88,126⁵, banorë në një sipërfaqe prej **361.78** km² me dendësi banimi prej 165 banorë/km².

Tabela 2. Karakteristikat hapësinore të Komunës

Sipërfaqja km ²	Numri i banorëve rezident 2011	Numri i banorëve jo-rezident 2011	Dendësia (banorë/km ²)	Lartësia mesatare mbidetare
361.78	59,722	28,418	165	455 m – 1760 m

Të dhënat bazohen në regjistrimin e fundit zyrtar të vitit 2011, i cili rezultoi se në Komunë jetojnë gjithsejtë 59,722 banorë dhe 9145 ekonomi familjare.⁶

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, vërehet një përqendrim i lartë prej 49,300 banorë në zonat rurale, ndërsa në zonë urbane banojnë 10,422 banorë. Bazuar në të dhënat e Regjistrimit civil komunal, numri i popullsisë në fund të vitit 2018 në Komunën e Suharekës është 65.350 banorë resident.

Krahasimi i karakteristikave demografike për ekonominë familjare⁷ të nivelit republikan sipas të të dhënave nga ASK, dhjetor 2013 ndërkaq statistika për të dhënat komunale paraqiten sipas statistikave të ASK të vitit 2011 dhe paraqitet në tabelën vijuese.

² Neni 7 i Statutit të komunës së Suharekës, 01-Nr-8336 Dt. 11.11.2008

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit, Prishtinë, 2013

⁴ Vendbanimi Breshanc shtrihet brenda ZK Nishor, poashtu edhe vendbanimi Dragaqinë shtrihet brenda ZK Duhël, kështu që të në të dhënat statistikore të ASK-së nuk figurojnë këto dy vendbanime, respektivisht brenda Nishorit përfshihen të dhënat edhe për Breshancë si dhe brenda Duhles të dhënat edhe për Dragaqinë.

⁵ ASK, Regjistrimi i popullsisë 2011

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017, Prishtinë, 2017


⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2013, Prishtinë, 2017



Tabela 3. Krahاسimi i karakteristikave demografike ne nivel nacional

	Ekonomi Familjare		
	Zonë urbane	Zonë rurale	Gjithsejtë
Suhareka (2011)	1,803	7,342	9,145
Numri i përgjithshëm nacional (2013)	175,942	236,942	412,884

Paraqitja grafike e karakteristikave demografike per ekonomitë familjare të komunës së Suharekës në raport me nivelin republikan sipas të dhënave nga tabela 3, shihet si në diagramin 1.




Grafika 1. Krahاسimi i Numrit të Ekonomive Familjare për Zonen Urbane dhe Rurale

Të dhënat statistikore të karakteristikave demografike (ASK, 2011) sipas regjistrimit të ekonomive familjare numrit të banorëve shihen si ne paraqitej tabelare 4.

Tabela 4 Karakteristikat demografike të Komunë (ASK, 2011)


	Zonë rurale		
	Zonë urbane	Zonë rurale	Gjithsejtë
Ekonomitë familjare	1,803	7,342	9,145
Numri i banorëve	10,422	49,300	59,722
Femra	5,268	24,976	30,244
Meshkuj	5,154	24,324	29,478



Grafika 2. Përqindja e banorëve sipas zonave urbane dhe rurale



Në tetëvjeqarin e fundit kemi një ndryshim të dukshëm të ngritjes së ekonomive familjare sa i përket zonave të ndërtimit, kështu tetë vitet e fundit kemi ngritje të madhe të shifrave në ndërtimin e ekonomive familjare në zonat urbane afërsisht 150 %, shikuar të dhënat nga tabela 5.



Grafika 3. Përqindja e banorëve sipas zonave urbane dhe rurale

Në tabelën 5 është paraqit trendi i ngritjes së ekonomive familjare në zonat urbane dhe në ato rurale gjat 8 viteve të fundit, ku vëreht se në zonat urbane kemi ngritje rreth 160% ndërkah në zonat rurale trendi i ngritjes së ekonomive familjare është 33%.

Tabela 5. Krahassimi i ngritjes së Ekonomive Familjare sipas zonave rurale dhe urbane ne komunë të Suharekes

	Ekonomi Familjare		
	Zonë urbane	Zonë rurale	Gjithsejtë
ASK (2011)	1,803	7,342	9,145
DBFE (2018)	4,693	9,767	14,460

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, vërehet një dallim i vogël gjinor ku 30,244 banorë janë të gjinisë femërore me 48.57%, ndërsa 29,478 banorë janë meshkuj.

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, grupmosha me më së shumti banorë është ajo e 20-64 vjeç me 31,743 banorë, e përcjellë nga grupmosha 5-14 vjeç me 12,211 banorë, grupmosha 15-19 vjeç me 6,466 banorë dhe grupmosha 0-4 vjeç me 5,198 banorë.

Tabela 6. Numri dhe përqindja e banorëve sipas grupmoshave

	0 - 4 vjeç	5 - 14 vjeç	15 - 19 vjeç	20 - 64 vjeç	≥ 65 vjeç
Nr. i banorëve	5,198	12,211	6,466	31,743	4,104
% e banorëve	8.70%	20.45%	10.83%	53.15%	6.87%

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dominon komuniteti shqiptar me gjithsejtë 98.92% banorë, komuniteti ashkali me 0.83% banorë dhe ai rom me 0.07% banorë.

Tabela 7. Numri dhe përqindja e banorëve sipas komuniteteve

	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Tjerë	N.J.N.D.
Nr. Banorëve	59,076	2	4	15	41	493	5	0	15	49
% e banorëve	98.92%	0.005%	0.01%	0.03%	0.07%	0.83%	0.01%	0.00%	0.03%	0.08%

Në Komunën e Suharekës dominon religjioni islam me gjithsej 98.33% besimtarë, komuniteti i besimit katolikë me 0.59% dhe religjione tjera me 0.06% besimtarë.

Tabela 8. Popullsia sipas përkatësisë së religjionit

	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Pa religjion	Pa përgjigje	Nuk janë në dispozicion
Nr. i banorëve	58,722	8	355	35	53	467	82
% e banorëve	98.33%	0.01%	0.59%	0.06%	0.09%	0.78%	0.14%



Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, vërehet një përqendrim i lartë i ekonomive familjare në zonë rurale rreth 80.82%, ndërsa në zonë urbane rreth 19.72%.

Tabela 9. Numri dhe përqindja e ekonomive familjare dhe anëtarëve sipas zonave urbane dhe rurale


	Ekonomi familjare		Banor	
	Numri	%	Numri	%
Zonë urbane	1,803	19.72%	10,422	17.45%
Zonë rurale	7,342	80.28%	49,300	82.55%

Sa i përket numrit të anëtarëve për ekonomi familjare, me 18.18% dominon numri i ekonomive familjare me 5 anëtarë, me 16.77% 6 anëtarë dhe me 14.94% mbi 10 anëtarë.

Tabela 10. Numri dhe përqindja e ekonomive familjare sipas numrit të anëtarëve

Anëtarë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10>
Nr. i ekonomive familjare	152	426	588	1, 203	1, 663	1, 534	1, 151	649	413	1, 366
% e ekonomive familjare	1.66%	4.66%	6.43%	13.15%	18.18%	16.77%	12.59%	7.10%	4.52%	14.94%

Sa i përket numrit mesatar të anëtarëve për ekonomi familjare, në zonat rurale mesatarja është 6.71 anëtarë për ekonomi familjare, ndërsa në zonën urbane është 5.78.



Grafika 4. Numri mesatar i anëtarëve për ekonomi familjare sipas zonave urbane dhe rurale

2.2.2.1. Migrimet Demografike

Derisa popullsia nga Prishtina, Gjakova, Mitrovica, Gjilani, Prizreni e Peja kryesisht emigruan para vitit 2000, popullsia nga Malisheva dhe Suhareka vazhdojnë të kenë emigrim më të lartë sidomos pas vitit 2000.

Bilanc pozitiv të migrimit ndërkombëtar kishin vetëm dy komuna: Juniku me 10.3% dhe Ranillugu me 2.8% përderisa Hani i Elezit kishte bilanc negativ të migrimit prej vetëm -0.02%.⁸

Popullsia e Suharekës kryeson me bilancin më të lartë negativ të migrimit me 40.2% në 1000 banorë pastaj Klina me 29.1%, Mitrovica me 28.3% si dhe Gjakova me 25.4%.⁹

Tabela 11. Komunat me bilancin më të lartë negativ të migrimit

Suharekë	Klinë	Mitrovicë	Gjakovë	Vushtrri	Viti	Malishevë	Istog	Skenderaj	Obiliq	Rahovec
-40.2	-29.1	-28.3	-25.5	-22.2	-21.9	-21.4	-21.2	-19.1	-15.9	-15.7

Bazuar në të dhënat e ASK të vitit 2014, jashtë vendit jetojnë gjithsej 27,905 banorë të Komunës së Suharekës, që paraqet një përqindje të lartë prej 46.72%, prej të cilëve 12,426 banorë janë të gjinisë femërore dhe 15,479 banorë janë të gjinisë mashkullore.

Sa i përket vendeve ku kanë emigruar banorët e Komunës së Suharekës, 8427 banorë jetojnë në Gjermani, 7703 banorë jetojnë në Zvicër, 6378 banorë jetojnë në Itali dhe 1216 banorë jetojnë në Austri.

⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Migrimi Kosovar, Prishtinë, 2014

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Migrimi Kosovar, Prishtinë, 2014



Tabela 12. Numri i banorëve sipas shteteve në të cilat emigruan

Gjermani	Zvicër	Itali	Austri	Suedi	Amerikë	Francë	Angli	Belgjikë	Slloveni	Te tjerë
8427	7703	6378	1216	450	122	407	141	161	1854	1046
30.20%	27.60%	22.86%	4.36%	1.61%	0.44%	1.46%	0.51%	0.58%	6.64%	3.75%

Numri më i madh i emigrantëve nga Komuna në vitin 2014 i takon grupmoshës 30-34 vjeç me 3014 banorë, vijuar nga grupmosha 10-14 vjeç me 2862 banorë dhe grupmosha 5 - 9 vjeç me 2836 banorë.

Tabela 13. Numri i emigrantëve sipas grupmoshave

0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+	N.J.N.D.
2831	2836	2862	2374	2465	2780	3014	2763	2289	1509	865	513	385	170	73	33	13	130
10.1%	10.2%	10.3%	8.5%	8.8%	10.0%	10.8%	9.9%	8.2%	5.4%	3.1%	1.8%	1.4%	0.6%	0.3%	0.1%	0.05%	0.5%

Gjatë viteve 2005-2009 emigruan 7070 banorë, gjatë viteve 1995 – 1999 emigruan 6449 banorë, kurse gjatë viteve 2000 – 2004 emigruan 5085 banorë.

Tabela 14. Numri i emigrantëve sipas viteve

>1960	60-64	65-69	70-74	75-79	80-84	85-89	90-94	95-99	2000-04	2005-09	2010+	N.J.N.D.
21	38	106	289	289	630	1227	4083	6449	5085	7070	1610	1008
0.08%	0.14%	0.38%	1.04%	1.04%	2.26%	4.40%	14.63%	23.11%	18.22%	25.34%	5.77%	3.61%

Arsyeja e emigrimit të banorëve jashtë Kosovës: Bashkimi familjar me 18,510 banorë, punësimi jashtë vendit me 7563 banorë dhe lufta e viteve 1998 – 1999 me 544 banorë.

Tabela 15. Numri i banorëve sipas arsyeve të emigrimit

Punësimi	Studimi	Familjare	Lufta 1998/99	Të tjera	Nuk ka të dhëna
7563	87	18510	544	393	808
27.10%	0.31%	66.33%	1.95%	1.41%	2.90%

Bazuar në të dhënat e ASK të vitit 2014, nga vendet e jashtme janë kthyer 3873 banorë, me 1365 të kthyer nga Gjermania, 697 të kthyer nga Zvicra, 612 nga Sllovenia dhe kështu me radhë.

Tabela 16. Numri i banorëve të kthyer sipas shteteve në të cilat imigruan

Gjermani	Serbi	Zvicër	Maqedoni	Shqipëri	Mali i Zi	Slloveni	Austri	Itali	Kroaci	Bosnje	Suedi
1365	81	697	84	157	24	612	90	458	65	59	32
36.7%	2.2%	18.7%	2.3%	4.0%	0.6%	15.8%	2.3%	11.8%	1.7%	1.5%	0.8%

Krahasuar me Komunat tjera, Komuna e Suharekës radhitet e njëzeta sa i përket numrit të banorëve që kanë emigruar drejt Komunave tjera me bilancin negativ -2.3 në 1000 banorë.



Tabela 17 Komunat me bilancin më të lartë pozitiv të migrimit

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Graçanicë	Klokot	Fushë Kosovë	Prishtinë	Partesh	Ranillug	Ferizaj	Novobërdë	Junik	Prizren	Hani i Elezit	Gjilan	Pejë	Istog	Gjakovë	Shtime	Vushtrri	Mamushë	Lipjan	Suharekë
23.2	22.5	17	15.2	12.3	7.4	5.3	5.2	5.2	4.8	3.8	2.7	1.2	1.1	-0.2	-0.5	-0.6	-1.1	-2.3	-2.3
Numri i emigrantëve kombëtar nga Komuna është 6747 që përbën 11% të popullsisë rezidente. ¹⁰																			
Numri i emigrimit kombëtar				Përqindja e emigrimit në raport me popullsinë rezidente të komunës						Pjesëmarrja e përgjithshme e emigrimit kombëtar									
6,747				11.3						3.43									

Krahasuar me Komunat tjera, në Komunën e Suharekës kanë imigruar 5358 banor, kryesisht për shkaqe familjare dhe të punësimit.

Tabela 18. Arsyet e imigrimit në Komunë

Punësimi		Arsimi apo trajnime		Familjare		Luftës		Tjera	
Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%
151	2.8	61	1.1	4,035	75.3	68	1.3	1,043	19.5

Periudha më e lartë e imigrimit është para vitit 1980 kur 1604 banor kanë imigruar në Komunë. Gjatë periudhës së pasluftës në vitin 2000 kanë imigruar në Komunë 194 njerëz, kurse në vitin 2010 imigruan 229 banorë.

Tabela 19 Imigrimi në Komunë sipas viteve <1980 - 1995

<1980	1981	1982	1983	1984	1985	1986	1987	1988	1989	1990	1991	1992	1993	1994	1995
1604	113	84	99	87	87	95	94	92	104	120	96	93	112	112	120
29.9%	2.1%	1.6%	1.8%	1.6%	1.6%	1.8%	1.8%	1.7%	1.9%	2.2%	1.8%	1.7%	2.1%	2.1%	2.2%

Tabela 20 Imigrimi në Komunë sipas viteve 1995 - 2011

1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
118	113	136	119	194	124	120	103	136	137	174	151	165	197	229	30
2.2%	2.1%	2.5%	2.2%	3.6%	2.3%	2.2%	1.9%	2.5%	2.6%	3.2%	2.8%	3.1%	3.7%	4.3%	0.6%


¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Migrimi Kosovar, Prishtinë, 2014



2.2.3. Veçoritë mjedisore

2.2.3.1. Pedologjia

Territori i Komunës së Suharekës tregon llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet në gjetjen e numrit më të madh të grupeve themelore të tokave dhe numrit të madh të njësive kualifikuese të rendit të ulët si dhe të zvogëlimit të tyre gjë që tërë territorit i jep një pamje mozaike. Nëse përjashtohet toka skeletore e cila paraqitet në vendin e saj ekzistues, tokat tjera janë nga substratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sendimentet e liqeve, pjesërisht me bartjen fluviale të lokacioneve e pjesërisht me bartjen recente të rrjedhave të ujit. Prezenca e një numri të madh të tokave të cilat sipas karakteristikave dhe mundësive të shfrytëzimit në bujqësi dallohen mjaft e që është rezultati i ndikimit të faktorëve të ndryshëm të formimit.



Harta 4 Përbërja pedologjike

Pseudoglejet—Në masë të vogël ndodhen edhe në territorin e Suharekës. Relievi i këtyre tokave është i rrafshët e vende valore. Prodhimtaria bujqësore në këto toka është e kufizuar kështu që me qëllim të shfrytëzimit intensiv të saj duhet të bëhen drenazhet sipërfaqësore dhe të ndërmerren masa agromerilacione në mënyrë që të thellohen shtresat e lavrës dhe të rritet kapaciteti i saj dhe lëshueshmëria e ujit. Boniteti i kësaj toke është i klasës IV— VI.

Tokat aluviale—Është tokë e luginave dhe lumenjve me përbërje të llojllojshme mekanike. Është tokë aluviale me përbërje deltinore, janë toka më produktive që mundësojnë formën më intensive të prodhimeve bujqësore. Mirëpo në disa pjesë të tokave aluviale për shkak të mos rregullimit të shtratit të lumenjve shpesh vërshohen apo dheu bartet me erozion anësor. Këto sipërfaqe duhet sanuar me masa gjegjëse hidroteknike. Këto sipërfaqe janë të bonitetit klasorë të I-rë dhe bëjnë pjesë në tokat me produktivitet të lartë bujqësorë.

Tokat bujqësore të kategorisë I, II, III dhe IV janë të mbrojtura me ligjin mbi tokat bujqësore dhe konsiderohet se sipërfaqja e tokës pjellore në komunën e Suharekës përbën 53% të sipërfaqes totale të kësaj komune.



Edhe pse territori i komunës është i mbuluar mirë me rrjetin e lumenjve (sipërfaqe ujore) sasia e ujit të lumenjve është e pamjaftueshme për ujitjen e tokave bujqësore.¹¹


Kosova humb një pjesë të madhe të tokës bujqësore, në forma të ndryshme si:

- Humbja e përhershme tokës bujqësore e cila shkaktohet nga vendbanimet, komunikacioni, industria, veprimtaritë komerciale – shërbyese - tregtare, akumulimet e ujit, shfrytëzimi joracional i pyjeve, etj.
- Humbjet e përkohshme të tokës bujqësore bëhen nga proceset e erozionit dhe të vërshimeve, degradimet e ndryshme, gërryerjet e lumenjve, deponitë e mbeturinave komunale, deponitë e mbeturinave industriale etj.

2.2.3.2. Gjeologjia dhe tokat

Komuna e Suharekës kufizohet me nën rrëzën e Prizrenit në një anë dhe Podrimën pjellore në anën tjetër. Pjesët veriore të komunës janë nën mergel, argjilë, argjilë me thëngjill gëlqeror, santon mastrihit, rrethina e Carralevës gjendet nën flishin e shkumësit të epërm, doneve mastrihite ku vende vende lajmërohet dijabazi në formacion brijor të dinaroideve, serpentine dhe perioditeve serpentine. Pjesa më e madhe e territorit në pjesën juglindore të komunës gjendet nën rrasat e gjelbërta, metabolizite, ku lajmërohet dhe anfiboliti e në jug ka dhe gëlqere dhe dolomit.¹²

Terrenet në të cilat shtrihen vendbanimet dhe ato për rreth saj, janë të përbërjes gjeologjike të ndryshme. Vendbanimet shtrihen kryesisht në lymoret e lumenjve të përbërjes së ndryshueshme dhe vërshimeve dhe ranishtave të vjetërsisë holocentrike (kvartale). Zona e gjerë e vendbanimeve nga veriperëndimi, perëndimi dhe jugu, shtrihet mbi mergel, argjilë me thëngjill, rërë dhe zhavorr të vjetërsisë pliocene (terciere).



Harta 5 Formacionet gjeologjike

Tereni në të cilin shtrihen vendbanimet si dhe terrenet në jug, lindje dhe perëndim të tyre në shikim të ekspozicionit gjenden në zonën e rrafshinës, ndërsa një pjesë më e vogël nga drejtimi në zonën jugore dhe

¹¹ PZHK Suharekë 2008 – 2018, fq.93

¹² PZHK Suharekë 2008 – 2018, fq.88



perëndimore të ekspozicionit. Pjerrësitë në të cilat gjendet vendbanimi i Suharekës janë në mes të 2⁰ dhe 5⁰. Nga veriu dhe lindja pjerrësitat janë më të mëdha për shkak të ngritjes më të madhe të terrenit.

Suhareka shtrihet në terrenet të cilat janë morfologjikisht më të përshtatshme për zgjerimin e tij topografik. Në veri dhe lindje të vendbanimit, terrenet ngrihen në formë të trasesë ndërsa nga jugu dhe perëndimi hapen rrafshinat e fushës së Prizrenit. Nga shikimi i ekspoziturës terrenet në të cilat shtrihet vendbanimi i Suharekës dhe ato të cilat shtrihen nga jugu, lindja dhe perëndimi gjenden në zonën jug-lindore të ekspozicionit, ndërsa nga verilindja në zonën jugore dhe perëndimore të ekspozicionit. Marrë në përgjithësi kushtet gjeomorfologjike të vendbanimit të Suharekës dhe rrethinës së saj janë të përshtatshme për zhvillim të mëtejshëm.


Sa i përket mbulueshmërisë së përgjithshme prej 36,099ha të sipërfaqes së tokës, me pyje janë të mbuluara 15,074ha ose 41.7%, toka bujqësore janë 19,373ha ose 53.7% si dhe sipërfaqe tjetër 1,652ha ose 4.6%.

2.2.3.3. Karakteristikat hidrografike

Komuna e Suharekës ka rrjet të zhvilluar hidrografik, gjegjësisht ka një numër të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë nëpër territorin e komunës.

Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore apo lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasive të ujit gjatë vitit. Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka pak ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.

Të gjithë ujërat burojnë dhe rrjedhin në territorin e komunës përpos disa përroskave si përroska e Carrallevës, Topillës dhe lumit të Bllacës që burimin e kanë në territorin e komunës së Suharekës kurse pjesa më madhe e tyre vazhdojnë rrjedhën dhe derdhen në territorin e komunave tjera.



Harta 6 Shtrirja hidrogeologjike

Lumi më i madh i komunës dhe arteria kryesore hidrografike është Lumi Toplluha. Ky lum formohet nga rrjedhat e burimeve të ujit duke filluar nga Qafa e Duhlës e deri në Malet e Budakovës dhe përroskat lokale duke e formuar Lumin e Suharekës dhe si degë e burimeve të ujit nga Pagarusha dhe Nishori (Lumi i




Semetishtit). Toplluha është një ndër degët e majta të lumit (më të madh në Kosovë) Drini i Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të Toplluhës¹³ është $F=510.0\text{km}^2$, kurse gjatësia e lumit është 15.5km.

Pellgu i Lumit të Sopisë formohet nga Lumi i Vraniqit nga burimet e ujit nga bjeshka e Jezercit dhe dega tjetër nga Lumi i Zi që formohet nga pellgjet e ujërave me rrjedhë nga gryka e Dellocit dhe Lumi Maqiteva. Pellgu i Lumit të Sopisë bashkohet me lumin Toplluha në territorin e Komunës së Mamushës dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi i Bardhë me burim nga Bjeshka e Mushtishtit me rrjedhë nën Sallagrazhdë dhe Gelancë, bashkohet me Lumin e Grejkocit nën fshatin Gelancë dhe vazhdon rrjedhën territorin e Komunës së Prizrenit duke u bashkuar me lumin Toplluha në fshatin Zojs dhe vazhdon rrjedhën e derdhjes në drejtim të Lumin Dri.

Mbi gjysma e sipërfaqes së pellgut të lumit Toplluha është tokë punuese, rreth 30% livadhe dhe kullosa, 10% male dhe pjesa tjetër është djerrinë.

2.2.3.4. Lartësia mbidetare

Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta dhe atë në veriperëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828 m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1048m, në lindje me malet e Jezercit 1677m (Kryet e Ahishtes) dhe në juglindje me malet e Sharrit (Dera e Pashës) 2092m, ndërsa në perëndim shtrihet në rrafshina (ultësira) e Prizrenit.




Harta 7 Hipsometria e terrenit dhe lartësitë mbidetare

Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455 m. Vetë qyteti i Suharekës gjendet në lartësi mbidetare prej 400 m. Sipërfaqja e komunës është 361 km^2 që mbulon 3.3% të territorit të Kosovës.¹⁴

¹³ Plani Hapësinor u Kosovës (Strategjia e Zhvillimit Hapësinor) 2010 – 2020+

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë, 2013



Harta 8 Pjerrtësitë e shpateve

2.2.3.5. Kushtet klimatike


Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Suharekë është 11°C. Në muajin gusht lajmërohet maksimumi absolut prej 38.2 °C. Amplituda absolute është 52.3 °C. Komuna e Suharekës gjendet në jug të Kosovës dhe ka klimë kontinentale me ndikim mesdhetar.

Në vijim janë radhitur vlerat kyçe klimatike:

- Vlerat mesatare relative vjetore e lagështisë në Suharekë është 74.3%. Lagështia më e ulët relative e ajrit në Suharekë është në muajin gusht 63.2%.
- Në Suharekë është vranësira më e vogël në muajin gusht (2.7), ndërsa vranësira mesatare vjetore është 5.0 të dhjetat e qiellit.
- Vlera mesatare e të reshurave në Suharekë është 674.0 mm. Të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa më të vogla në muajin shkurt dhe janar.
- Të reshurat më të mëdha në Suharekë janë gjatë muajit mars 169.6 mm, ndërsa sasia minimale e të reshurave në këtë territor është 410.0 mm.
- Në Suharekë më së shpeshti fyejnë erërat nga verilindja (193%), lindja (32%), dhe jugperëndimi (32%), ndërsa më së paku fyejnë erërat nga jugu (33%), dhe veriperëndimi (13%). Shpejtësinë mesatare më të madhe e kanë erërat nga jugperëndimi (4.6m/sek) dhe verilindja (3.6m/sek).

Tabela 21 Vlerat mesatare klimatike

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	m. vjet.
Temp. max .	16.4	20	25.5	26.3	32.3	36.5	37	38.2	35	30.2	23.8	22	38.2
Temp. min.	-14.1	-12.4	-10.4	-3	1	7	6	6.2	1.5	-1.8	-9	-11	-14.1
Temp. mes.	0	1.7	5.3	11.5	15.7	19.8	22.7	22.3	18.2	11.7	7.2	3.3	11.6
Lagështia %	84.5	76.6	75.4	75.0	75.0	69.4	63.6	63.2	68.1	71.8	85.7	34.2	74.3
Shtypja atmosferë	954.1	949.6	938.4	942.6	948.5	950.1	948.4	948.2	948.6	948.6	948.7	948.6	947.9
Shpjet. e erës m/s	1.0	1.5	2.5	2.7	1.9	2.4	2.2	1.9	1.8	1.8	2.2	2.6	2.0
Reshjet - shi	33.0	12.0	26.0	47.0	89.0	124.0	36.0	37.0	31.0	136.0	70.0	33.0	674.0
Reshjet - borë	0.4	3.9	4.2	2.1	0.3	0.1	0.4	3.9	4.2	2.1	0.3	0.1	0.4



Harta 9 Ekspozicioni i terrenit

2.2.3.6. Biogjeografia

Komuna e Suharekës ndodhet në pjesën verilindore të luginës së Prizrenit, në kufijtë të shpateve të Prizrenit në një anë dhe e Podrimës në anën tjetër.

Lartësia mesatare mbidetare është 455m. Nëpër luginë të Drinit të Bardhë me klimë kontinentale të kësaj ane ka ndikim klima mesdhetare e cila mundëson kushte të mira për zhvillimin e vegjetacionit.

Lumi kryesor i Suharekës është Toplluha i cili rrjedhë nëpër vendbanim të Suharekës. Gjatë pjesës më të madhe të vitit në shtratin e tij ka sasi relativisht të vogël të ujit. Në kohën e të reshurave të mëdha lajmërohen valët vërshuese, me erozion të theksuar.

Flora

Sipërfaqet bujqësore-ekonomike janë sipërfaqe të punuara (23,378ha), ku bujqësia është njëra ndër degët kryesore të veprimtarive ekonomike. Sipërfaqja e punuar, respektivisht arat dhe kopshtet (12,918ha) shfrytëzohen kryesisht për prodhimin e grunajave (grurit, misrit, elbit dhe thekrës), të bimëve industriale dhe perimeve (grosha, patatja, domatja, specja, sallata etj) dhe bimëve për kafshë (tërfoja dhe jonxha). Pemishtet përfshijnë sipërfaqen prej 426ha. Pemëtaria nuk është një degë aq e zhvilluar ekonomike. Në to kryesisht kultivohen kumbullat, mollët dhe qershitë. Ndërkaq falë pozitës gjeografike, kualitetit të tokës dhe kushteve tjera shumë të mira për zhvillimin e vreshtarisë e që sipas të dhënave nga “Departamenti të Vreshtarisë dhe Verëtarisë” deri në fund të vitin 2018 në prodhimtari kanë qenë 513.84ha vreshta.

Livadhet përfshijnë sipërfaqen prej 2,753ha ndërsa kullosat 5,578ha. Sipërfaqet e pashfrytëzuara ekonomike janë pyjet dhe zabelet. Gjendja ekzistuese e pyjeve dhe e fondit të pyjeve edhe pse janë ndërmarrë masa me qëllim të kultivimit, kujdesit dhe zhvillimit të pyjeve, nuk janë aq të mira edhe pse kushtet janë të volitshme. Sipërfaqe pyjore përbëjnë 15,561ha prej tyre 1,600ha janë pyje të larta. Pyjet e komunës së Suharekës shtrihen në lartësi mbidetare 455m deri 1760m.

Këto pyje janë kryesisht pyje gjethore (lisi dhe ahu) ndërsa haloret janë mjaft të pranishme. Si lloje përcjellëse të pyjeve lisore janë: shegët, gorniçet, dardhat e egra, gështenja etj., ndërsa të kaçubave pyjore: murrizi, thana, trëndafili i egër, etj.



Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në komunën e Suharekës, ekonomia pyjore ka dy njësi:

1. “Biraqi” dhe
2. “Kryet e Ahishtës — pyjet e Mushtishtit”.

Në “Biraqi” dominon bingu dhe ceri furs gjendet edhe qarri, pisha, mështekna, qershia, lajthia, thana, etj, ndërsa në “Kryet e Ahishtës — pyjet e Mushtishtit” dominon ahu pastaj pisha (të gjitha llojet), breu, mështekna, verri, plepi, rakiti, etj.

Kushtet për zhvillimin e pylltarisë janë mjaft të volitshme. Kemi rritje të shpejt të masës drurore prej 1.70m³ deri 5.30m³ për hektar/1vit.


Si pasoj e rrethanave të pasluftës këto pyje kanë pësuar dëme të shumta nga mekanizmat shtetëror para lufte dhe nga dëmtues individual pas luftës. Megjithatë falë bonitetit të lartë të tokës ato janë ripërtërirë vet, janë në fazën e rritjes dhe zhvillimit intensiv.

Fauna

Në ujërat e kësaj komune ekzistojnë këto lloje peshqish: krapoliq, brocak, mustak të përrojeve, dylmorë, por ka edhe ngjala. Në këto ujëra ka edhe gaforre, bretkosa dhe gjarpërinj të ujit.

Nga kafshët shtëpiake kultivohen: gjedhët, delet, dhitë dhe shpezët. Në zhvillimin e blegtorisë ndikojnë përveç të tjerash pjesët e imta të sipërfaqeve të punuara dhe kullosat e pakta dhe të pa begatshme.

Nëpër livadhe jetojnë stërqoka, sorra, thëllëza, shkurtëza, kukuvaika, lajmërohen edhe derrat, dhelprat, ujkit.



Harta 10 Zonat e biodiversiteti

2.2.4. Ekonomia

Zhvillimi Ekonomik në Komunën e Suharekës kryesisht bazohet në disa fusha të cilat janë me prioritet për zhvillimin e komunës tonë dhe janë vlerësuar si mundësi e mirë për zhvillim në fusha si: Agrokulturë, Turizëm, Energji dhe Prodhim.



Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme karakterizohen me zhvillime të ndryshme të veprimtarive, ndërsa si ndërmarrje të mëdha janë Fabrika e Prodhimit të gomës "Ballkan", Fabrika e prodhimit të verës "AgroKosova Holding", Fabrika për përpunimin e lëkurës "Solid", Fabrika për tekstil "Arta-Tex", Fabrika për përpunimin e produkteve të mishit "Flor-en", fabrika për përpunimin e pijeve freskuese joalkoolike "Frutex", dhe një sërë ndërmarrjesh për përpunimin e produkteve të drurit, plastikes, aluminit, metalit, etj.

Një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik paraqesin Zona Industriale në Shirokë dhe Agro Zona në Samadrexhë si dhe autostrada Morinë-Merdare që praktikisht kalon mes përmes komunës së Suharekës.

2.2.4.1. Punësimi

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, nga gjithsej 42,313 banorë, ekonomisht aktiv janë 15,013, të punësuar 8,043 banorë në marrëdhënie të rregullt pune.

Tabela 22 Popullsia e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual, gjinisë dhe komunës 2011

	Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Të papunësuar, ka punuar më parë	Të papunësuar, nuk kanë punuar kurrë më parë	Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të cilën janë pranuar	Ekonomikisht jo aktiv	Total
Meshkuj	11503	6666	2798	1996	43	8937	20440
Femra	3510	1377	251	1854	28	18363	21873
Gjithsej	15013	8043	3049	3850	71	27300	42313

Sa i përket aspektit gjinor, me 83% dominon punësimi i gjinisë mashkullore krahasuar me 17% të gjinisë femërore.

Tabela 23 Numri dhe përqindja e të punësuarve sipas gjinisë

	Numri i të punësuarve	Përqindja e të punësuarve
Meshkuj	6666	83%
Femra	1377	17%
Gjithsej	8043	100%

Sa i përket sektorëve të punës, më së shumti janë 1002 punëtorët e shërbimeve personale dhe mbrojtëse, 985 punëtorë në ndërtimtarë dhe miniera, 837 e mësimdhënës dhe 700 modele, shitësit dhe demonstruesit.

Pjesa më e madhe e të punësuarve, 5208 banorë punojnë në vendbanimet e tyre, përderisa 1284 banorë punojnë brenda Komunës por në vendbanimet tjetër dhe 1118 banorë punojnë në një Komunë tjetër.

Tabela 24 Të punësuarit që udhëtojnë shtëpi-punë dhe anasjelltas sipas vendit të punës, gjinisë dhe komunës

	Komuna dhe vendbanimi i njëjtë me banimin e zakonshëm aktual	Në Kosovë, komuna e njëjtë me banimin e zakonshëm aktual, por vendbanimi i ndryshëm	Në Kosovë komuna e ndryshme nga ajo e banimit të zakonshëm aktual	Shqipëri	Serbi	Mali i Zi	Maqedoni	Shtetet tjera	Nuk aplikohet	Nuk janë në dispozicion	Gjithsej
Gjithsej	5208	1284	1118	14	0	6	3	41	225	144	8043
Meshkuj	4330	1037	925	11	0	6	3	40	181	133	6666
Femra	878	247	193	3	0	0	0	1	44	11	1377



Nga 59,722 banorë, 29,660 varen nga mbështetja financiare nga persona tjerë, gjersa 10,090 banorë varen nga përfitimet prej punës, pronës apo biznesit, dhe 7,277 banorë varen nga remitencat.

Tabela 25 Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës, gjinisë dhe komunës

	Puna (përfshirë punën në pronën, biznesin e tij apo të familjes)	Patundshmëri, investime (qira, interes)	Pension	Ndihma sociale	Transfere tjera (përfitime nga papunësia, sëmundja dhe lehonie, bursë)	Remitenca (të ardhura nga familjarët në shtet tjera)	Mbështetje nga persona tjerë	Burime tjera	Gjithsej
Gjithsej	10090	72	3538	2019	66	7277	29660	7000	59722
Meshkuj	7674	47	1760	988	35	3222	12553	3199	29478
Femra	2416	25	1778	1031	31	4055	17107	3801	30244

Pjesa më e madhe e të punësuarve prej 1002 banorëve janë të punësuar në shërbime personale apo mbrojtëse, 985 banorëve janë të punësuar në miniera apo ndërtimtari, 837 në mësimdhënie.

Tabela 26 Punësimi sipas profesionit kryesor dhe gjinisë

	Ligjvënës	Menaxherët e korporatave	Menaxherët e organizatave të vogla	Profesionistët e fizikes, matematikes dhe shkencave inxhinierike	Profesionistët të shkencës biologjike dhe shëndetësore	Profesionistët e mësimdhënies	Profesionistët e tjerë	Bashkëpunëtorët profesional në lëmit teknike	Bashkëpunëtorët profesional të shkencës biologjike dhe shëndetësore	Bashkëpunëtorët profesional të mësimdhënies	Bashkëpunëtorët profesionalë për punë komerciale dhe administratë publike	Nëpunës zyrtarë	Nëpunës të shërbimeve për klientë	Punëtorët e shërbimeve personale dhe mbrojtëse	Modelet, shitësit dhe demonstruesit	Punëtorët e kualifikuar të bujqësisë dhe peshkimit	Punëtorë në miniera dhe ndërtimtari	Punëtorë në metalurgji, makineri dhe të ngjashme	Punëtorët për punë precize, pune dore, shtypje dhe të ngjashme	Punëtorët e zejeve tjera dhe të ngjashme	Operatorët e pajisjeve të palëvizshme dhe të ngjashme	Operatorët e makinave prodhuese dhe montuesit	Vozitësit dhe operatorët e pajisjeve mobile	Profesionet elementare të shitjes dhe shërbimeve	Punëtorët e bujqësisë e peshkatari së dhe të ngjashme	Profesionet elementare në miniera, ndërtimtari, industri përpunuese dhe transport	Profesionet elementare të paklasifikuara tjetërkund
Gjithsej	51	282	173	146	116	837	311	297	124	59	229	273	172	1002	700	374	985	408	45	162	26	116	392	221	44	358	140
Meshkuj	42	254	159	133	78	503	244	269	56	20	178	183	126	872	511	358	974	400	37	64	24	100	392	175	42	334	138
Femra	9	28	14	13	38	334	67	28	68	39	51	90	46	130	189	16	11	8	8	98	2	16	0	46	2	24	2



2.2.4.2. Bizneset dhe struktura e tyre

Komuna e Suharekës ka një pozitë të mirë gjeografike, që mundëson zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndër komunal, ka resurse të mira natyrore si sipërfaqet pyjore, toka të punueshme, kullosa, pemishte, bimë të ndryshme mjekësore dhe pasuritë e tjera tokësore dhe nëntokësore. Sa i përket ndërmarrjeve ekonomike aktive, vërehet një zhvillim i baraspeshuar në mes të zonës urbane, ku veprojnë 1090 ekonomi dhe zonës rurale ku veprojnë 942 ekonomi.

Tabela 27 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas sektorëve ekonomik, 2016-2019

Ndërmarrjet sipas sektorit ekonomik	2016	2017	2018	2019
A- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	25	25	20	18
B- Xehoret dhe gurëthyesit	0	3	1	0
C- Industria përpunuese	28	1	32	35
D- Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim	2	5	1	1
E- Furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese	3	1	0	1
F- Ndërtimtaria	28	14	23	18
G- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	54	32	49	37
H- Transporti dhe magazinimi	12	10	11	7
I- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	22	26	27	31
J- Informimi dhe komunikimi	3	2	3	2
K- Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	9	7	2	3
L- Aktivitetet e patundshmërive	1	1	0	0
M- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	16	11	17	11
N- Aktivitetet administrative dhe shërbimet mbështetëse	2	0	10	13
O- Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obligativ	2	0	2	1
P- Arsimi	3	0	2	3
Q- Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	2	8	7	2
R- Arte, argëtimi dhe rekreacioni	11	3	10	7
S- Aktivitetet tjera shërbyese	20	26	8	9
T- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra të pa diferencuara dhe shërbime aktivitetet prodhuese të ekonomive familjare për shfrytëzim vetanak	0	6	0	0
U- Aktivitetet e organizatave dhe organeve të huaja	0	0	0	0
Gjithsej	243	181	225	199

2.2.4.3. Industria

Komuna e Suharekës ka dy Zona Ekonomike:

- Zonën Industriale në Shirokë;
- Agrozonën në Samadrexhë dhe
- Eksploatimi i resurseve minerale dhe natyrore.

Zona Industriale në Shirokë

Zona Industriale është themeluar në vitin 2009, me një sipërfaqe prej ~163ha, me 78 parcela ndërtimore. Zona është e vendosur në afërsi të rrugës Prizren – Prishtinë, e cila është licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2017. Në bazë të projektit (PRrU) zona përbehet nga 12 tërësi, me destinim të mëposhtëm:



- T1/ Objekt Administrativ, Ambulanca e Mjekësisë së Punës, Tregu Ekspozues, Trafostacioni, Hotel, çerdhe e fëmijëve, Teren Sportiv, Parkingje dhe gjelbërim-park;
- T2/1 Mbushtorja e verës, Ben-Af, Vreshtaria;
- T2/2 Veprimtari të Pijeve Joalkoolike;
- T3/2 Veprimtari për përpunim të produkteve ushqimore;
- T4/1 Shkolla Bujqësore-Profesionale;
- T4/2 Veprimtari për përpunim të produkteve ushqimore nga pemët dhe perimet;
- T5/ Veprimtari për përpunim të elementeve nga Materialet e Plastikes, Aluminit dhe Druri;
- T6/ Veprimtari për përpunim të Tekstilit dhe Lëkurës;
- T7/ Veprimtari për Përpunim të Elementeve të Teknikës nga Elektri dhe Elektronika;
- T8/ Veprimtari për përpunim të Konstruksioneve nga Hekuri, Betoni dhe Druri;
- T8/ Veprimtari për përpunim të Qelqit, Plastikës, Fasadës, Gurit dhe Mermerit;
- T9/ Veprimtari Bujqësore, Hipodrome, Ferma, etj.;
- T10/ Veprimtari për Depo të Ndryshme Ushqimore;
- T11/ Veprimtari për Përpunim të Konstruksioneve nga Druri dhe Gasbetoni;
- T11/ Veprimtari për Depo të ndryshme të Materialeve;
- T12/ Objekti i Ngrohjes Qendrore.

Në Zonë Industriale aktualisht janë 53 biznese që kanë kontratë për shfrytëzim të parcelave siç janë:

Kompania “SOLID” me ~280 punëtor - prodhim i Këpucëve dhe përpunim të Lëkurës, “Graniti&CO Sh.p.k” - prodhim të stiropolit dhe llaqit fasadues, N.t.sh. “Stomatologjia” - prodhim i produkteve farmaceutike, “Seti Commerc” Sh.p.k.-prodhim i elementeve të betonit, Kompania Intertranscopy -prodhim i armaturës, Kompania “I Seferi” - prodhim i betonit dhe elementeve të tij, Dardania Wien prodhim i verës, Vllesa Co prodhim i shportave të plastikes, si dhe shumë kompani të tjera që janë pjesë e kësaj zone.

Sipas të dhënave të deri tanishme në Zonë Industriale janë të punësuar afërsisht 1000 punëtorë, po ashtu vlen të theksohet se veçanti e kësaj zone është edhe Shkolla e Mesme Profesionale “Abdyl Ramaj”, ku në këtë shkollë përgatiten kuadro për tregun e punës, veçanërisht për bizneset që zhvillohen brenda Zonës.

Agrozona në Samadrexhë


Agrozona është me sipërfaqe prej ~35ha, në ZK Samadrexhë ndodhet pranë rrugës Suharekë-Rahovec. Është themeluar me iniciativë të Komunës së Suharekës dhe Rahovecit.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian, për përkrahje të zhvillimit në regjionin ekonomik jugor të Kosovës për të krijuar ambient të përshtatshëm për biznes, rritje të aftësive ndërmarrëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ky projekt është kontribut i drejtpërdrejt dhe strategjik me objektivat e përgjithshme të Komisionit Evropian për të krijuar një bazë për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë.

Sipas të dhënave të fundit, shfrytëzues të parcelave për 99 vite janë gjithsej 16 shfrytëzues (persona fizik dhe juridik).

Resurset Minerale dhe natyrore

Në komunën e Suharekës një numër i konsiderueshëm i kompanive bën eksploatimin dhe përpunimin e gurit. Sipas Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale në territorin e komunës sipas Hartës 11 veprojne disa kompani të cilat bëjnë eksploatimin dhe përpunimin e produkteve nga guri.



Harta 11 Shtirja e resurseve minerale dhe natyrore

2.2.4.4. Bujqësia

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në komunën e Suharekës është 36, 099ha. Nga kjo sipërfaqe 19,377ha (53.7%) - tokë bujqësore pjellore, 1652ha (5%) - tokë jopjellore apo djerrinë si dhe 15,074ha (42%) -pyje.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, 12,666ha është tokë e punueshme, 1652ha të pa kultivuara dhe 2250ha livadhe dhe kullosa. Kjo tokë është e mbjellë me kulturat bujqësore si drithëra, vreshta, perime dhe pemë.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Suharekës gjatë viteve 2014-2017 janë 4481ha të mbjella me drithëra, 949ha me hardhi të rrushit, 646 ha të kultivuar me perime dhe 279ha me pemë. Toka tjetër përbën 2250ha me livadhe, 2010ha të shndërruar në kullosa dhe 2300ha të mbetura djerrinë.

Perimkultura - Është mjaft e përhapur në Komunën e Suharekës. Gjatë vitit 2017 janë mbjellë ~531 ha me perime, ku si kulturë kryesore është domatja, speci, patatja, shalqiri, pjepri, qepa, etj. Viteve të fundit ka marr hov kultivimi i perimeve në ambient të mbyllur (sera), ku sipas shënimeve të fundit janë mbjellë~27ha.

Vreshtaria - Komuna e Suharekës është e njohur për kultivimin e hardhisë së rrushit dhe prodhimtarinë e rrushit dhe verës.

Sipas të dhënave nga “Departamenti të Vreshtarisë dhe Verëtarisë” deri në fund të vitin 2018 në prodhimtari kanë qenë 513.84ha vreshta që i përkasin sektorit privat, të mbjella në 2589 parcela të veçanta. Për shkak të politikave subvencionuese qeveritare dhe granteve të ndryshme ndërkombëtare kërkesat e fermerëve janë në rritje e sipër për kultivimin e kulturës së hardhisë së rrushit.



Tabela 28. Sipërfaqja e vreshtave sipas destinimit të variateteve

Destinimi	Sipërfaqja [ha]	Përqindja [%]	Nr. vreshtave
Tryeze	257.98	50.20 %	1434
Vere	255.86	49.80 %	1155
Gjithsej	513.84		2589

Pemëtaria—Komuna e Suharekës ka kushte të volitshme klimatike—tokësore shumë të favorshme për kultivimin e pemëve. Më së shumti kultivohen mollët, dardhat, kumbullat, qershizat, pjeshkat, kajsitë, arrat dhe gështenjat. Kjo veprimtari ka filluar të ringjallet, momentalisht me pemë janë të mbjella mbi 50 hektarë. Sipas të dhënave të drejtoratit për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari viteve të fundit sidomos nga 2012 e deri e deri me 2017 janë mbjell mbi 30 hektar me kultura të mollës, gjithë ashtu me tendencë të rritjes të këtyre sipërfaqeve. Në ekonominë familjare ngritja e kopshteve me pemë ka marr hov shumë të madh dhe sot kemi të ngritura 250 *ha* me lloje të ndryshme të pemëve në oborre dhe kopshte të shtëpive.

Tabela 29 Prodhimtaria vjetore Drithërave, Foragjereve, Perimeve, Pemëve në tonelata për vitin 2019

Drithëra				Foragjere			Perime					Pemë				
Gruri	Misri	Elbi	Tërshëre	Jongja	Tërfili	Misri foragjer	Domate serra	Spec	Tranguj serra	Patate	Qepë	Molla	Kumbulla	Dardha	Pjeshka	Ftua
5.3	4.2	3.2	4	10	6.5	30	190	40	42	38	31	50	27	42	30	31

Shpeztaria—Mbajtja e shpendëve është mjaft e përhapur në ekonominë familjare. Gati çdo familje posedon një sasi të vogël të shpendëve, që kryesisht shfrytëzohen për nevojat familjare. mbas lufte kanë qenë 4 mini ferma për mbajtje të shpezëve (me kapacitet 3000-4000 krerë). Sipas të dhënave të fundit (janar 2018) nga numri i përgjithshëm i fermave të pulave vojse është 7 ferma me kapacitet prej 2000-28000, pula vojse. Fondi i shpezëve është 39700 copë pula vojse.

Blegtoria—Sipërfaqja poseduese e livadheve, terreni i përshtatshëm për kullosa si dhe interesimi i vazhdueshëm i fermerëve për blegtorinë dhe shpezërinë janë potenciale të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe zbutjen e problemeve sociale në fshatra. Para luftës fondi i bagëtive ka qenë i pasur me gjedh (rreth 15,234 krerë). Gjatë luftës ky fond u përgjysmua dhe kap shifrën prej 7943 krerë lope qumështore.

Gjedhtaria - Sipas të dhënave nga Drejtoria për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari, numri i përgjithshëm i gjedhëve, viçave dhe mështjerrave ka qenë 11,298 krerë

Të regjistruar janë gjithsejtë: 34 ferma të deleve me kapacitet prej 30-400 krerë dele, pra numri i përgjithshëm i deleve është 2,700 krerë. Ndërsa kemi 14 ferma të dhive me kapacitet prej 20-100 krerë dhi, numri përgjithshëm është 344 krerë dhi.

Në vitin 2019 komuna ka një numër prej 9500 gjedhesh, nga të cilat 4000 lopë qumështore të cilat mbarështohen çdo vit, të gjitha gjedhet janë të matrikuara me numra të veshit dhe të regjistruar në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit në gjithsejtë 2008 prona blegtorale.

Tabela 30 Fondi blegtoral për vitin 2019

Gjela	Pula	Lopë	Mëshqerra	Dele	Qengja	Cjap	Dhi	Derra	Dose
1018	3970	4000	5500	2700	4700	50	420	25	45



Dominojnë fermat me nga 2-5 lopë qumështorë, ku janë gjithsejtë 230 miniferme të lopëve, ndërsa janë afër 40 ferma me mbi 10 lopë qumështore.


Fermat të viqave për majmëri janë 5 ferma me kapacitet prej 10-100 viça. Sipas të dhënave të fundit (janar 2018) nga Drejtorati për Bujqësi, Blegtori dhe Pylltari, në komunën e Suharekës ekzistojnë 2650 ekonomi familjare që jetojnë nga bujqësia. Nëse kalkulohe me numrin mesatar të anëtarëve të familjes do të jenë përafërsisht 13,800 banorë që merren me bujqësi. Ndërsa 2,216 ekonomi familjare jetojnë nga blegtoria.

Tabela 31 Prodhimtaria blegtorale për vitin 2019

Mish gjedhi (t)	Mish viçi (t)	Qumësht (l)
670	40	14,540,000

Bletaria—Suhareka ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë, mbasi ka shumë livadhe me lule, drurë akacie, si dhe një ambient ekologjikisht të pastër nëpër pyje. Ekzistojnë "Shoqatat e Bletarëve", e cila po ndihmon zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së fermerëve / apo bujqve në fushën e bletarisë. Aktualisht në territorin e Suharekës ekzistojnë mbi 6000 koshere bletësh. Janë të regjistruar diku rreth 503 bletar të cilët kanë nga 10- 400 shoqëri me bletë.

Teknikat bujqësore -Për lëvrimin e tokës, mbjelljet, korret dhe shirjet, spërkatjen e kulturave bujqësore, si dhe punëve të tjera në bujqësi përdoren traktorët (kryesisht tipi 539 IMT), rimorkio, plugje, freza, autokombajna dhe vegla e makineri të tjera bujqësore. Megjithatë është e domosdoshëm që ky sektor të modernizohet më tej nëpërmjet futjes në përdorim të makinerive dhe teknologjive të reja si ato për mbjelljet e bimëve, spërkatjen dhe vjeljen e pemëve.



Harta 12 Shtrirja e tokave bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë i - VIII




2.2.4.5. Turizmi

Pejsazhi i bukur në tërë komunën është bazë për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të koncentruar në turizëm ekologjik. Në këtë rast qyteti po ashtu ka potencialet e tij natyrore dhe pejsazhore të cilat i japin bazën që turizmi të filloi që nga aty, si një ambient që në të njëjtën kohë shndërrohet në pikë fokale informative dhe akomoduese për aktivitetet turistike që lidhen me qytetin dhe resurset e tij e po ashtu edhe si pikë kohezive e të gjitha aktiviteteve turistike që ndodhin jashtë territorit urban.

Komuna e Suharekës rajon me turizëm të qëndrueshëm rekreativ dhe eksperiencë në natyrë, bazuar në pasuritë natyrore dhe ambiente atraktive për adhuruesit e natyrës ka zona mjaft të përshtatshme dhe interesante për zhvillimin e turizmit që ndodhen në kompleksin e masivit të malit Sharr, i cili shtrihet në pjesën Verilindore dhe Juglindore të Mushtishtit, si dhe në zonën e Maleve të Carralevës. Bukuritë natyrore, vegjetacioni i pasur bimor, ujqor dhe lartësia mbidetare 1500m–2400m, klima mesdhetare alpine, zgjojnë kërshërinë e vizitorëve si gjatë verës ashtu edhe gjatë dimrit.

Vende interesante të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike për t'u vizituar:

Kalaja e Kastercit, Lokaliteti arkeologjik parahistorik në Shirokë dhe Reshtan, Kulla e Pashës në Mushtisht, Shtëpia e Ramë Bllacës në Bllacë, Kulla e Jonuz Tafollit në Qadrak, mullinjtë e Breshancit, mulliri i Dragaqinës, mulliri i Budakovës, mulliri i Semetishtit, mali i Sharrit, guri i Dellocit, Buqalla në Reqan, Xhami e Gazi Mehmet Pashës në Leshan, Xhamia e Bardhë në Suharekë, Muzeu në Suharekë. Ndërkaq nga historia më re e Kosovës ka përmendore dhe lapidare individuale ose kolektive të dëshmorëve, Kompleksi Memorial Parku i Dëshmorëve, përmendorja e viktimave civile të luftës në Suharekë dhe Kompleksi Memorial i viktimave të familjes Berisha në Suharekë.



Harta 13 Lokacionet me potenciale turistike



2.2.4.6. Tregtia dhe shërbimet

Tregtia është një sektor tjetër ekonomik që ka pas një zhvillim të hovshëm gjatë një kohe shumë të shkurtër. Menjëherë pas luftës brenda një periudhe të shkurtër në Suharekë u themeluan shumë ndërmarrje tregtare private të cilat e filluan aktivitetin e tyre. Rrjeti i objekteve tregtare është i përhapur mjaft mirë në të gjitha vendbanimet. Sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë punëson rreth 1600 persona.

Konkurrenca në tregti ka bërë të dukshëm përmirësimin e shërbimit tregtar: ka furnizim të mire dhe të shumëllojshëm me mallra të konsumit të gjerë (artikujt ushqimorë, veshmbathje, pajisje shtëpiake, etj). Këto artikuj tregtohen me çmime relativisht të qëndrueshme. Gjithashtu shumë ndërmarrje tregtojnë artikuj industrialë si materiale ndërtimore, karburante, materiale elektrik dhe teknikë të bardhë.

2.2.4.7. Ndërtimtaria

Gjendja e vështirë pas lufte, për shkak të shkatërrimeve shumë të mëdha të shtëpive të banimit dhe infrastrukturës bëri të domosdoshme edhe nevojën për një zhvillim të hovshëm të ndërtimtarisë. Si pasojë u krijuan ndërmarrje ndërtimore por edhe orientimin e të rinjve në përgatitjen profesionale në lëmin e arkitekturës dhe ndërtimtarisë. Kështu që aktualisht, Suhareka ka potencial shumë të mirë në ndërtimtari me zhvillimin e biznesit në tërë Kosovën dhe më gjerë.

Ndërmarrjet ndërtimore të komunës së Suharekës, të cilat kryejnë punët ndërtimore dhe prodhojnë produkte ndërtimore në komunën e Suharekës rangohen si më të suksesshmet në Kosovë. Ndër ndërmarrjet e shumta janë: Hidroterm, Cima Construction, I-Seferi, Euroing, Kawa Grup, Ingenering, Flori, Famis-CO, EuroFamis, Seti-Commerc, Intertrans-Cop, Logi, Niti, AAB Construction, NBT-ING, Construmax, Thesar, Vllezrit Morina, Nita Plast, Graniti, Simboli, Muri Plast, Aluplast, Dini Plast, Skenderi Plast, Enisi, Celi-AG, Arbëria, DekorFix, etj. Në këto ndërmarrje punojnë rreth 1500 punëtorë. Ky numër konsiderohet të jetë më i lartë pasi që këtu nuk janë përfshirë punëtorët ende të përgjithshëm dhe ata sezonal.

2.2.4.8. Mirëqenia sociale

Aktualisht nga sektori i Mirëqenies Sociale janë duke u trajtuar mbi 1000 raste të shërbimeve të ndryshme sociale dhe rreth 569 familje përfitojnë nga skema e ndihmave sociale në shumë muaj prej 60 deri në 120€, varësisht nga numri i anëtarëve të familjeve skamnore që përfiton nga skema sociale.

Personat me ngecje në zhvillim mendorë trajtohen në mënyrë profesionale në Shtëpinë me Bazë në Komunitet për strehimin rezidencial ku aktualisht strehohen 11 persona. Kjo shtëpi menaxhohet nga DSHMS prej 1 Janarit 2016. Sa i përket çështjes së banimit deri më tani janë ndarë banesa të ndërtuara nga komuna për 20 familje si dhe 29 familje janë të strehuara në objektin e solidaritetit.

2.2.5. Infrastruktura teknike

Si në mbarë Kosovën edhe në territorin e komunës së Suharekës, infrastruktura teknike e rrjedhimisht edhe shërbimet publike që lidhen me të nuk është në nivel të kënaqshëm të zhvillimit. Kjo çështje është problem sidomos sa i përket nivelit të zhvillimit të infrastrukturës ujore dhe për këtë arsye ka nevojë për përpjekje më të mëdha të shoqërisë që ky problem të zgjidhet apo të zbutet. Komuna e Suharekës ka pozitë më të pafavorshme (pas Malishevës) në Kosovë për burim të sigurt të ujit të pijshëm.

Problem është po ashtu furnizimi jo i mirë me energji elektrike ku rrjeti elektrik në disa pjesë është shumë i amortizuar, tensioni i dobët dhe ka reduktime të furnizimit. Rrjeti rrugor është në gjendje relativisht të mirë ku të gjitha vendbanimet janë të lidhura me rrugë të asfaltuara.



2.2.5.1. Ujësjiellësi

Furnizimi i banorëve të Komunës së Suharekës me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjiellësit.

Kapacitet ekzistuese eksploatuese janë burimeve ujore është 0.17 m³/s, gjersa 0.121 m³/s aktualisht shfrytëzohen për furnizim.


Tabela 32 Kapacitet ekzistuese të rrjetit të ujësjiellësit

Sipërfaqësore (m ³ /s)	Nëntokësore (m ³ /s)	Eksploatuese (m ³ /h)	Furnizuese (m ³ /s)	Konservuese rezervoaret (m ³ /s)
0.127	0.802	626.4	0.121	7.245

Në territorin e Komunës, rrjeti primar i ujësjiellësit përkshkon një gjatësi prej 161.70 km.

Tabela 33 Gjatësia e rrjetit primar i ujësjiellësit sipas diametrit

Diametri (Ø)	90	110	125	140	160	200	225	250	315	400
Gjatësia (km)	17.9	23.1	92.9	3.2	6.7	0.5	3.9	4.2	8.1	1.2



Harta 14 Vendbanimet që kanë dhe që nuk kanë rrjet (sistem) të ujësjiellësit

Pjesa më e madhe prej 156,143 km e rrjetit primar është HDPE PE 100, gjersa 6,178 km është PVC.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të KUR "Hidroregjioni Jugor" është 6,892, gjersa konsumi mujor është 53,158 m³.

Tabela 34 Numri i konsumatorëve dhe konsumi mujor i klientëve të Hidroregjioni Jugor"

	Klient të amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
Numri i konsumatorëve	6304	88	500
Shpenzimet sipas konsumatorëve (m³/muaj)	45026	4983	3149



Tabela 35 Qasja në rrjetin e ujësjellësit


	Vendbanime/Banorë me qasje në rrjetë të ujësjellësit	Numër	%
1	Vendbanime	43	
2	Banorë (rezident dhe jo rezident)	93,316	
3	Vendbanime me rrjet të ujësjellësit	21	48.8%
4	Vendbanime me rrjet të ujësjellësit funksional dhe pjesërisht funksional	18	41.9%
5	Vendbanime nën menaxhim të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.a	14	32.6%
6	Banorë që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit	70,927	76.0%
7	Banorë që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit funksional dhe pjesërisht funksional	60,196	64.5%
8	Banorë që kanë qasje në rrjet të ujësjellësit funksional dhe pjesërisht funksional nën menaxhim të KRU	53,066	56.9%

Prej tyre 7 vendbanime ose 41% furnizohen me ujë nga burimet (me anë të gravitacionit), kurse 11 vendbanime ose 59% furnizohen me ujë me anë të sistemit të pompave që rrit koston e mirëmbajtjes për m³ të ujit të harxhuar.

2.2.5.2. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza)

Rrjeti i kanalizimit në qytetin - Pjesa më e madhe e qyteti të Suharekës ka sistem e kanalizimit fekal dhe atmosferik. Rrjeti i kanalizimit fekal është i shpërndarë më shumë (L=8.096m) se rrjeti i kanalizimit atmosferik (L=2.031m), gjersa të gjithë ujërat e zeza, pa përjashtim, shkarkohen në lumit e qytetit, në Toplluhë. Shkatërrimi bëhet pa ndonjë trajtim paraprakë duke e ndotur ujin e lumit.

Rrjeti i kanalizimit në fshatra -Vetëm 11 ose 23% të fshatrave kanë rrjet të kanalizimit fekal, gjersa pjesa tjetër e fshatrave 30 ose 63% nuk kanë rrjet të kanalizimit. Grupi i dytë i fshatrave, shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë numër gropa klasike, nëpër jaze ose kanale sipërfaqësore, kurse shtëpitë ose grup shtëpisë që kanë afër lumenj shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë drejtpërdrejt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.



Harta 15 Vendbanimet që kanë dhe që nuk kanë rrjet (sistem) të kanalizimit

2.2.5.3. Energjetika

Qyteti i Suharekës me rrethinë furnizohet nga nënstacioni NS Suhareka 110/35/10(20) kV nga dy transformator me fuqi totale të instaluar prej $2 \times 31.5 = 63$ MVA ku:

- T1-110/35/10 kV me fuqi 31.5 MVA
- T2-110/10(20) kV me fuqi 31.5 MVA

Ky trafostacion furnizohet përmes linjave 110 kV, konkretisht linjave të paraqitura në figurën në vijim:

- Linja nr. 179/2 NS Suhareka-NS Ferizaji 1.
- Linja nr. 179/3 NS Suhareka-NS Prizreni 3
- Linja nr. L158 NS Suhareka-NS Rahoveci¹⁵.

Nënstacioni Suhareka është rindërtuar në tërësi dhe tani i gjithë konsumi i qytetit dhe rrethinës së Suharekës do të furnizohet nga ky nënstacion, pasi që edhe daljet të cilat kane qenë nga nënstacioni 35/10kV janë transferuar në nënstacionin 110/35/10(20) kV Suhareka.



Figura 1 Shtrirja e linjave transmetuese energjetike 110kV në Suharekë

Daljet 10(20)kV do të i furnizojnë të gjitha kategoritë e konsumatorëve dhe për një kohe të ardhme të afërt i plotësojnë nevojat për energji të këtyre konsumatorëve të cilët numerikisht nga të dhënat e KEDS-it janë:

Tabela 36 Numri i klientëve të KEDS-it sipas konsumatorëve

Klient të amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
14,389	129	2,504

Për furnizimin e konsumatorëve në amvisëri në të gjitha lokalitetet e komunës së Suharekës është instaluar një fuqi përafërsisht prej 68.5MVA, fuqi kjo e instaluar e pa mjaftueshme për ti mbuluar nevojat e tanishme të këtyre konsumatorëve, kur kihet parasysh që edhe në kategorinë e konsumatorëve komercial ka kërkesë për shtim të konsumit. Për ti plotësuar këto mungesa nevojitet të instalohen trafo të reja me kapacitet prej afro 11.2 MVA në sektorin e amvisërisë në nivelin e tensionit 10(20)/04 kV, pa përfshirë këtu edhe konsumatorët komercial.

Me zëvendësimin e trafo stacionit T1 110/10kV që ka fuqi 31.5MVA, me një trafo të re trup shtjellore T1 110/35/10kV me fuqi 40 MVA sipas planit zhvillimor afatmesëm, do të arrihet të plotësohet kërkesa për fuqi

¹⁵ Ky largpërçues është në ndërtim e sipër dhe pritet të aktivizohet Brenda vitit



për lokalitetet e komunës që furnizohen nga ky nënstacion, nga aspekti i sigurisë së furnizimit ose siç quhet në gjuhën e teknikës mund të plotësohet kriteri “n-1”. Ky kriter tani për tani nuk plotësohet sepse:

- Dy njësit transformuese në anën sekondare nuk kanë të dy nivelet e tensionit, pra njëri trafo mundëson transformim vetëm në nivelin 110/35 kV, kurse tjetra njësi nivelet 110/10 kV dhe 110/35 kV
- Dalja nga puna e njërit transformator nuk mund të kompensohet me tjetrin që ka mbetur në punë, si për shkak të përshkruara në pikën 1, e gjithashtu fytit të ngushtë transformues.


Sa i përket zhvillimeve të rrjetit Elektrik të Tensionit të Mesëm 10(20) kV, pjesa dërmuese e rrjetit distributiv të qytetit të Suharekës si dhe vendbanimeve të kësaj komune, furnizohet në nivelin 10 kV, konkretisht njëmbëdhjeta dalje 10 kV-she. Me ndërtimin e nënstacionit 110/35/10(20) kV daljet të cilat kane qene nga nënstacioni 35/10 janë transferuar në nënstacionin Suhareka.

Fuqia e instaluar në nivelin 10/04 kV është 68.4 MVA, ndërsa ngarkesa aktuale e daljeve është përafërsisht 36.8 MVA. në tabelën 2 janë paraqitur stabilimentet energjetike të niveleve 110/35/10(20)kV.

Tabela 37 Transformatorët 110/35/10 kV dhe linjat 110 kV dhe 10 kV

Linjat 110 kV			
	Linja 110 kV NS Suhareka –NS Ferizaji 1.		30.425 km
	Linja 110 kV NS Suhareka –NS Prizreni 3.		8.862 km
	Linja 110 kV NS Theranda –NS Rahoveci.		16.447 km
Trafo T1- 110/10(20) kV - 31.5 MVA		Trafo T2- 110/35/10(20) kV - 31.5 MVA	63 MVA
Linjat ajrore dhe kabllorike 10(20) kV			
1.	Suhareka	Dalja 10 kV	Mushtishti
2.	Reshtani	Budakova	Gjinovci
3.	Peqan	Studenqani	Shiroka
4.	Shirokë		Mamushë
			P _{inst} -daljeve 68.4 MVA

Në nivelin e tensionit të mesëm shumica e objekteve të instaluar elektro energjetike janë për tension 10kV. Fuqia e instaluar komplete transformuese 10/0,4 [kV/kV] si u cek më herët është 48,01 [MVA]. Ngarkesa aktuale në këto dalje është 36.64 [MVA].



Harta 16 Shtrirja e rrjetit të energjisë elektrike



Linjat furnizuese të tensionit të mesëm janë të dimensionuar kryesisht për nivelin 10 kV. Këto linja janë kabllorike të realizuara me shtrirje të lirë, dhe ajrore të montuara në shtylla të impregnuara të drurit (SHD), në shtylla të betonit (SHB), e në disa ekziston kombinim i tyre (SHBD). Ekzistojnë 11 linja furnizuese 10 kV-she.

Në disa nga trasat e linjave 10 kV dhe 0.4 kV, me shtylla të drurit, lartësia e përçuesve elektrik është e ulët, distanca me objektet e banimit, afariste dhe shoqërore e pamjaftueshme, kalimet në rrugë janë joadekuate, kështu që nuk i përmbushin kriteret nga aspekti i sigurisë.

Në kuadër të planeve zhvillimore kompanitë energjetike të Kosovës KEDS dhe KOSTT kanë publikuar planet e tyre zhvillimore që përfshinë një periudhë kohore nga viti 2017 deri në vitin 2020, përkatësisht 2026. Projektet që janë përfshirë në këto plane janë paraqitur në tabelën 36 dhe 37.

Tabela 38 Lista e projekteve për realizim nga KEDSI-i në periudhën kohore 2016-20 në Suharekë

Projektet në realizim e sipër dhe në proces të tenderimit (kategoria: përforcim rrjeti)			
N	Emërtimi i Projektit	Përshkrimi teknik	Viti
5	Linja e re 110kV NS Rahoveci – NS Suhareka	- 15 km, Al/Çe 240 mm ² , - Fusha e linjës 110 kV në NS Suhareka, Projekti ndërlidhet me projektin e ri-vitalizimit të pajisjeve të TL në NS Rahoveci	Q4: 2018
Projektet në realizim e sipër dhe në proces (kategoria: ri-vitalizimit të nënstacioneve)			
Nr	Emërtimi i Projektit	Përshkrimi teknik	Viti
3	Ri-vitalizimi i pajisjeve të TL në NS Suhareka	Ndërrimi i dy fushave të linjave 110 kV, dhe një fushe lidhëse 110 kV. Kalim në sistem të zbarave të dyfishta. - Ndërrimi i dy fushave transformatorike 10 kV dhe një 35 kV. Projekti do të koordinohet me projektin e linjës së re: Rahovec- Suharekë	Q4: 2018
Lista e projekteve të planifikuara për përforcimin në rrjetin e transmisionit 2017-2026			
Nr	Emërtimi i Projektit	Përshkrimi teknik	Viti
6	Zëvendësim transformatori në NS Suhareka, T1=31.5 MVA	Transformator TR2 110/10(20) kV, 40 MVA. Siguria e furnizimit të konsumit të Suharekës; Plotësim i kriterit N-1 në Transformim. Reduktim i humbjeve në shpërndarje.	Q2-2022

Tabela 39 Lista e projekteve për realizim nga KOSTT-i në periudhën kohore 2017-26 në Suharekë

Projekti 3012			
Nr.	Kategoria e projektit	Objektiva:	Implementimit
3012	Zvogëlimin e humbjeve teknike Daljet e përfshira: Mushtishti	Zgjidhja e problemit të mbingarkesës të linjave, zvogëlimin e humbjeve teknike dhe rënies të tensionit dhe rritjen e qëndrueshmërisë	2020
Investimi i propozuar: Një largpërçues i ri duhet të instalohet në të njëjtën rrugë të linjës ekzistuese të daljes Mushtishti deri në lokacionin e propozuar për stabiliment shpërndarës të ri me zbarrë të dyfishtë. Dy degët e kësaj dalje që furnizojnë fshatrat Vraniq dhe Dubravë do të furnizohen nga ky trafostacion i ri. Edhe një kiosk duhet gjithashtu të instalohet në lokacionin e paraqitur. Ky kiosk do të furnizojnë degët për fshatrat Maqiteve dhe Baqevc.			
Projekti 3013			
Nr.	Kategoria e projektit	Objektiva:	Implementimit
3013	Zvogëlimin e humbjeve teknike. Daljet e përfshira: Peqani	Zgjidhja e problemit të mbingarkesës të linjave, zvogëlimin e humbjeve teknike dhe rënies të tensionit dhe rritjen e qëndrueshmërisë	2018
Investimi i propozuar: Është propozuar të ndërtohet një kiosk i ri afër fshatit Peqan. Seksioni i linjës i daljes ekzistuese Peqani deri në këtë kiosk të ri duhet të përmirësohet / vendoset në 70mm ² .			



Projekti 3014			
Nr.	Kategoria e projektit	Objektiva:	Implementimit
3014	Zvogëlimin e humbjeve teknike. Daljet e përfshira: Studenqani	Zgjidhja e problemit të mbingarkesës të linjave, zvogëlimin e humbjeve teknike dhe rënies të tensionit dhe rritjen e qëndrueshmërisë	2018
Investimi i propozuar: Një kioske e re duhet të instalohet në lokacionin e propozuar afër fshatit Studenqan. Linja kryesore aktuale deri në këtë kioske duhet të rritet (pjesa ekzistuese e dyfishtë 50mm ² duhet të rritet në 70mm ² , i ri duhet të ndërtohet pas asaj në kioske). Kioski do të furnizoj degët perëndimore dhe veriore të daljes. Seksioni i degës perëndimore duhet gjithashtu të rritet në 50mm ² .			

2.2.5.4. Telekomunikimi

Sa i përket telefonisë fikse, dhe në përgjithësi infrastrukturës së telekomunikacionit, gjendja në komunën e Suharekës është shumë e keqe. Vendbanimet e vetme që kanë qasje në shërbimet e rrjetës së telefonisë fikse janë:


- Suhareka me 1130 numra telefonik,
- Mushtishti me 250 numra telefonik;
- Samadrexha me rrjet të ri të telefonisë fikse.

Ky kapacitet është i vogël sepse vetëm rreth 45% të banorëve të Suharekës dhe dukshëm më pak se 27% të banorëve të Mushtishtit kanë rrjete të telefonisë fikse.

Rrjeti ekzistues i Telefonisë Fikse i cili siç u tha është i shpërndarë vetëm në lokalitetet e lartpërmendura, duhet të përmirësohet dhe kompletohet me qellim që t'i ofroj shërbimet përkatëse në ato lokalitete si dhe të instalohen në ato tjerat ku nuk ekziston.

Rrjeti i ekzistues i kabllit Optik i cili është i shtrirë në relacionin:

- Shtime-Duhel-Suharekë-Prizreni.
- Duhet të zgjerohet duke implementuar projekte të zhvillimit të kësaj rrjete në drejtimet përkatëse
- Duhel-Bllacë-Malishevë.
- Suharekë-Reshtani-Studeniqan-Samadrexhë.
- Suharekë -Shirokë-Sopi-Dubravë-Mushtisht.
- Suharekë-Peqan
- Topliqan-Terrnje.



Harta 17 Infrastruktura e telekomunikimit në Komunën e Suharekës



Duhet theksuar se valët e telefonisë mobile e mbulojnë pothuaj tërë territorin e komunës së Suharekës dhe kjo nënkupton mbulueshmeri nga të gjithë operatorët e telefonisë mobile që kanë licence operimi.

Gjithashtu në këtë kuadër duhet të parashihet shtrirja e kabllit optik deri në të gjitha lokacionet e komunës së Suharekës ku do të mundësoj qasjen e të gjithë akterëve ashtu qe:

- Mundësia e operimit me shërbimet e internetit të çdo shkolle, kabineteve të informatikës .
- Shërbimi FTTH për secilën shtëpi për shërbime përkatëse.
- Lidhja e qendrave(bashkësive) lokale me Kuvendin Komunal, zyra të ofiqarive etj.
- Lidhja e ambulancave lokale me qendrat përkatëse të mjekësisë.
- Lidhja e shërbimeve të emergjencave, stacioneve policore, gjykatave, stacioneve të furnizimit me ujë, infrastrukturës sportive etj., duke mundësuar integrimin e rrjetit për qëllime publike.

Përmes projekteve përkatëse për përmirësimin e shërbimeve dhe ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore do të realizohet ofrimi i shërbimeve telekomunikuese duke përfshi shërbimet:

- Voice-telefoni fikse,
- Data- internet dhe
- TV- televizionin me teknologji IPTV.


Këto shërbime do të ofrohen përmes brezit të gjerë ku si medium transmetues do të shfrytëzohet fibri optik i shtrirë kryesisht nëpër gypa plastik dhe kanale nëntokësore sipas parametrave teknik duke siguruar qasje dhe leje nga organet përkatëse komunale.

2.2.5.5. Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Suharekë bëhet nga ndërmarrja regjionale “Eco—Regjioni” në Prizren që menaxhon me 20 njësi shërbyese dhe “IS-Com” që menaxhon me 12 njësi shërbyese.

Tabela 40 Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit, 2019

Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i kontejnerëve (nr.)	Vëllimi i kontejnerëve (m ³)
9194	70	420



Harta 18 Zonat me shërbim të largimit të mbeturinave



Në Komunë janë dy njësi të grumbullimit të mbeturinave, me sipërfaqe prej 3.9ha për mbeturina inerte dhe 25ha për mbeturina sanitare.

Tabela 41 Menaxhimi me mbeturina, numri i klientëve sipas kategorive të klientëve, 2019

Gjithsej	Klient të amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
19,345	311	9,194	9,840

Gjenerimi i mbeturina në Komunën është 7.603 t/vit.

Tabela 42 Menaxhimi me mbeturina (t/vit), gjenerimi sipas kategorive të klientëve, 2019

Gjithsej	Klient të amvisërisë	Klient publik	Klient komercial
7,692	7,248	355	95

Në lokalitetet që janë nën menaxhim nuk ekzistojnë deponi ilegale ndërsa pjesët e pambuluara nga ky shërbim hedhjen e mbeturinave e bëjnë në pjesë të ndryshme.

Nuk ekziston një lokacion legal për deponi industriale, mbeturinat industriale hedhen në pjesë të ndryshme—në përroska, përgjatë vreshtave në Biraq, etj.

2.2.6. Infrastruktura e transportit dhe transporti


2.2.6.1. Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Mespërmes territorit të Komunës së Suharekës shtrihet Auto udha “Ibrahim Rugova” dhe magjistralla M25 (Prizren-Prishtinë), dhe për këtë arsye pozita e Komunës së Suharekës mund të përfitojë shumë nga zhvillimi i këtyre dy rrugëve dhe për këtë nevojitet të krijohet një strategji në nivelin qendror për të krijuar një shteg alternativ për udhëtarët nga Maqedonia drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Gjendja e rrugëve në Komunën e Suharekës është shumë e mirë dhe shumica e rrugëve në vendbanime i plotësojnë kriteret dhe standardet ndërkombëtare për gjerësitë e rrugëve.

Tabela 43 Shtrirja e rrugëve (km) në territorin e Komunës

Autoudhë	Nacionale	Regjionale	Lokale	Në vendbanime rurale	Në vendbanim urban
17.50	28.86	18.67	119.77	385.83	87.40



Harta 19 Rrjeti rrugor




2.2.6.2. Transporti publik komunal

Transportit publik automobilistik përfshihen 19 vendbanime me këto relacione:

Tabela 44 Vijat e transportit publik komunal

Suharekë — Bllacë;	Suharekë—Budakovë;	Suharekë—Vraniq;
Suharekë — Mushtisht;	Suharekë—Sallagrazhdë—Bajqecë;	Suharekë—Gjinoc;
Suharekë — Grejkoc;	Suharekë—Gelancë;	Suharekë—Leshan—Tërrnjë;
Suharekë — Nishor;	Suharekë— Dobërdolan;	Suharekë—Samadrexhë;
Suharekë — Neprebisht;	Suharekë—Luzhnicë—Javor.	Suharekë—Qadrak;
Suharekë — Papaz — Grejqec (vetëm dy herë në ditë).		

Vendbanimet që nuk janë të mbuluara me transport publik janë: Peqani, Sllapuzhani dhe disa fshatra të vogla si Stravuqina, Dvorani, Delloci dhe Maqiteva. Transporti publik realizohet nga autobusët dhe kombi busët ndërsa ky qarkullim zhvillohet prej 3 deri 15 herë në ditë varësisht prej vendbanimit.



Harta 20 Vijat e qarkullimit të transportit publik



2.2.7. Infrastruktura publike dhe sociale

2.2.7.1. Ndërtesat publike

Ndërtesat administrative dhe publike janë të përqendruara në pjesën më të madhe në qytetin e Suharekës, si qendër komunale. Në këtë qytet janë të shtrira institucionet e nivelit komunal si Kuvendi i Komunës, Gjykata Komunale, Zyra Komunale e Punësimit, zyra e Postës dhe Telekomit, shërbimet bankare, Stacioni i Autobusëve, Zjarrfikëset dhe Stacioni Policor. Ndërkaq në vendbanimet tjera numri i këtyre institucioneve është tejet i vogël dhe përfshinë disa zyre të vendit dhe ofiqari nëpër disa fshatra, dy zyre postare në Samadrexhe dhe Mushtisht si dhe një stacion policor po ashtu në Mushtisht.

Një zhvillim i tillë i rrjetit të institucioneve publike ka bërë që banorët e komunës për kryerjen e shumicës së shërbimeve administrative të orientohen në qytet. Përqendrimi i këtyre shërbimeve në qendrën komunale në njërën anë si dhe ekzistenca e rrugëve të paasfaltuara në anën tjetër, bëjnë që qasja në ndërtesat publike të mos jetë gjithmonë e lehtë ndërsa shfrytëzimi i shërbimeve të jetë i kufizuar.

Tabela 45 Ndërtesat publike

Objekti / Institucioni	Lokacioni	Sipërfaqja e ngastrës	Sipërfaqja e zhvilluar	Etazhiteti	Viti i ndërtimit	Nr. i punësuarve
Kuvendi i Komunës	Suharekë	6736 m ²	1205 m ²	P+ 1	1948	162
Gjykata Komunale	Suharekë	1100 m ²	920 m ²	P+ 3	1974	46
Zyra Komunale e Punësimit	Suharekë	640 m ²	226 m ²	P+ 0	2015	5
Posta dhe Telekomit	Suharekë	2000 m ²	1580 m ²	P+ 1	1980	20
Stacioni i Autobusëve	Suharekë	4485 m ²	3100 m ²	P+ 0	1977	12
Stacioni i Zjarrfikësve	Suharekë	1100 m ²	200 m ²	P+ 0	1970	17
Stacioni Policor	Suharekë	3700 m ²	950 m ²	P+ 1	1926	144
Qendra për Punë Sociale	Suharekë	1390 m ²	180 m ²	P+ 0	2002	13
Zyre lokale apo ofiqari	Mushtisht					
	Studençan					
	Duhël					
	Nishor					
	Mohlan					
	Bukosh					
	Gjinoc					
Zyre lokale postare	Mushtisht					
	Samadrexhë					
Stacion lokal policor	Mushtisht					

Një sfidë e vazhdueshme që e vështirëson kërkimin në këtë fushë është mungesa e të dhënave të sakta për personat me aftësi të veçanta. Të dhënat lidhur me personat me nevoja të veçanta janë të mangëta, jo të standardizuara dhe jo të kategorizuara sipas gjinisë, moshës, kategorisë së aftësisë së kufizuar, kohës së gjendjes, etj. Të dhënat ekzistuese nuk lejojnë një analizim më të detajuar të këtij grupi për shkak të numrit të kufizuar të përfaqësimit në përmbledhjen e të dhënave zyrtare. Gjithashtu, mungesa e një qasjeje të standardizuar për mbledhjen e të dhënave nuk jep mundësi për informata të nevojshme.

Megjithëse Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka nxjerrë një udhëzim administrativ me anë të të cilit obligohet rregullimi i kushteve teknike dhe mënyra e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me nevoja të veçanta, sërish në komunën e Suharekës nuk janë plotësuar këto kushte. Mungesa e pjerrinave, lartësia e trotuareve, përkatësisht guri skajor në afërsi të vendkalimeve për këmbësorë nuk i plotëson kushtet për këtë kategori të njerëzve.



2.2.7.2. Administrata publike

Shërbimet e administratës publike ofrohen përmes ndërtesës kryesore komunale në Suharekë dhe 7 bashkësive lokale rurale Suharekë, Mushtisht, Studençan, Duhël, Gjinoc, Nishor, Bukosh, Mohlan dhe, të cilat ofrojnë distanca të shkurta nga vendbanimet të cilat i shërbejnë.

Tabela 46 Institucionet administrative dhe të sigurisë publike sipas vendbanimeve, 2019

Vendbanimet	Institucioni	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i banorëve
Suharekë	Kuvendi Komunal	1944	Të gjitha vendbanimet	88,181
Gjinoc	Bashkësi lokale	2010	Gjinoc, Gelancë, Grejkoc, Leshan, Sallagraxhdë, Dubravë	14,752
Suharekë	Bashkësi lokale	1944-45	Suhareka, Reshtan, Peqan, Sllapuzhan, Reqan, Sopijsë	26,846
Bukosh	Bashkësi lokale	2010	Bukosh, Vraniq, Popolan, Savrovë	6,975
Duhël	Bashkësi lokale	2010	Duhël, Bllace, Grejqec, Javor, Luzhnicë, Çadraq, Dragaçinë	8,754
Mohlan	Bashkësi lokale	2010	Mohlan, Budakovë, Buzhal, Vërshec, Krushicë e epërme, Krushicë e poshtme, Papaz, Stravuçinë	5,187
Nishor	Bashkësi lokale	2010	Nishor, Kastërc, Semetishtë, Breshancë	4,481
Studençan	Bashkësi lokale	1945	Studençan, Dobërdelan, Neprebishtë, Samadraxhë, Tërrnje	14,549
Mushtisht	Bashkësi lokale	1945	Mushtisht, Dvoran, Delloc, Maçitevë	6,637

2.2.7.3. Institucionet arsimore

Në nivel komunal, procesi arsimor zhvillohet në tri nivele, arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Sistemi Edukativ e Arsimor në Komunën tonë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (SNKA):

- Niveli 0: Arsimi parashkollor (moshat 3 deri në 6 vjet).
- Niveli 1: Arsimi fillor (faza e parë e arsimit bazë) për 5 vjet (moshat 6 deri në 12 vjeç).
- Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët (faza e dytë e arsimit bazë) për 4 vjet (moshat 12 deri në 15 vjeç); dhe
- Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë për 3 ose 4 vjet, varësisht nga programet arsimore të përcaktuara nga MASHT (normalisht moshat 15 deri në 19 vjet).

Rrjeti i ndërtesave të arsimit përbëhet prej 29 shkollave për Arsimi Fillor dhe të Mesëm i Ultë dhe në 3 shkolla të Arsimit të Mesëm të Lartë, ku përfshihen 11,522 nxënës, ndërsa në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar rreth 1000 të punësuar, prej tyre 786 mësimdhënës dhe 38 edukatorë si dhe stafi udhëheqës, administrativ dhe mbështetës teknik.

Tabela 47 Veçoritë e institucioneve të arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ultë (2019)

Numri i institucioneve	Numri i banorëve	Numri i nxënësve	Numri i mësimdhënësve	Numri i edukatorëve	Sipërfaqja e parcelave	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e gjelbër (ha)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
46	65,851	8,693	576	31	33.93	5.76	29.56	29.56	87	82



Tabela 48 Veçoritë e institucioneve të arsimit të mesëm të lartë (2019)

Numri i institucioneve	Numri i banorëve	Numri i nxënësve	Numri i mësimdhënësve	Numri i edukatorëve	Sipërfaqja e parcelave	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e gjelbër (ha)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
3	65,851	3,134	188	0	6.70	1.49	5.50	5.5	20	20

Grupi Punues për hartimin e “Planit Zhvillimor të Arsimit të Komunës së Suharekës 2020-2028”, pas diskutimeve që ka pasur, ka vendosur që në kuadër të këtij plani zhvillimor të arsimit të përfshihen pesë fusha të cilësisë të rëndësishme të organizimit të arsimit në të gjitha nivelet përmendura në vijim:

1. Menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë
2. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve
3. Pajisjet dhe infrastruktura shkollore
4. Kultura dhe mjedisi shkollor
5. Performanca e nxënësve

Analiza SWOT është përdorur për analizën e gjendjes në këto pesë fusha, në mënyrë që të identifikohen sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për secilën nga këto fusha të përfshira në këtë plan zhvillimor të arsimit.

2.2.7.4. Institucionet shëndetësore

Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Suharekës është i organizuar në tri nivele, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Suharekë, qendra të mjekësisë familjare 6 njësi në Mushtisht, Studenqan, Gjinoc, Duhël, Mohlan dhe Bukosh si dhe ambulanca 5 njësi në Grejkoc, Samadraxhë, Sopi, Nishor dhe Dobërdolan.

Sipërfaqet e ndërtesave shëndetësore dallojnë në varësi të nivelit të shërbimit. Sipërfaqet e ambulancave sillen prej 95 deri 140 m² ndërsa sipërfaqet e QMF prej 205 deri në 325m². QKMF në Suharekë ka rreth 2270m², sipërfaqe kjo e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e pacientëve që gravitojnë në këtë qendër.

Tabela 49 Veçoritë e institucioneve të shëndetësisë

	Numri i institucion.	Mjek të përgjithshëm (nr.)	Mjek në specializim (nr.)	Mjek të specializuar (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	Kapaciteti i shtretërve
AMF	12	12	0	0	2.92	1.48	3.92	14
QMF	5	7	2	2	1.57	1.05	1.99	11
QKMF	1	1	3	12	0.66	0.14	0.52	9

2.2.7.5. Institucionet e mirëqenies sociale

Spektori Mirëqenies Sociale në baza ligjore dhe sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative zbaton politikat nacionale dhe zhvillon aktivitete planifikuese dhe shërbyese për kategoritë më të cënueshme sociale. Në bazë të ligjit për shërbime sociale dhe të familjes ofrohen shërbime sociale për të gjitha kategoritë sociale që kanë nevojë për mbrojtje institucionale. Ndërsa në bazë të Ligjit të Skemës së Asistencës Sociale familjet në nevojë ekonomike përkrahën me mjete financiare të rregullta mujore.



Përveç kësaj, nga subvencionet e komunës mbështeten persona dhe familje me nevoja emergjente të natyrës socio-ekonomike, shëndetësore apo të kushteve të banimit.

Tabela 50 Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit

Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit	Sipërfaqja (m ²)
Qendra për punë sociale	200 m ²
Zyra Komunale e Punësimit (hapësira e përzier komunale)	/
Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore	300 m ²
Kryqi i Kuq i Kosovës	135 m ²

Tabela 51 Kategoritë e personat në nevojë për asistencë sociale (burimi i të dhënës DSHMS)

Personat në nevojë - kategoritë	Numri i banorëve
Fëmijë pa përkujdesje prindërore	4
Fëmijë me sjellje asociale	2
Delikuent të mitur	35
Persona me marrëdhënie të çrregulluara në familje	9
Persona të moshës së shtyrë	4
Persona me sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike	6
Persona me të aftësive të kufizuara mendore	2
Persona me sëmundje mendore	3
Persona me rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi	/
Viktima të dhunës në familje	8
Viktima të trafikut të qenieve njerëzore	/
Persona me varësi nga alkooli ose drogat	/
Viktima të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu	/
Kategori të tjera.	491

Tabela 52 Kategoritë e personave të mbrojtur (burimi i të dhënës DSHMS)

Kategoritë mbrojtëse	Rastet e aktive	Rastet e reja	Gjithsejtë
Delikuenca e të miturve	25	10	35
Fëmijët me sjellje asociale	2	0	2
Fëmijë të keqtrajtuar	13	2	13
Fëmijët e braktisur të porsalindur	0	0	0
Fëmijët pa përkujdesje për strehim	22	0	22
Fëmijë me nevoja të veqanta	20	0	20
Kujdestaria ndaj fëmijëve	3	0	3
Kërkesa për adoptim	2	0	2
Dhuna në familje	8	0	8
Viktima të trafikimit	0	0	0
Çrregullimet bashkëshortore	8	0	8
Familje strehuese	1	0	1
Mbrojta e personave të moshuar	2	0	2
Klient tjerë	491	0	491
Puna e rrezikshme	0	0	0
Përdoruesit e substancave narkotike	0	0	0
Përdoruesit e alkoolit	1	0	1
Martesa e të miturve	5	1	5
Gjithsej	603	13	613

Aktualisht në Komunë janë 545 familje dhe 2780 anëtarë të familjeve që mbështeten në ndihma të skemës sociale.



2.2.7.6. Institucionet kulturore

Në institucionet kulturore të Komunës janë gjithsejtë 16 të punësuar: 1 në sektorin për kulturë, 1 në sektorin për Trashëgimi Kulturore – Muzeu i qytetit, 1 në sektorin për mërgatë, 1 në sektorin për rini, 4 në bibliotekën Komonale, 1 në Shtëpinë e Kulturës në Suharekë, dhe 8 në Qendrën për edukim kreativ - Shtëpia e Fellbahut.

Në nivel komunal, institucionet kulturore përbëhen prej 6 shtëpi kulture dhe atë:

- Një bibliotekë komunale;
- Katër qendra të rinisë;
- Një muze qyteti;

Tabela 53 Veçoritë e hapësirave kulturore

Numri i institucioneve	Numri i banorëve	Sipërfaqja e parcelave (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	Vendpark. për vizitor	Vendpark. për zyrtar	Sipërfaqja e gjelbër (ha)
6	65350	25308	2960	4160	17	10	2030

2.2.7.7. Institucionet sportive

Në institucionet sportive të Komunës janë gjithsejtë 3 të punësuar: 1 në sektorin për sport, 1 në stadiumin e qytetit, 1 në Palestrën Sportive "13 Qershori". Në nivel komunal, institucionet sportive përbëhen prej:

Tabela 54 Kategorizimi i hapësirave sportive

Stadiume Sportive		Salla Sportive		Fusha sportive	
Funksional	Jofunksional	Publike	Shkollore	Publike	Shkollore
2	4	3	7	4	27

Tabela 55 Veçoritë e hapësirave sportive

Numri i institucioneve	Numri i banorëve	Sipërfaqja e parcelave (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	Vendpark. për vizitor	Vendpark. për zyrtar	Sipërfaqja e gjelbër (ha)
49	63,416	50,7941	7.8524	24.5407	289	3	2.1765

2.2.7.8. Varrezat publike


Hapësira të dedikuara për varrezat në Komunën e Suharekës në shumicën e vendbimeve janë të pajaftueshme. Parcelat e varrezave një pjesë e parcelave janë në pronësi të Bashkësisë Islame por pjesa më e madhe janë në pronësi publike.

Tabela 56 Veçoritë e institucioneve fetare

Vendbanimi	Institucioni Fetar	Viti themelimit	Lagjja/zona gravituese	Banorë
Suharekë	Xhamia Suharekë	1520	Qendra qytetit	12,362
Studenqan	Xhamia Studenqan	1707	Qendra fshatit	3,617
Bllacë	Xhamia Bllacë	1710	Qendra Fshatit	3,598
Samadrexhë	Xhamia Samadraxhë	1802	Qendra fshatit	3,486
Sopijë	Xhamia Sopijë	1912	Qendra fshatit	3,475
Mushtisht	Xhamia Mushtisht 1	1720	Qendra Lindore	3,400
	Xhamia Mushtisht 2	2002	Në perëndim	
Greikoc	Xhamia Greikoc	1730	Qendra Fshatit	2,655
Peqan	Xhamia Peqan	1882	Qendra fshatit	2,513
Gjinoc	Xhamia Gjinoc	1942	Qendra fshatit	2,264
Vraniq	Xhamia Vraniq	1740	Qendra Fshatit	2,150
Shirokë	/	/	/	1,930



Vendbanimi	Institucioni Fetar	Viti themelimit	Lagjja/zona gravituese	Banorë
Budakovë	Xhamia Budakovë	1873	Qendra Fshatit	1,856
Duhël	Xhamia Duhël	2005	Guri verdhë	1,855
Leshani	Xhamia Leshan	1527	Qendra fshatit	1,748
Semetisht	Xhamia Semetisht	1803	Qendra fshatit	1,688
Sallagrazhdë	Xhamia Sallagrazhdë	1969	Qendra fshatit	1,408
	Kisha e Sallagrazhdës	1977	Hyrje të fshatit	
Nishor	Xhamia Nishor	1765	Qendra fshatit	1,291
Reqan	Xhamia Reqan	1969	Qendra fshatit	1,278
Bukosh	/	/	/	1,274
Gelancë	Xhamia Gelancë	2008	Qendra fshatit	1,225
Doberdelan	Xhamia Doberdelan	1967	Qendra fshatit	1,218
Reshtan	/	/	/	1,214
Savrovë	/	/	/	1,127
Sllapuzhan	/	/	/	1,121
Tërnje	/	/	/	927
Dubravë	Xhamia Dubravë	2017	Qendra fshatit	849
Neprebisht	Xhamia Neprebisht	1955	Qendra Fshatit	820
Greqec	Xhamia Greqec	1897	Afer Shkolla	617
Javor	/	/	/	524
Krushica Poshtme	/	/	/	482
Mohlan	/	/	/	475
Kasterci	/	/	/	467
Maqitevë	Xhamia Maqitevë	2012	Qendra fshatit	454
Breshanc	/	/	/	365
Papaz	/	/	/	311
Popolan	/	/	/	274
Staravuqinë	/	/	/	271
Draqaqine	/	/	/	230
Krushica Epërme	/	/	/	192
Vershec	/	/	/	186



Harta 21 Lokacionet e varrezave



2.2.8. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

2.2.8.1. Mjedisi dhe Ndotja mjedisore

Ndotja e mjedisit në tërë territorin e Kosovës është problem mjaft serioz dhe është prezent pothuaj kudo. Po ashtu edhe në komunën e Suharekës kjo çështje është evidente. Ndotja më e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj. Gjithashtu hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Në mes të Reshtanit dhe Neprebishtit në lum bëhet eksploatimi i rërës. Për shkak të nevojave për djegie por edhe për ekonomi pyjet dëmtohen pa kriter nga fshatarët.

Ajri

Edhe pse nuk monitorohet e nuk dihet se cilët përbërës ndotës të ajrit dhe sa janë prezent në të, ai është i ndotur në qendrën urbane. Kjo ndotje shkaktohet nga pluhuri, si pasojë e djegies industriale si dhe komunikacioni (gazrat e liruara nga makinat e vjetra dhe pa katalizator). Koridori i autoudhës Morinë-Merdare që kalon në krah të qytetit e ka zvogëluar dukshëm lëvizjen e automjeteve që kalojnë brenda qytetit. Por në kohe festash dhe ngarkesave tjera në vere dhe dimër ende ka ngarkesë të theksuar të automjeteve, kjo edhe për shkak të mungesës së një rruge unazore që do të devijonte trafikun e automjeteve që kalojnë nëpër magjistralen kryesore që lidhë Prishtinën me Prizrenin. Duke marrë parasysh që në Suharekë nuk ka rrjet të ngrohjes qendrore, të gjitha njësitë e banimit ngrohen përmes burimeve alternative si drunj, thëngjill, naftë që kanë impakt në ndotje të ajrit.

Tabela 57 Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje të njësive të banimit

Gjithsejtë	Dru	Pelet	Thëngjill	Naftë	Gaz	Energji elektrike	Tjetër lloj energjie
11001	8500	650	100	40	10	1700	1


Uji

Lidhur me ujin e pijes disa vendbanime kanë probleme sepse nuk kanë qasje në sistemin e ujësjellësit dhe ujin e pijes e marrin nga pusët individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk mirëmbahen si duhet. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësor (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës. Në komunën e Suharekës 40% e banorëve kanë qasje në ujësjellës dhe në sistemin e kanalizimit janë të kyçur 45% e banorëve.

Toka

Në këtë komunë toka është e ndotur nga prania e deponive ilegale të mbeturinave ku vetëm 43% e popullatës janë përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave. Mirëpo është duke u punuar në implementimin e projektit për eliminimin e deponive ilegale dhe transferimin e mbeturinave në deponinë regjionale të Prizrenit. Degradimi i tokës shkaktohet edhe nga prerja e pyjeve dhe funksionimi i gurëthyesve si dhe shfrytëzimi i inerteve në lumenj.

Mbrojtja e mjedisit ndërlihet, me sektorin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore (37 objekte natyrore nën mbrojtje), zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe ka efekt pozitiv në to, ndërsa me sektorët tjerë është në konflikt e sidomos me atë të industrisë, sepse industria ka ndikim negativ në mjedis.



Harta 22 Ndieshmëria mjedisore e tokës

2.2.9. Sipërfaqet me rrezikshmëri

2.2.9.1. Vërshimet

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedisit dhe Emergjencës në Komunën e Suharekës thuhet se lumi i cili kalon nëpër qytet është vazhdimisht si pikë me rrezikshmëri të lartë për qytetar, ku vite me radhë pas të reshurave të mëdha atmosferike ka përmbysur tokat e në disa raste edhe shtëpitë që kanë qenë përreth.

Vërshime të këtij lloji ka pasur edhe në disa fshatra si në: Semetisht, Studençan dhe Neprebisht por me një shkallë të rrezikshmërisë më të vogël.

Me rregullimin e kanaleve përcjellës, nga gryka e Dubiqakut dhe përroskave vërshuese nga drejtimi i Biraçit, në drejtim të Lumit Toplluha është bërë një zgjidhje e mirë për evitimin e vërshimeve për Suharekën.

Pasi që lumi Toplluha bënte shpesh vërshime, në pjesën që kalon nëpër qytet është bërë rregullimi i shtratit të tij. Shtrati i rregulluar është e formës katërkëndësh. Stomet e tij janë të veshur me gurë. Mirëpo, në pozicionin në mes të Suharekës dhe Mamushës (në komunën e Prizrenit), lumi Toplluha rrezikon që t'i vërshoj sipërfaqet e tokës bujqësore.



Për sa i përket erozionit, rrëshqitje të theksuara të tokës ka pasur në fshatin Vraniq, ku vitin e kaluar nga rrëshqitjet e mëdha të dheut janë rrezikuar pesë shtëpi të banimit. Gjithashtu lëvizje erozive të tokës kanë ndodhur edhe në vendin e quajtur “Gradina” në dalje të qytetit përreth rrugës kryesore për në Prizren, ku nga lëvizjet e tokës janë dëmtuar disa shtëpi. Lëvizje erozive të tokës por në masë më të vogël janë shënuar edhe në fshatrat: Vraniq, Peçan, Budakovë dhe Papaz.

1:240,000

N

Legjenda

- Erozioni i shume i forte
- Erozioni i forte
- Erozioni i mesem
- Erozioni i dobët
- Erozioni shume i dobët
- Zone pa erozion
- Lum
- Rruge magjistrale
- Rruge regionale
- Vendbanim
- Kufi komunal

2 1 0 2 4 Km

2.2.10. Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

55



Trashëgimia përfshin elemente materiale dhe jo materiale të cilat pasqyrojnë kulturën dhe kreativitetin e komuniteteve njerëzore që nga kohërat më të lashta, si dhe diversitetin e pasur dhe bukurit e mjedisve natyrore.

2.2.10.1. Asetet e trashëgimisë natyrore

Marrë në përgjithësi kushtet gjeomorfologjike të komunës janë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e saj të mëtejshme. Në territorin e komunës ka pasuri të lëndëve të para, të metaleve dhe jometaleve.

Minerali i kromit gjendet në disa vende por prania e tij është më e theksuar në zonën midis Mushtishtit dhe Grejkocit. Për ta zbuluar këtë mineral gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore janë bërë hulumtime në lokalitetet: Qafa e Malit për në Manastirin e Shën Treshit, Buhork, Leskë (mbi livadhe) në lindje nga Grejkoci tek Guri i Arave dhe në veri-lindje të xhamisë së Grejkocit. Një pjesë e vogël e kësaj hapësire është në kuadër të Parkut Nacional “Sharri”.

Minerali i hekurit ndodhet në shpatiet veriore të Rusenicës deri nën Rrafshin e Uthullave dhe gjendet pranë serialit të rrasave serpentine. Janë konstatuar tri shfaqje të magnetitit të cilat nuk tregojnë ndonjë orientim të caktuar dhe nuk janë të lidhura reciprokisht dhe shtrihen në një hapësirë të vogël në kuadër të parkut nacional.

Sa u përket jometaleve, në territorin e komunës së Suharekës ka argjilë, shkëmbinj karbonat dhe rrasa grafitë. Me rëndësi ekonomike janë argjila për përpunimin e tullave dhe shkëmbinj të karbonit për materiale ndërtimore. Grafitet gjenden në jug të fshatit Mushtisht në kontakt të terciarit dhe të rrasave klorite-sericite por depërtimi në thellësi i tyre nuk është hulumtuar. Gjithashtu në Biraq në bazë të hulumtimeve të bëra është gjetur një hapësirë ku mund të bëhet shfrytëzimi i gurit për prodhimin e materialit ndërtimor si bazë për asfalt. Kjo pjesë është 90% në pronësi private.

Sipërfaqja pyjore është 15.074 ha ose 41.7% e sipërfaqes së përgjithshme territoriale nga e cila në pronësi shoqërore 8,689 ha ose 57.6% si dhe në pronësi private janë 6,389 ha ose 42.4%. Pjesa më e madhe janë shkurre, kurse një pjesë e vogël pyje të larta gjetherënëse, me rritje vjetore 3.8m³/ha, kurse të pyjet e larta 3.05m³/ha.

Trashëgimia natyrore:

- Guri i Dellocit
- Burimi i ujit mineral në Reqan
- Rezervati natyror i Rusenicës
- Parku natyror Rahavan
- Lisi në Bllacë
- Parku Kombëtar i Malit Sharr

Mirëmbajtja e parqeve pyjore, dhe sidomos e parkut nacional “Sharri” që është mjaft i pasur me pyje halore, nuk është nën kompetencat e komunës, kjo bën që pasuritë natyrore të jenë nën mëshirën e fatit (vështirë të mbrojtura). Shfrytëzimi i resurseve të natyrës ndërlidhet më së shumti me sektorin e ekonomisë për shkak të përfitimeve të mëdha, zhvillimi ekonomik e posaçërisht me sektorin e industrisë, ndërsa me shumicën e sektorëve tjerë është në konflikt.

Tabela 58 Asetet e trashëgimisë natyrore nën mbrojtje

Lokacioni	Kategoria	I mbrojtur	Sipërfaqja (ha)
Rusenica	Rezervat i natyrës	X	300.00
Malet e Sharrit	Park kombëtar	X	39,000.00
Rahavane	Peizazh i mbrojtur	X	

Për shkak të rritjes ekonomike është i domosdoshëm të bëhet shfrytëzimi racional i resurseve, gjithmonë duke pasur parasysh ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Pyjet me të gjithë biodiversitetin e tyre në këtë komunë paraqesin një atraksion të posaçëm, duke pasur parasysh faktin se një pjesë e tyre është pjesë e Maleve të Sharrit, që gjendet në pjesën jug-lindore (në jug të Mushtishtit dhe të Dellocit) dhe përbëjnë 18 % të sipërfaqes që përfshihet në regjion të Prizrenit nga sipërfaqja e përgjithshme e parkut nacional “Sharri”.

2.2.10.2. Asetet e trashëgimisë kulturore dhe turistike

Përgjatë zonës së gjerë të komunës së Suharekës janë regjistruar disa lokalitete arkeologjike, në disa prej të cilave janë kryer gërmime kohë pas kohe.

Reshtani është një vendbanim neolitik i pozicionuar në prapatokën e Suharekës (në aksin ku sot kalon autostrada Suharekë-Prizren). Ky lokalitet është hulumtuar në vitet 1966/67, gërmime të cilat kishin karakter sondazhi. Gjatë muajit mars të vitit 2011, një sipërfaqe e konsiderueshme e këtij lokaliteti është incizuar me instrumente gjeofizike dhe po gjatë këtij viti janë zhvilluar gërmime me karakter shpëtimi që kapte një sipërfaqe prej 250m². U evidentuan tri horizonte banimi të neolitit të mesëm dhe fillimit të neolitit të vonë (4200-3800 p.e.s.). Në shtresën kulturore të trashësisë 2 metra, janë zbuluar gjurmë të tri horizonteve të banimit të shtëpive me gjithë vatër dhe hendeqe. Në bazë të fragmenteve të qeramikës së zbuluar, si në formë, ashtu dhe në ornamentikë, është konstatuar se krahas Kulturës së Vinçës, kemi një prani shumë të fuqishme edhe të kulturës adriatikase të Danilos.

Lokaliteti arkeologjik i njohur si Hisar, i cili gjendet në një rrafshnaltë të gjerë dhe të sheshtë në mes të qytezës së Suharekës dhe Prizrenit, njihet si një lokalitet i rëndësishëm i popullit dardan. Ai ka ekzistuar që nga epoka e neolitit të vonë deri në epokën e hekurit dhe njëhej si një zonë e zhvilluar në epokën e bakrit. Kjo konfirmohet nga shumë artefakte të punuara nga bakri apo hekuri të cilat janë përdorur për kultivimin e tokës apo për rituale.

Nekropoli i Gjinocit, i cili ndodhet 200 metra në të majtë të rrugës nga Suhareka në Prizren, është i shënuar nga një kodrinë (tuma ilire) dhe është një zbulim unik i kulturës dardane i cili është konstruktuar gjatë periudhës së hekurit të vonë, sipas Guidës Arkeologjike të Kosovës.

Një lokalitet i ngjashëm arkeologjik u zbulua në afërsi të fshatit Shirokë, 1.5 kilometra në jug të Suharekës, me indikacione të konstruksioneve tipike të varrezave tumule, me formë rrethore dhe ndërtuar me dhe dhe gurë të lumenjve. Byzylykë krah dhe dore dhe varëse me ornamente mbresëlënëse u gërmuan nga ky nekropol që daton në shekujt 6-8 p.e.s.

Lokaliteti arkeologjik i tipit fortifikatë në Kasterc, i pozicionuar rreth 12 kilometra në veriperëndim të Suharekës (Therandës) respektivisht i njohur edhe si Hisari i Kastercit, është dëshmuar të jetë një qendër arkeologjike shumështrësore duke vazhduar shfrytëzimin që nga kohërat parahistorike, më saktësisht nga një vendbanim i mbrojtur eneolitik, e më pas riformësohet në një fortifikatë të kohës së perandorit Justinian dhe për t'u ripërdorur si një varrezë gjatë kohës së mesjetës. Në këtë lokalitet arkeologjik, hulumtimet e para me karakter sondazhi arkeologjik janë zhvilluar në vitin 1986, duke nxjerrë një pasqyrë të përgjithshme. Hulumtimet arkeologjike vazhduan edhe gjatë vitit 2010 dhe 2011 duke zbuluar një sipërfaqe prej rreth 500 metrash katrorë dhe nxorën në dritë një kishë paleokristiane dhe material të veçantë të luajtshëm arkeologjik, në përbërje si vegla pune prej hekuri, qeramikë, stoli, vathë, unaza, byzylykë, monedha etj.



Vazo kultit e gjetur në Reshtan, komuna e Suharekës, koha e Neolitit (foto:MKRS)



Ibrik me dy dorëza nga lokaliteti arkeologjik, shek. 8 deri shek. 6 para Erës sonë, komuna e Suharekës (foto:MKRS)

Figura 2. Gjetje arkeologjike në Reshtan

Në territorin e Komunës së Suharekës ka mjaft objekte të trashëgimisë kulturore ndërsa numri i përgjithshëm i tyre apo i lokaliteteve me vlerë kulturo-historike dhe mjedisore në komunën e Suharekës është diku rreth 75. Kur këtij numri i shtohen edhe objektet e propozuara për mbrojtje, siç janë: përmendorja e viktimave



civile të luftës dhe vendi i masakrimit të familjeve Berisha në Suharekë; përmendoret individuale ose kolektive të UÇK-së; shtëpia e Ramë Bllacës në Bllacë; kulla e Pashës në Mushtisht; kulla e Jonuz Tafollit në Qadraq; mullinjtë e Breshancit; mulliri i Dragaqinës; mulliri i Semetishtit; mulliri i Budakovës; mulliri i Suharekës etj. mund të thuhet se komuna jonë disponon me një pasuri të konsiderueshme të trashëgimisë. Këto objekte janë të shpërndara në tërë territorin e komunës, më një përqendrim më të shtuar në pjesët qendrore dhe lindore. Njëzetedy (22) lokacione të trashëgimisë arkitektuale janë nën mbrojtje të përkohshme¹⁶.

Tabela 59 Asetet e trashëgimisë arkitektuale nën mbrojtje

Lokacioni	Sipërfaqja (ha)	Gjendja	I mbrojtur
Kisha e Virgjëreshës se Shenjte në Hodegetri, Mushtisht			X
Kisha e Shën Gjergjit, Reçan			X
Manastiri i Treshit të Shenjte, Mushtisht			X
Gërmadhat e murgores në kodrën e Matos, Mushtisht			X
Gërmadhat e murgores Rusenica, Mushtisht			X
Rrënojat e kishës mesjetare në Mushtisht			X
Kështjella - Qyteti i Grajqevcit, Grajqevc			X
Shkolla fillore - Muzeu, Suharekë			X
Mulliri i Berishëve, Suharekë			X
Xhamia e Bardhe, Suharekë			X
Tyrbe Lezi, Suharekë			X
Mulliri i familjes Loshi, Vraniq			X
Mulliri i familjes Bytyqi, Breshanc Suharekë			X
Mulliri i vjetër i familjes Buzhala, Buzhalë			X
Mulliri i vjetër i Elez Ramë Buzhalës, Buzhalë			X
Xhamia e Budakovës, Budakovë			X
Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Qadraq			X
Shtëpia e Ibrahim Ramë Bllacës, Bllacë			X
Xhamia e fshatit *, Semetisht			X
Xhamia e Gazi Mehmed Pashës, Leshan			X
Shtëpia e Xhevdet Gashit, Dubravë			x
Shtëpia muze e Fadil Vatës, Sallagrazhde			x

Nëntë (9) lokacione të trashëgimisë arkitektuale janë nën mbrojtje të përkohshme.

Tabela 60 Asetet e trashëgimisë arkitektuale nën mbrojtje


Lokacioni	Sipërfaqja (ha)	Gjendja	I mbrojtur
Lokaliteti shumëstresor në Hisare, Hisare, Suharekë			X
Fortifikata/Kalaja "Hisari i Kastercit", Kasterc			X
Vendbanim Parahistorik dhe Antik e Vone në Reshtan, Reshtan			X
Tuma në Neprebisht, Neprebisht, Suharekë			X
Tuma Ilire në Leshan, Leshan, Suharekë			X
Tuma Ilire në Gjinoc, Gjinoc, Suharekë			X
Lokaliteti arkeologjik romak në Peçan të Ulët, Peçan i Ultë, Suharekë			X
Nekropoli mesjetar në Bllacë			X
Mbeturinat e të Dëftuarit të Shën Merisë në Peçan			X

¹⁶ Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2018-10.10.2019), 3409/2018-02, dt.03.10.2018



Sa i përket objekteve fetare në veçanti, si rezultat i zhvillimeve dhe ndikimeve të ndryshme në të kaluarën, ekzistojnë ndërtesa që u përkasin tri konfesioneve:

- islam (22 xhami - shumica të rinovuara pas luftës);
- ortodoksë (6 kisha) dhe
- katolik (një kishë).



Harta 25 Lokacionet e trashëgimisë kulturore

2.2.11. Banimi

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi është vendimtar për stabilitet social, ambient të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore në përgjithësi.

Duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës si aktiviteti themelor i vendbanimeve, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është komponentë i rëndësishme e zhvillimit ekonomiko-social, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi. Zona urbane e qytetit të Suharekës karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 38 banorësh/ha. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane.

Bazuar në regjistrimin zyrtar të banimit të vitit 2011, njësitë e banimit janë kryesisht në zonën rurale. Sipas të dhënave të DEBF në Suharekë, banesat sipas llojit dhe vendbanimit paraqiten si në Tabelën 59.

Tabela 61 Banesat sipas llojit, statusit të shfrytëzimit dhe tipit të vendbanimit nëpër Komuna / Urbane

Lloji i banesës	Gjithsej			Urban			Rural		
	Banesa	Ek. Fam.	Persona	Banesa	Ek. Fam.	Persona	Banesa	Ek. Fam.	Persona
Gjithsej	10,978	9,144	63,416	2302	1802	12,362	8676	7342	51,054
Banesa të zakonshme	9,621	9,137	63,416	2302	1802	12,362	7319	7335	51,026
Lloj tjetër banese	7	7	28	-	-	-	7	7	28



Njësitë e banimit me 5+ dhoma dominojnë në Komunë, duke vijuar me 4 dhomshe.

Tabela 62 Banesat sipas numrit të dhomave

1 dhomshe	2 dhomshe	3 dhomshe	4 dhomshe	5+ dhomshe
97	893	1, 314	2, 404	4, 413

Njësitë e banimit me 2 kate dominojnë në Komunë, duke vijuar me ato 3 kate, gjersa ndërtesat më të lartë është 6 deri 9 kate.

Tabela 63 Ndërtesat me të paktën një banesë të zakonshme të shfrytëzuar sipas llojit, dhe numrit të kateve

	Gjithsej	1	2	3	4	5	6 deri 9	10 deri 14	15 +
Suharekë	8603	1370	5597	1524	91	8	13	2	0
Për banim	8599	1368	5595	1524	91	8	13	2	0
Jo për banim	4	2	2	0	0	0	0	0	0

Shtëpitë e veçanta dominojnë, duke vijuar me shtëpitë dyshe.

Tabela 64 Ndërtesat e banimit sipas llojit

	Shtëpi e veçantë	Shtëpi dyshe	Shtëpi në varg	Ndërtesat e banimit me shumë njësi	Tjetër
Suharekë	8,394	124	46	42	4
Urban	1,287	61	29	40	2
Rural	7,107	63	17	2	2

Njësitë e banimit me 15 – 20 m² për kokë banori dominojnë, duke 12 -15 m².

Tabela 65 Numri i njësive të banimit sipas sipërfaqes (m²) për banor

deri në 4	4, 1-6, 0	6, 1-8, 0	8, 1-10	10, 1-12, 0	12, 1-15, 0	15, 1-20, 0	20, 1-25, 0	25, 1-30, 0	30, 1-40	Mbi 40
159	527	1,043	1,111	1,049	1,427	1,685	798	404	456	462

Në zonën rurale 1,544 njësi banimi janë të pabanuara, gjersa në zonën urbane vetëm 515 njësi banimi janë të pabanuara.

Tabela 66 Banesat sipas llojit, statusit të shfrytëzimit në zonë rurale dhe rurale

	E shfrytëzuar nga një apo më shumë banorë	E shfrytëzuar nga banorë që nuk janë përfshirë në regjistrim (personeli diplomatik etj.)	E shfrytëzuar nga banorë për qëllime të rastësishme apo përdorim dytësor, që nuk janë përfshirë në regjistrim	Banesë e pabanuar (e dedikuar për shitje, qira etj)	Lloj tjetër Banese
Urbane	1802	1	193	515	0
Rurale	7319	0	1359	1544	7

Njësitë e banimit me 1 dhomë të shfrytëzuar, vijuar me 2 dhoma shfrytëzimi.

Tabela 67 Numri i njësive të banimit sipas numrit të dhomave të shfrytëzuar për qëllime afariste

Gjithsej banesa	1	2	3	4	5+	Urban	Rural
160	114	38	4	1	3	74	86



Shumica e njësive të banimit të kanë sipërfaqe të vogla nën 20m², vijuar me sipërfaqet 31-40 m².

Tabela 68 Numri i njësive të banimit sipas sipërfaqes (m²)

		< 20	21-30	31-40	41-50	51-60	61-70	71-80	81-100	101-120	> 120
Gjithsej	160	52	15	32	14	10	13	8	6	3	7
1 dhomëshe	114	51	12	17	12	7	6	5	3	-	1
2 dhomëshe	38	1	3	15	1	2	6	2	3	2	3
3 dhomëshe	4	-	-	-	1	1	-	1	-	1	-
4 dhomëshe	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-
5+ dhomëshe	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3

Tabela 69 Gjendja faktike – analiza në formë tabelare

KOMUNA E SUHAREKËS			
Nr. i popullsisë		89,085	
Zonat rurale		73,358	
Zonat urbane		15,727	
Nr. i fshatrave/nr. i lagjeve		43	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999		8274
	Nr. objekteve pas 1999		9460
	Etazhiteti mesatar		P+1
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. Objekteve	22
		Nj. Banimi	330
	Pas 1999	Nr. Objekteve	43
		Nj. Banimi	774
	Etazhiteti mesatar		P+6
Statusi pronësor (banim kolektiv) para 1999		Privat [nj. banimi]	280
		Shoqëror [nj. banimi]	50
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]		9	
Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]		100	
Nr. i objekteve të pabanuara		0	
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim		0	
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]		70%	
Ndërtimet ilegale	mbindërtimet		5,100
	ndërtimet tjera		15,300
	ndërtimet në pronë shoqërore		300
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit		73	
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		Suharekë-Rruga e Reshtanit, afër autostradës, në sipërfaqe pre 5000m ² , parcela me nr.268/32	
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët (brenda 3 viteve 2018-2020)		55 njesi banimi	
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga vlera mesatare e qirasë		15 / 120 €	
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshme për qira të ulëta të tregut		0	
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që duhet të rinovohen		20	
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK		0
	Vendndodhja /emërtimi		0
	Nr. i familjeve		0
	Nr. i banorëve		0
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		PZHV/ PZHK /PZH hapësinor	



2.2.11.1. Program i veçant i banimit

Komuna e Suharekës për çdo vit përmes Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë, në bazë të kërkesave të qytetarëve me nevojë, ndan një shumë të mjeteve me të cilët i ndihmon familjet në nevojë për banim. Meqenëse komunat janë drejtpërdrejtë të përfshira në administrimin e sektorit për banim, atëherë edhe do të angazhohet në krijimi i kushteve për banim të përballueshëm për qytetarët e saj e posaqërisht ndaj familjeve në nevojë për banim. Ndihma zakonisht jepet në formë të granteve të vogla për riparime të shtëpive të tyre. Pra, qytetarët ndihmohen në varësi të asaj se për çka kanë nevojë për shembull për ndërtim/riparim të kulmeve të shtëpive, vendosje të dyerve/dritareve, material tjetër ndërtimor etj. Kjo bëhet në bazë të përcaktimit nga komisioni i kësaj drejtorie. Kështu gjatë vitit 2015 për nevoja të këtyre qytetarëve janë ndarë nga buxheti komunal 29,840.60 euro, ndërsa gjatë vitit 2017 janë ndarë 67,290.70 euro, dhe janë ndihmuar qytetarët e Suharekës të cilët kanë pas nevojë për renovim të shtëpive të tyre. Gjatë mandatit të kaluar të qeverise komunale, janë ndërtuar dy shtëpi për dy familje me gjendje të rëndë ekonomike nga themeli, ndërsa edhe më parë dy shtëpi të këtilla për dy familje të komunitetit ashkali me kushte të vështira sociale. Këto shtëpi janë ndërtuar nga Motra Johana e cila është “Qytetare Nderi” e komunës së Suharekës. Gjatë vitit 2018 janë ndërtuar edhe 7 shtëpi të komunitetit RAE në bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete ndërkaf në vitin 2019 janë ndërtuar 5 shtëpi banimi.

Po ashtu në bashkëfinancim të komunës së Suharekës dhe të Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” në vitin 2018 janë ndërtuar 10 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë ekonomike të komunës sonë. Ndërkaq bashkëfinancimi në mes këtyre dy partnerëve në vitin 2019 janë ndërtuar 15 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. Për vitin 2020 Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit dhe Komuna e Suharekës do të ndërtojë 30 shtëpi të reja për familje me gjendje të rëndë ekonomike.

Tabela 70 Familjet momentalisht të ndihmuara me banim social

	Mënyra e ndihmës	Nr . i familjeve të ndihmuar	Nr . i individëve të ndihmuar	Data e fillimit të ndihmës	Data e skadimit të ndihmës	Vlera e qirasë/ndihma financiare (€)
1	Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;	0				
2	Banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;	4				
3	Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim;	0				
4	Shtëpi individuale të ndërtuara nga donatorë të huaj/vullnetarë;	55				
5	Renovime/riparime					

Sipas Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë në Suharekë numri i familjeve kërkuese të banimit social në tri vitet e fundit sipas kategorive është si vijon:

Tabela 71 Numri i familjeve kërkues të banimit social sipas kategorive

	Kategoritë	Familje
1	Me asistencë sociale	20
2	Kategoritë e dala nga lufta, familjet e dëshmorëve, invalidëve	27
3	Të kthyerit	0
4	Të riatdhesuarit	2



5	Te punësuarit nga buxheti shtetëror	0
6	Minoritetet	14
7	Tjerë	0
Total		63

Komuna e Suharekës ka ndarë një parcelë me sipërfaqe 5000 m² me qëllim të ndërtimit të një ndërtese për nevoja të Programit të vecant të banimit. Planifikohet që kjo ndërtesë banimi të i posedon 16 njësi banesore që do të thotë të i sistemohen 16 familje.

Për ndërtimin e këtij objekti Komuna e Suharekës do të ndajë në baza vjetore nga 20.000 euro. Pra në periudhën 2019-2021, Komuna e Suharekës do të siguroj 60.000 euro për këtë qëllim. Pjesa tjetër duhet të sigurohet nga donatorë të jashtëm.

2.2.12. Vendbanimet

Numri i vendbanimeve në Kosovë numëron 1457 nga të cilat 30 janë të nivelit urban dhe të tjerat për nga përmbajtja dhe veprimtaritë që zhvillohen dhe ofrohen në to janë të statusit të fshatit. Shprehur në përqindje del se qytetet përbëjnë 2.06% të vendbanimeve kosovare. Ato paraqesin qendrat në të cilat zhvillohen aktivitetet sociale, kulturore, ekonomike ndaj edhe koncentrimi i popullatës është më i madh në këto qendra. Madhësia e 30 qendrave urbane varësisht në raport me numrin e banorëve është si vijon:

Tabela 72 Komunat sipas numrit të banorëve

Deri 15,000 banorë	Malisheva, Z.Potoku, Shtërpca, Novo Bërda.
15,000—75,000 banorë	Suhareka dhe të gjitha komunat tjera
75,000 – 120,000 banorë	Gjilani, Gjakova, Peja, Mitrovica, Vushtrria, Podujeva
120,000- 220,000 banorë	Prizreni
> 220,000 banorë	Prishtina

Vendbanimet më afër magjistrale dhe zonës urbane janë më të zhvilluara në çdo aspekt andaj është analizuar edhe afërsia e vendbanimeve dhe popullsisë ndaj rrugëve nacionale (magjistrale) dhe rajonale. Rreth 80% e popullsisë shtrihet në një distancë më të vogël se 20 km nga 7 qendrat rajonale që kanë mbi 100,000 banorë. Kjo e bën mjaft specifik relacionin midis zhvillimit urban dhe rural të Kosovës nga aspekti i rëndësisë së zhvillimit të transportit midis këtyre qendrave rajonale dhe vendbanimeve përreth tyre.

Shtirja e vendbanimeve të komunave ka veçoritë vijuese:

- Obiliqi, Dragashi, Suhareka, Vitia kanë mesatarisht 42.3% të popullsisë që jetojnë në vendbanime deri 2 km larg prej rrugëve magjistrale e rajonale (këto komuna kryesisht kanë një rrugë të tillë).
- Në grupin e dytë bëjnë pjesë 16 komuna me rreth 66% të popullsisë të cilat kanë 1-2 rrugë të tilla afër të cilave shtrihen vendbanimet dhe popullsia.
- Në grupin e tretë bëjnë pjesë 7 komuna të cilat kanë mesatarisht rreth 80% të popullsisë afër rrugëve të tilla dhe të cilat kanë 2-4 rrugë magjistrale e rajonale, dhe
- 3 komuna (Mitrovica, Prishtina dhe Kaçaniku) kanë 92.3% të popullsisë në rrugë deri 2 km larg tyre. Këto komuna kanë 4-6 rrugë të tilla ose për shkak të relievit specifik vendbanimet janë të radhitura afër rrugëve (Kaçaniku).

Komuna e Suharekës përbëhet prej 43 vendbanimeve. Qyteti i Suharekës është qendër komunale ndërsa vendbanimet e afërta si Reçan, Reshtan, Shirokë mund të konsiderohen vend- banime periferike të qytetit. Vendbanimet si Mushtishti, Studençani, Bllaca, dhe Duhla për nga karakteristikat e tyre hynë në vendbanime gjysmë urbane, ndërsa të gjitha vendbanimet tjera të komunës karakterizohen si fshatra.




Vendbanimet e komunës së Suharekës, kryesisht kanë ruajtur karakterin e tyre agrar. Në këtë ka ndikuar e dhëna, se në të gjitha vendbanimet përpos deri diku në qendrën komunale ka mbizotëruar popullsi bujqësore, kështu që shkalla e aktivitetit jashtë bujqësorë është ende mjaft e vogël, për shkak të zhvillimit të pamjaftueshëm të veprimtarive jo prodhuese.

Nga sipërfaqja totale e komunës së Suharekës prej 360,991km², prej së cilës 8,435km² përbëjnë vendbanimet (hapësira e ndërtuar). Kjo do të thotë që vetëm 2.34 % të territorit e përfshinë hapësira e ndërtuar. Largësia mesatare ndërmjet vendbanimeve është 2.95 km. Territori i komunës së Suharekës ka gjithsejtë 43 vendbanime.

Tipologjia dhe klasifikimi i vendbanimeve—Në komunën e Suharekës mbizotërojnë vendbanimet e zhvilluara të tipit të lagjeve të cilat në vetvete përmbajnë disa lagje të cilat janë mjaft të lansuara njëra nga tjetra. Këto janë kryesisht vendbanimet më të mëdha që tregojnë se janë zhvilluar në mënyrë stihike në hapësirë.

Tabela 73 Numri i vendbanimeve karakteristikave të shtirjes

Lloji i zhvillimit	Numri i vendbanimeve	Numri banorëve	Dendësia Mesatare	Përqindja e vendbanimeve
I shpërndarë	11	12,585	130.37	27%
Kompakt	21	39,200	232.39	51%
Linear	9	13,566	161.78	22%



Harta 26 Shtirja e vendbanimeve

2.2.12.1. Karakteristikat morfologjike dhe urbanistike të vendbanimeve

Pozita, renditja dhe vendosja e vendbanimeve të komunës së Suharekës, si dhe lokacioni i tyre që i përket terrenit është rezultat i relievit dhe i elementeve të tjera të bazës natyrore- gjeografike. Nëse nisemi nga tërësitë releviore gjeografike, atëherë kemi: vendbanimet e rrafshëta, vendbanimet në terrenet e valëzuara-kodrinore dhe vendbanimet malore. Vendbanimet e rrafshëta gjenden në pjesën fushore, luginave përgjatë lumenjve, buzë luginave, ose rrugëve kryesore ose anësore dhe janë të tipit të dendur, disa janë edhe në formë të zgjatur. Vendbanimet në terrenet e valëzuara kodrinore, shtrihen kryesisht rrëzë kodrave, shpateve, shullaneve dhe nëpër qafa. Këto janë vendbanime të tipit të grumbulluar.




Vendbanimet malore shtrihen në shpate të përshtatshme malore, në pjesët rrafshnalta dhe rreth përrojeve malore. Disa nga ato janë të tipit të shpërndarë, të ndarë nëpër lagje. Sipas pozitës gjeografike, 10 vendbanime gjenden në terren të rrafshët, 16 vendbanimet janë në terrenet e valëzuara-kodrinore, 15 vendbanime janë kodrinore-malore dhe 2 vendbanime janë në terren malor.¹⁷

Tabela 74 Veçoritë hapësinore të vendbanimeve (2019)

Vendbanimet	Urban/ Rural	Banor (nr.)	Sipërfaqe (km ²)	Dendësi (nr./km ²)	Lartësia mbidetare	Zhvillimi
Bllacë	R	3,598	21.39	168.21	633	Kompakt
Çadraq	R	179	5.06	35.38	787	Kompakt
Dobërdelan	R	1,218	8.01	152.06	566	Kompakt
Dubravë	R	849	2.17	391.24	477	Kompakt
Dvoran	R	153	4.21	36.34	585	Kompakt
Gelancë	R	1,225	4.23	289.60	374	Kompakt
Gjinoc	R	2,264	8.14	278.13	425	Kompakt
Kastërc	R	467	2.10	222.38	530	Kompakt
Leshan	R	1,748	7.42	235.58	375	Kompakt
Mohlan	R	475	13.14	36.15	683	Kompakt
Popolan	R	274	2.58	106.20	588	Kompakt
Regan	R	1,278	6.78	188.50	425	Kompakt
Reshtan	R	1,214	2.75	441.45	375	Kompakt
Sallagrazhde	R	1,408	8.32	169.23	473	Kompakt
Savrovë	R	1,127	3.78	298.15	500	Kompakt
Semetisht	R	1,688	7.20	234.44	410	Kompakt
Sllapuzhan	R	1,121	6.10	183.77	525	Kompakt
Sopi	R	3,475	8.51	408.34	440	Kompakt
Suharekë	U	12,362	19.21	643.52	400	Kompakt
Tërnjë	R	927	4.67	198.50	360	Kompakt
Vraniq	R	2,150	13.19	163.00	617	Kompakt
Budakovë	R	1,856	24.00	77.33	750	I shpërndarë
Bukosh	R	1,274	5.00	254.80	527	I shpërndarë
Griçec	R	617	14.06	43.88	950	I shpërndarë
Griqoc	R	2,655	14.08	188.57	520	I shpërndarë
Javor	R	524	9.25	56.65	900	I shpërndarë
Krushicë e Epërme	R	192	1.26	152.38	915	I shpërndarë
Krushicë e Poshtme	R	482	2.50	192.80	590	I shpërndarë
Maçitevë	R	454	13.40	33.88	1030	I shpërndarë
Mushtisht	R	3,400	33.25	102.26	600	I shpërndarë
Neprebisht	R	820	2.80	292.86	338	I shpërndarë
Papaz	R	311	8.04	38.68	950	I shpërndarë
Delloç	R	175	14.05	12.46	833	Linear
Duhël	R	1,855	14.13	131.28	660	Linear
Luzhnicë	R	172	7.22	23.82	883	Linear
Nishor	R	1,291	10.05	128.46	580	Linear
Pegan	R	2,513	8.28	303.50	450	Linear
Samadrexhë	R	3,486	10.67	326.71	410	Linear
Staravuçinë	R	271	2.26	119.91	555	Linear
Studençan	R	3,617	10.97	329.72	400	Linear
Vërshet	R	186	2.32	80.17	745	Linear
Gjithsejtë	41	65,351	366.55	178.29		

¹⁷ PZHK 2008-2018



Harta 27 Vendbanimet sipas numrit të banorëve

2.2.12.2. Funkcionaliteti i vendbanimeve

Sa përket funksionalitetit të vendbanimeve dhe rolit të tyre për vendbanimet rrethuese, bazuar në numrin e banorëve, pozitës së dhe bashkësive lokale tyre janë identifikuar:

- 1 Vendbanim i mesëm i vogël urban 25,000-50,000 banorë;
- 6 Vendbanime rural i madh 2,500-5,000 banorë;
- 16 Vendbanime i mesëm i madh rural 1,000-2,500 banorë;
- 5 Vendbanime i mesëm rural 500-1,000 banorë;
- 8 Vendbanime i mesëm rural 500-1,000 banorë;
- 5 Vendbanime shumë i vogël rural <200 banorë;

Tabela 75 Numri dhe përqindja e vendbanimeve sipas klasifikimit të vendbanimeve


	Nr i vendbanimeve	% e vendbanimeve	Nr. i banorëve	% banorëve
Vendbanim i mesëm i vogël urban	1	2%	12,362	18.9%
Vendbanim rural i madh	6	15%	19,954	30.5%
Vendbanim i mesëm i madh rural	16	39%	25,456	39.0%
Vendbanim i mesëm rural	5	12%	3,765	5.8%
Vendbanim i vogël rural	8	20%	2,980	4.6%
Vendbanim shumë i vogël rural	5	12%	834	1.3%



Gjersa sa i përket funksionalitet të vendbanimeve janë identifikuar një qendër kryesore urbane dhe 7 nën qendra sekondare rurale.

Tabela 76 Veçoritë e qendrës kryesore urbane dhe 7 nënqendrave sekondare rurale

Lokacioni	Nr. i vendbanimit që shërben	Nr. i banorëve	% e banorëve	Sipërfaqja e mbuluar	% sipërfaqes
Suharekë	6	21,963	33.6%	51.63	14.09%
Mushtisht	4	4,182	6.4%	64.91	17.71%
Studençan	5	10,068	15.4%	37.12	10.13%
Duhël	7	6,945	10.6%	71.11	19.40%
Gjinoc	6	10,149	15.5%	44.36	12.10%
Nishor	4	3,446	5.3%	19.35	5.28%
Bukosh	4	4,825	7.4%	24.55	6.70%
Mohlan	7	3,773	5.8%	53.52	14.60%



Harta 28 Struktura e vendbanimeve

2.2.13. Vendbanimet joformale

Janë vendbanime njerëzore, të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm.

Bazuar në Plani për Zbatimin e Standardeve në Kosovë, Vendbanimet Joformale kategorizohen si vijon:

1. Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë
2. Qasja joadekuatë ose privimi në shërbime elementare
3. Pjesëmarrja joadekuatë ose mospjesëmarrja në qeverisje
4. Rrezikshmëria deri në diskriminim




Në Komunë të Suharekës janë gjithsejt 4 katër vendbanimeve joformale rurale në zonë rurale dhe atë në fshatrat Reshtan, Gjinoc, Grejkoc dhe Maqitevë.

Tabela 77 Veçoritë e vendbanimeve joformale

Emri i Vendbanimit	Sipërfaqja e zonave në ha	Numri i objekteve	Numri i banorëve
Grejkoc	30.00	83	581
Maqitevë	3.18	7	49
Gjinoc	138.77	116	812
Reshtan	23.74	36	252
Gjithsejtë	195.69	242	1694

Të gjitha Vendbanimet Joformale i përkasin kategorisë së parë, të zotërimit joformal ose jo i sigurt i pronësisë, gjersa të gjithë banorët e këtyre vendbanimeve gëzojnë qasja adekuate ose privimi në shërbime elementare, pjesëmarrja adekuate ose pjesëmarrja në qeverisje, si dhe nuk janë rrezikuar nga diskriminimi.



Harta 29 Struktura e vendbanimeve joformale

2.2.14. Shfrytëzimi aktual i tokës

Në vijim është paraqitur shfrytëzimet e destinuar aktuale të tokës përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Tabela 78 Sipërfaqet (ha) e shfrytëzimeve të destinuar aktuale të tokës përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor

Agrozona Industriale në Suharekë-Shirokë	Agrozona Industriale në Samadrexhë	Rosula- Suharekë	Qendra-Suharekë	Kodra - Suharekë	Grapi- Studenqan-Suharekë	Pojata - Suharekë	Fidanishtja	Rruga e Reqanit	Shiroka 1	Lagja e Bajraktarëve dhe Gradina	Lagja Kodra
162.25	28	50.06	65.00	28.40	38.24	34.38	20.00	83.00	49.00	36.00	22.00



Në vijim është paraqitur shfrytëzimi aktual i tokës sipas shfrytëzimit të sipërfaqeve të ndërtuara:

Tabela 79 Sipërfaqja dhe përqindja e sipërfaqeve të ndërtuara sipas shfrytëzimit aktual


	Qerdhe	Shtëpi për pleq	Stallë	Religion	Depo	Gurthyes	Stadium i Futbollit	Rezervat Natyror	Arsim	Park/rekreimi	Varreza	Tregti/Afarizëm/Banim	Gurthyes	Zonë industriale	Banim individual
Ha	1.08	1.41	189.14	3.14	1.95	2.89	11.30	17.97	35.67	37.82	39.56	41.25	143.29	147.70	189.14
%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	0.12%	99.31%	0.99%	1.00%

2.2.14.1. Pronësia e tokës

Sa i përket pronësisë së tokës brenda territorit të Komunës, 61.06% është Prone Private, 35.62% është Prone Komunale dhe 3.31% është AKMP.

Tabela 80 Sipërfaqja (ha) e tokave sipas pronësisë

Prone Private [ha]	Prone Komunale [ha]	AKMP [ha]
868,837.00	589,628.70	462,759.60



Harta 30 Harta e shfrytëzimit të tokës



2.2.15. Kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës

2.2.15.1. Kapacitetet njerëzore

Aktualisht Komuna ka gjithsejtë 1,309 punonjës, apo 2 punonjës për 100 banorë resident.

Tabela 81 Numri i punonjësve të Komunës gjatë katër viteve të fundit

ZYRA E KRYETARIT	ADMINISTRATA E PËRGJITHËSHME	EKONOMI BUXHET DHE FINANCA	SHËRBIMET PUBLIKE, MJEDIS DHE EMERGJENCË	ZJARREFIKSET	BUJQESI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI	ZYRA KOMUNALE PER KOMUNITETE	DREJTORIA PER INSPEKSION	SHËRBIMET PRONËSORE-JURIDIKE DHE KADASTËR	DREJTORIA URBANIZËM DHE PLANIFIKIM	DREJTORIA PER SHËNDETËSI DHE MIRQENIE SOCIALE	MJEKSIA PRIMARE	QENDRA PER PUNE SOCIALE	DREJTORIA PER KULTURE, RINI, SPORT	DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT	ARSIMI PARAFILLOR	ARSIMI FILLOR	ARSIMI I MESEM	GJITHSEJ
16	35	26	8	16	14	1	12	14	8	6	145	13	15	11	11	739	219	1309

Aktualisht në Komunë janë të punësuar gjithsejtë 57 punonjës sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Pasqyra dhe trendet e punësimit të shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive, 2015- 2018

Tabela 82 Numri i punonjësve të Komunës sipas Korniza Kombëtare të Kualifikimeve

Drejtoria:	Të punësuar- viti:				Trendet e rritjes / zvogëlimit- viti:			
	2015	2016	2017	2018	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2015-2018
Zyra e Kryetarit	0	0	0	1	0	0	1	1
Administratë	1	1	1	2	1	1	2	4
Shërbime Publike dhe Emergjencë	1	0	0	0	1	0	0	1
Ekonomi Buxhet dhe Financa	1	4	0	1	1	4	1	6
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale QPS	1	1	1	1	2	1	1	4
Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis	0	0	0	0	0	0	0	0
Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari	0	1	0	1	0	1	1	2
Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë	0	4	1	0	4	1	0	5
Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër	1	2	0	0	1	2	0	3
Gjithsej:	5	13	3	6	10	10	6	26

*Burimi: Shërbimi i Administratës së Komunës në Suharekë



Tabela 83. Pasqyra e kualifikimeve të edukimit formal e shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive, 2019

Drejtoria:	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve*					
	SNKA 2	SNKA 3	SNKA 4	SNKA 5/6		
				Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Zyra e Kryetarit	0	04	01	11	1	0
Zyra për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0	01	0
Administratë	01	25	0	08	01	0
Shërbime Publike dhe Emergjencë	03	12	01	08	0	0
Ekonomi Buxhet dhe Financa	0	08	02	15	01	0
Drejtoria për Arsim	0	02	01	08	0	0
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	01	01	04	0	0	0
QPS	0	05	01	07	0	0
Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis	01	01	0	06	0	0
Drejtoria për Inspektion	0	02	01	09	0	0
Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari	03	05	0	06	0	0
Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë	02	04	0	09	0	0
Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër	0	06	0	06	02	0
Gjithsej:	12	76	11	91	5	0

*Korniza Kombëtare e Kualifikimeve- Standardet Ndërkombëtare për Klasifikim të Arsimit (SNKA).

Sa përket kapaciteteve njerëzore të Komunës, vërehet një rritje simbolike të numrit të të punësuarve në Komunë prej 6 punonjësve shtesë gjatë katër viteve të fundit.

Tabela 84 Numri i punonjësve të Komunës sipas përvojës së punës

Drejtoria:	Vite përvojë pune:				
	0- 5	6- 10	11- 15	16- 20	Mbi 20 vite
Zyra e Kryetarit	01	02	03	04	06
Zyra për Kthim dhe Komunitete	00	00	00	01	00
Administratë	02	01	03	09	20
Shërbime Publike dhe Emergjencë	01	05	01	10	07
Ekonomi Buxhet dhe Financa	03	04	03	02	14
Drejtoria për Arsim	00	00	03	02	06
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	01	00	01	00	02
QPS	05	00	01	00	07
Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis	01	01	00	02	04
Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari	01	02	01	04	06
Drejtoria për Inspektion	00	00	01	06	05
Kulturë Rini Sport dhe Mërgatë	04	01	02	01	07
Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër	02	02	00	03	07
Gjithsej:	21	18	19	44	91



2.2.15.2. Kapacitetet financiare të komunës

Kapacitetet financiare të Komunës nga të hyrat vetanake janë arritur kryesisht nga tatimi në pronë që përbën 32% të të hyrave të përgjithshme dhe 10% nga dokumentet e gjendjes civile.

Tabela 85 Të hyrat financiare (€) sipas kategorive për vitin 2019

Te hyrat vetanake direkte	Te hyrat vetanake indirekte	Donacione të brendshme	Donacione te jashtme	Gjithsej
1,810,863.00	178,000.00	1,924,247.67	295,389.95	4,208,500.62

Tabela 86 Të hyrat vetanake të Komunës (€) sipas kategorive të pagesave

Tatimi në prone:	Regjistrimi i automjeteve:	Lejet e ndërtimit:	Regjistrimi i trashëgimisë:	Matjet gjeodezike e tokës:	Dokumentet e gjendjes civile:	Inspektimi i afaristeve:	Shfrytëzimi i pronës publike:	Participimet në Arsime dhe Shëndetësi:	Dënimet nga komunikacioni dhe gjykata:	Gjithsej
690,000	171,000	127,000	29,000	103,000	266,863	21,000	112,000	113,000	178,000	1,810,863

Tabela 87 Pasqyra e investimeve kapitale (€) për vitin 2019 sipas sektorëve

Infrastruktura sociale dhe publike	Infrastruktura transportuese	Infrastruktura teknike	Gjithsej
3,946,880.69	49,990.00	970,220.31	4,967,091.00



3. VLERËSIMI I GJENDJES

Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson të dhënat e Profilit Komunal për t'i paraqitur trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozat dhe supozimet e ardhshme që janë relevante për komunën. Për shembull, fushat kyçe për analizë mund të përfshijnë projeksionet e popullsisë, prognozat e gjendjes ekonomike, nevojat për banim në të ardhmen, si dhe lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve përgjatë rrugëve specifike të komunikimit.

Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për komunën që përkufizojnë nevojat dhe kërkesat e fushave zhvillimore sektoriale.

Vlerësimi i gjendjes përfshin shqyrtimin e fushave tematike specifike relevante për komunën, si dhe me komunat fqinje, nivelin qendror dhe normat teknike të planifikimit hapësinor.

Vlerësimi i gjendjes përqendrohet në identifikimin e sfidave të lidhura me fushat tematike me vëmendje të posaçme lidhur me implikimet e tyre hapësinore.

3.1. Konstatime gjeografike dhe mjedisore

Rrjeta e lumenjve (përroskave) është mjaft e përhapur dhe mbulon tërë territorin e komunës. Sasia e ujit në to është mjaft e vogël dhe e pamjaftueshme. Të gjithë lumenjtë burojnë në territorin e komunës dhe sasia e ujit ndryshon gjatë stinëve të vitit. Në mbarim të vjeshtës, gjatë dimrit dhe në fillim të pranverës kur të reshurat janë të shpeshta dhe të mëdha pas shkrirjes së borës sasia e ujit rritet, duke rrezikuar me vërshime (përmytje), ndërsa gjatë muajve të verës në shumë raste lumenjtë thahen në tërësi.

Faktor tjetër që shkakton vërshimet është edhe faktori njeri gjatë veprimtarive të veta si: -Eksplotimi i inerteve -Shkatërrimi i objekteve hidroteknike -Hedhja e mbeturinave në lumenj -Mbjellje e bimëve të larta dhe atyre të vet-rritura në afërsi të lumit. Këtu do të përmendim rastin e lumit Toplluha, ku toka bujqësore rrezikohet nga vërshimi rreth 15 km nga shtrati i këtij lumi (në mes Suharekës dhe Mamushës. Rekomandimet: -Rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit, -Ndërtimi argjinaturave, -Ndalimi i shfrytëzimit ilegal të inerteve

3.2. Trendët dhe prognozat demografike

Bazuar në numrin e banorëve të regjistruar në vitin 2011 prej 59,722 banorë dhe numrin aktual prej 66,960 banorëve, prognoza për numrin e banorëve rezident në vitin 2028 është 72,932 banorë, me rritje vjetore prej 0.7735%.

Tabela 88 Prognoza e numrit të banorëve rezident për vitin 2028

Viti i regjistrimit 2011	Popullsia rezidente Viti aktual (2020)	Prognoza e popullsisë rezidente Viti 2028
59,722	67,002	72,932

Për dallim nga Komunitat tjera, trendi i numrit të popullsisë në Suharekë ka shënuar një rritje prej 2.87%.

Bazuar në rritjen prej 8.6%, projeksioni për rritjen të popullsisë së Komunës së Suharekës është +3.801 banorë rezidentë dhe +5.129 popullsi rezidente dhe jo-rezidente në vit.

Tabela 89 Projeksioni i numrit të banorëve rezident për vitin për tetë vitet e ardhme

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Projeksioni i nr. të banorëve	71,140	73,181	75,282	77,442	79,665	81,951	84,303	89,315	96,639



Projeksioni i shtimit vjetor	2,042	2,100	2,161	2,223	2,286	2,352	2,420	2,515	
------------------------------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	--

Tabela 90 Projeksioni i numrit të banorëve rezident dhe jo-rezident për vitin për tetë vitet e ardhme

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Projeksioni i nr. të banorëve	98,102	103,134	108,424	113,985	119,831	125,977	132,438	139,231	146,384
Projeksioni i shtimit vjetor	5,032	5,290	5,561	5,846	6,146	6,461	6,793	7,153	

Prognoza e numrit të banorëve rezident për vitin 2027 është 86,723 gjersa të banorëve rezident dhe jo-rezident është 139,231 banorë.

3.3. Ekonomia

Kjo pjesë shqyrton dhe vlerëson gjendjen ekzistuese të ekonomisë komunale, duke përfshirë karakteristikat elementare të ekonomisë lokale:

3.3.1. Ekonomitë familjare, punësimi dhe papunësia

Në Komunë janë gjithsej 9.145 ekonomi familjare, me mesatarisht 6.5 anëtarë për familje dhe mesatare prej 27m² hapësirë banimi për kokë banori. Sa i përket krahasimit të madhësisë së nukleusit familjar, Suharekasit kanë një numër të ultë të anëtarëve për familje, që dëshmon se ka pak familje, të cilat jetojnë në bashkësi sipas traditës. Numri i vogël i anëtarëve për familje, paraqet një tregues pozitiv për zhvillimin ndërtesave për banim në të ardhmen, gjersa hapësira mesatare e banimit prej 27m² është më e lartë krahasuar me hapësirën mesatare prej 22m² për kokë banori të vendeve të Bashkësisë Evropiane.

Me 38,209 banorë të moshës 15–64, fuqia punëtore e Komunës së Suharekës zë një vend të rëndësishëm në krahasim me komunat tjera të Republikës së Kosovës, që paraqet një tregues joshës për investitor të interesuar në zhvillimin e ndërmarrjeve të mëdha në Komunën tonë. Vetëm 0.50% të banorëve sigurojnë të ardhura nga qiraja, që dëshmon se sektori i patundshmërive nuk është edhe aq i zhvilluar, që ndikon negativisht në mirëqenien ekonomike të banorëve. Komuna e Suharekës ka vetëm 5.55% të banorëve, që pranojnë pensione dhe vetëm 3.42% të banorëve që pranojnë ndihma sociale, që dëshmon një gjendje të mirë ekonomike të banorëve.

Tjetër faktor i rëndësishëm ekonomik është që në krahasim me Komunat tjera, me gjithsejtë 22,253 prona private, Numri i lartë i pronave dëshmon që një e konsiderueshme e ekonomive familjare e Suharekës posedon pronë private. Mirëpo, krahasuar përqindjen e numrit të banorëve të cilat kanë emigruar jashtë vendit është 26% të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh përqindjen e ultë të familjeve që pranojnë remitenca nga diaspora, Komuna duhet të përqendrohet shumë në krijimin e vendeve të reja të punës.

Në vijim janë paraqitur veçoritë e punëkërkueseve të regjistruar në Zyrën Komunale në Suharekë, për periudhën 01.01.2016 deri më 07.03.2019

Tabela 91 Numri punëkërkueseve sipas arsimit

Niveli i edukimit	Totali	Femra	Meshkuj
Te pa shkollë	405	260	145
Klasat I-IX (shkolla fillore)	1208	636	572
Arsimi i mesëm profesional	620	184	436
Shkolla e mesme-gjimnazi	118	62	56
Bachelor	188	113	75



Master	16	9	7
Totali	2555	1264	1291

Tabela 92 Numri punëkërkuessve sipas përkatësisë etnike

Etniciteti	Totali	Femra	Meshkuj
Shqiptar	2480	1232	1248
Ashkalinj	22	7	15
Rom	2	1	1
Kroat	2	1	1
Totali	2506	1241	1265

Tabela 93 Numri i punë kërkuessve sipas grup moshës

Grup moshë	Totali	Femra	Meshkuj
15-24	456	204	252
25-39	974	468	506
40-54	682	344	338
55+	349	183	166
Totali	2461	1199	1262

3.3.1.1. Sektorët ekonomik, struktura e tyre dhe ekonomia bujqësore

Numri i bizneseve të regjistruara në Komunën e Suharekës sipas viteve gjatë 5 vjeçarit të fundit janë:

- 2015 janë regjistruar 154 biznese të reja dhe 37 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- 2016 janë regjistruar 246 biznese të reja dhe 41 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- 2017 janë regjistruar 185 biznese të reja dhe 63 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
- 2018 gjithsej 112 biznese të reja dhe 65 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;
Aktivitetet turistike janë të koordinuara nga koordinatori i emëruar për turizëm për komunë, i cili punon në qendrën lokale informative për turizëm. Qendra për informim për turist ofron informata për mundësitë e akomodimit dhe zhvillon konceptet për infrastrukturën turistike shtesë dhe aktiviteteve të lira si ekskursionet ose ngjarje të ndryshme.

Seminaret dhe kurset e niveleve të ndryshme të trajnimit të stafit kualifikues, përkohësisht ofrohet në komunë me qëllim që të siguroj kualitet të shërbimeve turistike. Komuna përkrah sinergjitë mes turizmit, bujqësisë, blegtorisë dhe ndërmarrjeve të vogla.

4.1.3. Energjia

Shembulli i komunës në vënien e masave për konceptin e energjisë efikente në bashkëpunim me kontraktues të specializuar, është mirë e themeluar dhe në funksion. Përmes kursimeve nga kostoja e energjisë, komuna mund të harxhoj më shumë mjete (para) në zhvillimin e masave të infrastrukturës.

Fokusi i komunës në aktivitetet e bazuara në energji është në ndërtesat e qeverisura nga komuna (si institucionet shëndetësore, shkolla, zyra lokale etj.). Të motivuar nga të arriturat dhe kursimet e komunës, ndërmarrjet private gjithashtu kanë implementuar konceptin e energjisë në industri dhe hotele. Përmes bartjes së njohurive për potencialin e mënyrave bashkëkohore për buxhetet e energjisë, po ashtu këto metoda depërtojnë edhe në ndërtesat e banimit.

Tema e energjisë ripërtëritëse dhe kursimeve të energjisë ka zhvilluar një fushë të re për ekonominë lokale si dhe për trendet ardhshme për Kosovën. Ndërmarrjet e specializuara në këtë fushë ofrojnë njohuritë e veta për komunën dhe tërë vendin. Stafi është i trajnuar drejtpërdrejtë nga këto ndërmarrje në komunë dhe kanë arsimim edhe nga kurset speciale të organizuara nga ekspertët e kësaj fushe.

4.1.4. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Pozita ekonomike dhe gjeografike e Suharekës e pozicionuar në korridorin rrugor ndërmjet Prishtinës dhe Prizrenit, me potencial të mir të fuqisë punëtore lokale.

Punësimi rajonal është mirë i balancuar nisur nga kërkesat e mëdha për punëtorët e prodhimtarisë dhe rafinimit bujqësorë.

Fuqitë ekonomike rajonale janë të lidhura me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe industrive dhe bizneseve me emetim të ulët. Fokusi i ndërmarrjeve lokale është i orientuar në prodhimtarinë bujqësore, shërbime dhe konsultimeve për energji ose zgjidhjeve energjetike.

Atraktiviteti ekonomik i lokacionit të Suharekës është i theksuar nga promovimi strategjisë së tregut e cila përfshinë konceptet për:

- Ndërmarrësit e rinj
- Kosovarët nga diaspora
- Ndërmarrjet me qëllim/dëshirë të zgjerimit
- Asociacionet e tregtisë
- Gratë

Industritë dhe bizneset të cilat i përpunojnë resurset regjionale janë të përkrahura nga agjencia regjionale për marrëveshje që është përgjegjëse për hulumtim profesional të lokacioneve si dhe menaxhim të tyre.



Agjencia i administron hapësirat e siguruara nga komuna për zhvillim ekonomik si dhe lokacionet private për investorët e jashtëm.

Në kuadër të zonave të krijuara biznesore dhe industriale sigurohet infrastruktura dhe lidhjet efikase me rrjetin regional rrugor. Hapësira e parkut komunal të biznesit është e pajisur me furnizim vetanak të energjisë të bazuar në format e përsëritshme të energjive regionale. Kjo siguron furnizim të përhershëm me energji për ndërmarrjet.

4.2. Qëllimet dhe Objektivat

4.2.1. Qëllimet e përgjithshme

Për ta arritur vizionin e planifikuar, me këtë plan caktohen qëllimet (deklarata të përgjithshme) të drejtimeve të planifikuara zhvillimore në Komunë, që përcaktojnë bazën për zhvillim të integritetit të qëndrueshme dhe janë përputhje me qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe aspiratave të banorëve të Suharekës, duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Këto qëllime në kuptimin kohor kategorizohen si afatgjate, dhe si të tilla në kuptimin praktik zbërthehen nëpërmes disa objektivave të ndërlidhura dhe të cilat do shtjellohen në vazhdim.

Qëllimet e përgjithshme të këtij dokumenti mbështeten në hulumtimin e gjerë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese, qëllimet e prezantuara nga drejtoritë komunale, institucionet tjera publike lokale dhe qendrore, shoqëria civile por edhe në “Qëllimet e Qëndrueshme Zhvillimore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”.

Qëllimet kryesore të përgjithshme të komunës së Suharekës, të parashtruara në vijim, do jenë në një apo tjetër formë pjesë e qëllimeve të veçanta për çdo fushë veç e veç.

Qëllimet e përgjithshme janë:

1. Zhvillimi dhe përparimi i infrastrukturës fizike
2. Zhvillimi i rrjetit atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetës së qytetarëve, punësimit, barazive sociale.
3. Zhvillimi i pemëtarisë, vreshtarisë dhe blegtorisë
4. Promovim i Prizrenit “Qytet muze”,
5. Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzim të përparësive konkurruese,
6. Zhvillimin e lidhjeve efikase brenda urbane, ndërrurbane me hapësirat tjera dhe më gjerë atë regional nëpërmjet zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, TI-së).
7. Zhvillimi i turizmit kulturor e malor, industrial shërbyes e tregtar, me mbrojtje të trashëgimisë natyrore kulturore.
8. Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore;
9. Zhvillim të qëndrueshëm Ekonomik, social dhe mjedisor;
10. Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore;
11. Eliminimi i varfërisë;
12. Eliminimi i urisë dhe ngritja e cilësisë së të ushqyerit;
13. Krijimi i kushteve për banim të përballueshëm.
14. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqenies së njerëzve të gjitha moshave;
15. Edukim dhe Arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe plotësim i së drejtës së banorëve të Suharekës për të mësuar gjatë gjithë jetës;
16. Promovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike, mbrojtja dhe zhvillimi i saj;
17. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave;
18. Sigurimi i pajisjes dhe administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve për të gjithë banorët e Suharekës;
19. Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne dhe me çmim të përballueshëm;
20. Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme përmes punësimit në kushte humane dhe të denja, për të gjithë;
21. Ndërtimi i infrastrukturës rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitja e inovacionit;

22. Zvogëlimi i pabarazisë ndërmjet të Qytetit dhe zonave rurale por edhe vet në mes tyre (zonave rurale);
23. Kthimi i qytetit të Suharekës në vendbanim gjithëpërfshirëse, të parrezikshme, rezistuese dhe të qëndrueshme;
24. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit;
25. Lufta kundër ndryshimit klimatik dhe efekteve të tij, me aktiviteteve të planifikuara në PZHK-ë, dhe me efekte lokale dhe më gjerë.

4.2.2. Objektivat

Duke ditur se objektivat janë deklarata që përshkruajnë një gjendje specifike të ardhshme që do të arrihet në periudhën e deklaruar kohore, për të arritur një qëllim, të trajtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës, Ekipi punues dhe pjesëmarrësit tjerë në proces të planifikimit janë përpjekur që objektivat e mëposhtme të jenë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të lidhura për afatet kohore. Në këtë drejtim janë propozuar objektivat e tilla që synohet për tu arritur brenda një periudhë kohore specifike.




Figura 5 Zbërthimi i Objektivave sipas rregullit SMART

Për periudhën tetë vjeçare Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar qëllimet e veçanta dhe objektivat vijuese, sipas fushave tematike të radhitura në vijim.

4.2.3. Zhvillimi ekonomik

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të zhvillimit ekonomik, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.3.1. Qëllimet zhvillimore për ekonominë lokale

- QËLLIMI 1 - Ndërmarrësi e zhvilluar prodhuese e produkteve ndërtimore;
- QËLLIMI 2 - Agrikulturë me prodhimtari primare kualitative bujqësore dhe blegtorale
- QËLLIMI 3 - Industri përpunuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale
- QËLLIMI 4 - Turizëm rekreativ - sportiv dhe përjetim në natyrë;
- QËLLIMI 5 - Suhareka një pilot rajon në Kosovë për energji eficiente dhe energji të ripërtërtishme.

4.2.3.2. Objektivat zhvillimore për ekonominë lokale

- OBJEKTIVI 1 – Definimi i Zonës së Industriale dhe Ndërtimi i kapaciteteve prodhuese ndërtimore;
- OBJEKTIVI 2 Agrikulturë me prodhimtari primare dhe përpunim të produkteve kualitative bujqësore.
Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:



1. Mbrojtja e 100% të tokës bujqësore deri në vitin 2027.
2. Rritja dhe riaktivizimi i 50% të tokave ekzistuese bujqësore deri në vitin 2027.
3. Nxitja dhe përkrahja e bio-agrikulturës (bujqësia ekologjike) me arritjen e njohurive përkatëse deri në vitin 2022.
4. Mbulueshmëria e 50% sipërfaqes së destinuar të Agro-Zonës me kapacitete për përpunimin e prodhimeve bujqësore deri në vitin 2027.
5. Ndërtimi i rrjetit të ujitjes për 40% të sipërfaqeve të tokave bujqësore me deri në 2022.
6. Marketingu aktiv rajonal dhe ndërkombëtar për prodhimet bujqësore.

OBJEKTIVI 3 – Industri përpunuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale

1. Infrastruktura e rregulluar në Agrozonën Industriale dhe k
2. Krijimi i kushteve për zhvillimin e industrisë për prodhimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale;

OBJEKTIVI 4 Turizëm rekreativ - sportiv dhe përjetim në natyrë;

Për të përmbushur qëllimin e lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Krijimi i një bordi lokal të turizmit dhe pikave informuese turistike deri në vitin 2020.
2. Krijimi i hapësirave adekuate rekreative për turizëm deri në vitin 2027.
3. Zhvillimi dhe zbatimi i veprimeve për përmirësimin e peizazhit të qytetit dhe ruajtjen e peizazheve natyrore deri në vitin 2024.

OBJEKTIVI 5 - Suhareka një pilot rajon në Kosovë për energji eficiente dhe energji të ripërtëritshme;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore të erës për prodhim të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2023.
2. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore solare për prodhim të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2021.
3. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore ujore për prodhim të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2027.

4.2.4. Infrastruktura teknike

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës teknike, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit dhe në përputhje me U.A. MMPH-NR.11/2015 dhe U.A. MMPH Nr. 08/2017, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese

:

4.2.4.1. Qëllimet zhvillimore për infrastrukturës teknike

- | | |
|-----------|--|
| QËLLIMI 1 | - Furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm me ujë të pijes për të gjithë banorët e Komunës; |
| QËLLIMI 2 | - Rrjetit të ri i ujërave të ndotura dhe ndarja e ujrave atmosferik nga ujërat e ndotura; |
| QËLLIMI 3 | - Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike; |
| QËLLIMI 4 | - Ofrimi i qëndrueshëm i të gjitha shërbimeve telekomunikuese (TEL+DATA+VIDEO) për të gjithë qytetarët, bizneset, institucionet dhe ekonomitë familjare; |
| QËLLIMI 5 | - Ofrimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për të gjitha vendbanimet. |

4.2.4.2. Objektivat zhvillimore për infrastrukturës teknike

OBJEKTIVI 1 - Furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm me ujë të pijes për të gjithë banorët e Komunës.

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Ngritja e kapaciteteve të prodhimit të ujit të pijshëm në 800l/s dhe mbrojtja e tyre deri në vitin 2027.
2. Eliminimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues, deri në vitin 2022.



3. Ndërtim dhe ri-ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe drenazhimit në vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në rrjet deri në vitin 2024.

OBJEKTIVI 2 – Ujërat e ndotura të trajtuara në impiantet për ujëra të ndotura;

1. Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërve të ndotura;

OBJEKTIVI 3 - Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Mbeshtetje ligjore dhe bashkepunim në përmirësimin e nënstacioneve furnizuese deri në vitin 2021.
2. Mbeshtetje ligjore ndaj korporatës në zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të energjisë elektrike deri në vitin 2025;

OBJEKTIVI 4 - Shërbimeve telekomunikuese të qëndrueshëm (TEL+DATA+VIDEO) për të gjithë qytetarët, bizneset, institucionet dhe ekonomitë familjare;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Avancimi teknologjik i pajisjeve ekzistuese në përkrahje të shërbimeve telekomunikuese 4G dhe 5G LTE deri në vitin 2023;
2. Mbulueshmëria 100% me rrjeta të reja optike kabllore të avancuara FTTH (Fiber To The Home) në zonat e pambuluara në periudhën kohore trevjeçare deri në vitin 2023;

OBJEKTIVI 5 - Shërbimevet e grumbullimit të mbeturinave për të gjitha vendbanimet në nivel të duhur;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Zgjerimi i rrjetit për grumbullimin e mbeturinave për të gjitha vendbanimet deri në vitin 2024.

4.2.5. Infrastruktura e Transportit dhe transporti

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të transportit dhe transportit publik, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.5.1. Qëllimet zhvillimore për transportin dhe transportin publik

- QËLLIMI 1 Zhvillimi i një infrastrukture të integruar funksionale dhe shërbimeve të përshtatshme të transportit publik për të gjitha zonat;
- QËLLIMI 2 Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe i sigurisë publike në infrastrukturë të transportit;
- QËLLIMI 3 Promovimi i lëvizshmërisë rekreative.

4.2.5.2. Objektivat zhvillimore për transportin dhe transportin publik

OBJEKTIVI 1 Zhvillimi i një infrastrukture të integruar funksionale dhe shërbimeve të përshtatshme të transportit publik për të gjitha zonat;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Krijimi i infrastrukturës rrugore që ndërlidh të gjitha vendbanimet deri në vitin 2024.
2. Zgjerimi i rrjetit të transportit të rregullte publik për të gjitha vendbanimet me mbi 750 banorë deri në vitin 2023.
3. Ndërtimi i rrugëve transit që do të lirojnë trafikun në qytet deri në vitin 2022.

OBJEKTIVI 2 Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe i sigurisë publike në infrastrukturë të transportit;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar objektivat vijuese:

1. Hartimi i Planit të Mobilitetit deri në vitin 2021;



2. Zbatimi i Planit të Veprimit të Planit të Mobilitetit deri në vitin 2025;

OBJEKTIVI 3 Promovimi i lëvizshmërisë rekreative;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar objektivat vijuese:

1. Ndërlidhja e vendbanimeve rurale jug-lindore me qytetin përmes shtigjeve për çiklistë deri në vitin 2024.
2. Ndërlidhja e vendbanimeve turistike malore përmes shtigjeve për çiklistë dhe kalërim deri në vitin 2027.

4.2.6. Infrastruktura publike

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës publike, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.6.1. Qëllimet zhvillimore për infrastrukturën publike

- QËLLIMI 1** Krijimi i hapësirave të reja shëndetësore dhe shërbimeve sociale sa më afër banorëve.
- QËLLIMI 2** Krijimi i infrastrukturës arsimore publike për gjitha nivelet.
- QËLLIMI 3** Krijimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve.

4.2.6.2. Objektivat zhvillimore për infrastrukturën publike

OBJEKTIVI 1 - Krijimi i hapësirave të reja shëndetësore dhe shërbimeve sociale sa më afër banorëve;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

3. Ndërtimi i AMF-ve për vendbanimet me +2000 banorë dhe i QMF-ve për vendbanimet me +2000 banorë deri në vitin 2027;
4. Përfundimi dhe funksionalizimi i shtëpive të pleqve deri në vitin 2023.
5. Përmirësimi i kushteve të ofrimit të shërbimeve sociale deri në vitin 2022

OBJEKTIVI 2 - Krijimi i infrastrukturës arsimore publike para-universitare;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Plotësimi i kriterëve hapësinore të MASHT deri në vitin 2025;
2. Ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve për të gjitha lagjet urbane me mbi 2000 banorë deri në vitin 2023.

OBJEKTIVI 3 - Krijimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve;

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

3. Krijimi i E-kioskut deri në vitin 2021;
4. Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe efikase përmes teknologjisë moderne të telekomunikimit në vitin 2024.

4.2.7. Infrastruktura sociale

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës sociale, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:



4.2.7.1. Qëllimet zhvillimore për infrastrukturën sociale

- QËLLIMI 1 - Sigurim i hapësirave për kulturë nëpër vendbanime sipas funksionit dhe hierarkisë;
- QËLLIMI 2 - Sigurimi i hapësirave për aktiviteteve sociale, sport dhe rekreacion sipas funksionit dhe hierarkisë;
- QËLLIMI 3 - Zgjerimi dhe përmirësimi i hapësirave të varrezave të reja të qytetit dhe fshatrave.

4.2.7.2. Objektivat zhvillimore për infrastrukturën sociale

- OBJEKTIVI 1 - Hapësira komode për kulturë nëpër vendbanime sipas funksionit dhe hierarkisë
Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:
1. Ndërtimi i një qendre të re multi-kulturore deri në vitin 2027.
- OBJEKTIVI 2 – Hapësira adekuate për aktiviteteve sociale, sport dhe rekreacion sipas funksionit dhe hierarkisë;
Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:
1. Krijimi i fushave të reja rekreative sipas normave teknike deri në vitin 2024.
 2. Ndriçimi i fushave ekzistuese sportive të institucioneve arsimore, për të u shfrytëzuar nga banorët e lagjeve, jashtë orarit mësimor deri në vitin 2024.
 3. Ndërtimi i sheshit publik në qendër të qytetit deri në vitin 2021.
- OBJEKTIVI 3 Hapësira të mjaftueshme për aktiviteteve sociale, sport dhe rekreacion sipas funksionit dhe hierarkisë.
Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:
1. Plotësimi i normave hapësinore për varreza prej 1.50m² për banor për të gjitha vendbanimet deri në vitin 2024.

4.2.8. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.8.1. Qëllimet zhvillimore për mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

- QËLLIMI 1 Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor
- QËLLIMI 2 Parandalimi i ndotjes së mjedisit nga Agro-Zona dhe Zona Industriale
- QËLLIMI 3 Mënjanimi i fatkeqësive natyrore

4.2.8.2. Objektivat zhvillimore për mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

- OBJEKTIVI 1 - Trajtimi i ujërave të zeza në mbrojtje të ndotjes së mjedisit
Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:
1. Ndarja e rrjetit të kanalizimit të ujërave fekal dhe atmosferik në të gjitha vendbanimet me mbi 1500 banorë dhe deri në vitin 2026.
 2. Ndërtimi impiantit për trajtimin e ujërave të zeza deri në vitin 2024.
 3. Përgatitja e studimit të fizibilitetit për furnizim përmes sistemit të integruar të ngrohjes qendrore.
- OBJEKTIVI 2 - Mjedis i pastër nga Agro-Zona dhe Zona Industriale
Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:
1. Ndërtimi impiantit për trajtimin e ujërave industrial në Agro-Zonë deri në vitin 2022.
 2. Ndërtimi impiantit për trajtimin e ujërave industrial në Zonë Industriale deri në vitin 2023.



3. Mbjellja e drunjtëve shtatlartë gjethembajtëse përgjatë perimetrit të Agro-Zonës dhe Zonës Industriale.

OBJEKTIVI 3 - Mënjanimi i fatkeqësive natyrore

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Në objektet e veçanta si dhe në objektet shumëkatëshe, duhet të punohen me arkitekturë a-sizmike;
2. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve;
3. Ndërtimi i tarracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese;
4. Ndërtimi i argjinaturave dhe mbjellja e fidanëve pyjore përgjatë brigjeve të lumenjve deri në vitin 2022;
5. Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatijet e rrëpishme deri në vitin 2022;
6. Ndërtimi i mureve rezistuese deri në vitin 2022.

4.2.9. Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.9.1. Qëllimet zhvillimore për asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

QËLLIMI 1 Ruajtja e zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës;

QËLLIMI 2 Regjistrimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore;

4.2.9.2. Objektivat zhvillimore për asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

OBJEKTIVI 1 - Ruajtja e zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës

Me qëllim të përmbushjes së qëllimit të lartpërmendur përcaktohen objektivat vijuese:

1. Definimi i zonave, shenjëzimi dhe përmirësimi i zonave me vlera të rralla natyrore deri në vitin 2021.

OBJEKTIVI 2 - Regjistrimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore

1. Identifikimi, inventarizimi, dhe shenjëzimi i trashëgimisë kulturore deri në vitin 2021.
2. Hartimi i Planit 25-vjeçar të Konservimit të Trashëgimisë Arkitekturale deri në vitin 2021.

4.2.10. Vendbanimet

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të vendbanimeve në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit dhe në përputhje me Përcaktimin kufijve të Tokës ndërtimore në bazë dispozitave dhe kritereve të përcaktuara me U.A. MMPH Nr. 08/2017, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.10.1. Qëllimet zhvillimore për vendbanimet

QËLLIMI 1 Zhvillimi kompakt i vendbanimeve me infrastrukturë moderne

Objektivat zhvillimore për vendbanimet

OBJEKTIVI 1 - Përgatitja e dokumenteve të planifikimit hapësinor

1. Kufizimi i ndërtimeve brenda kufijve ndërtimor deri në vitin 2026;



2. Përcaktimi i lokacioneve dhe kushteve për zhvillimin e infrastrukturës moderne përmes Hartës Zonale deri në vitin 2020;

4.2.11. Banimi

Bazuar në gjendjen ekzistuese, rritja e popullsisë dhe të amvisërive si dhe ndryshimet në strukturat e tyre, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të vendbanimeve joformale në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.11.1. Qëllimet zhvillimore për Banimin

Qëllimi 1 –Përmirësimi i kushteve të banimit

Qëllimi 2 –Ngritja e kapaciteteve për sigurim të banimit për familje me të ardhura të ulëta, për të moshuar, familje të dëshmorëve

4.2.11.2. Objektivat për banimin

OBJEKTIVI 1 –Renovimi i objekteve kolektive të banimit;

OBJEKTIVI 2 –Përfundimi i Ndërtimit të shtëpisë së pleqve dhe personave pa përkujdesje;

OBJEKTIVI 3 – Ndërtimi i banesës në bazë të programit të veçant të banimit;

4.2.12. Vendbanimet joformale

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të vendbanimeve joformale në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit dhe në përputhje me Planifikimi i zhvillimit të Vendbanimeve formale dhe Vendbanimeve Joformale sipas U.A. MMPH Nr. 08/2017, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.12.1. Qëllimet zhvillimore për Vendbanimet joformale

Qëllimi 1 –Rregullimi i statusit të pronës për vendbanimet ekzistuese joformale;

4.2.12.2. Objektivat për vendbanimet joformale

OBJEKTIVI 1 - Vendbanimet Joformale me status të rregulluar pronësor

1. Përgatitja dhe miratimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për vendbanimet joformale deri në vitin 2022;
2. Rregullimi i çështjeve pronësore deri në vitin 2024.

4.2.13. Shfrytëzimi i tokës

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të shfrytëzimit të planifikuar të tokës në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit dhe në përputhje me Planifikimi i zhvillimit të Vendbanimeve formale dhe Vendbanimeve Joformale sipas U.A. MMPH Nr. 08/2017, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.13.1. Qëllimet zhvillimore për shfrytëzimin e planifikuar të tokës

QËLLIMI 1 Përgatitja e dokumenteve të planifikimit hapësinor;

4.2.13.2. Objektivat zhvillimore për shfrytëzimin e planifikuar të tokës

OBJEKTIVI 22 - Përgatitja e dokumenteve të planifikimit hapësinor

1. Përgatitja dhe miratimi i Hartës Zonale të Komunës deri në vitin 2020;



2. Përgatitja dhe miratimi i të gjitha Planeve Rregulluese të Hollësishme për zonat urbane deri në vitin 2021;
3. Përgatitja dhe miratimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për nënqendrat sekondare deri në vitin 2023;

4.3. Koncepti i zhvillimit hapësinor

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara, dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna së Suharekës ka planifikuar Konceptin e Zhvillimit Hapësinor vijues, i cili cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes propozimeve konkrete zhvillimore në territorin e komunës për secilin sektor.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor ka për synim të përcaktojë bazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të tokës gjatë procesit të vendim marrjes dhe hartimit të kushteve zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës.

Konceptet mundësojnë thjeshtësimin e marrjes së vendimeve lidhur me zhvillimet e ardhshme në hapësirë. Nga analizat e kryera të gjendjes së zhvillimit hapësinor të komunës së Suharekës dhe faktorëve natyror, janë shkoqitur dy treva kryesore të cilat dallohen për kah gjeomorfologjia e formave të relieftit dhe mbulesa e tokës e cila kushtëzon edhe nivelin e zhvillimit në këto treva. Është pjesa e rrafshinës me tokë bujqësore të kualitetit të lartë dhe pjesa kodrinoro malore e pasur me pyje dhe kullosa.

Kushtet e tilla natyrore kanë diktuar edhe zhvillimin në shkallë të vogël që është konsideruar si përparësi për realizimin e vizionit.

Rezultatet e analizës së koncepteve të zhvillimit hapësinor kanë rezultuar me tri elemente qenësore të zhvillimit hapësinor:

- Shkoqitja e zonave të komunës në bazë të veçorive gjeomorfologjike dhe mjedisore si dhe resurseve natyrore
- Rrjeti hierarkik i vendbanimeve bazuar në funksionin e tyre për ofrimin e shërbimeve administrative, ekonomike dhe sociale për banorët e vendbanimit dhe vendbanimeve që gravitojnë përreth.
- Rrjeti hierarkik i rrugëve bazuar në lidhjet e trafikut në mes të vendbanimeve brenda territorit të komunës dhe me vendbanimet në komunat fqinje
- Koncepti kryesor i zhvillimit hapësinor shprehë kornizën themelore të mundësive të zhvillimit sektorial të komunës së Suharekës.

Në vazhdimësi do i paraqesim disa përmbajtje, analiza dhe faktor të cilët janë marrë për bazë për zhvillimin e Konceptit të zhvillimit hapësinor nëpërmes skenarëve:

4.3.1. Mbrojtja e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Në kuadër të dokumentit janë analizuar faktorët të cilët ndikojnë në sipërfaqet me rrezikshmëri të cilat ndikojnë në mjedis si tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshëri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse të njerëzve, të shtazëve dhe të bimëve dhe fatkeqësi të tjera që i shkakton natyra. Në kuadër të fatkeqësive të tjera, janë analizuar fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje. Pastaj janë parashikuar gjendjet e jashtëzakonshme, ato emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rrymë, telekomunikacioni dhe teknologjia informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikut masiv. Nga grupet punuese, është konstatuar se njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është tërmeti. Prandaj është parashikuar që duhet marrë masa për të lëvizur nga kultura e reagimit, në kulturën e marrjes së masave për amortizim dhe minimizim të dëmeve.



Trashëgimia kulturore është pasqyrë e vlerave dhe e nivelit kulturor të një vendi. Trashëgimia kulturore është rezultat i procesit të lidhur me zhvillimin e shoqërisë moderne dhe përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor, dhe shërben edhe si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për brezat e ardhëm. Trashëgimia kulturore duhet të mbrohet sepse është pasuri e pa ripërtërishme, dhe gjurmët kulturore janë vazhdimisht nën trysinë e zhdukjes dhe zëvendësimit me të rejtë. Trashëgimia kulturore përbëhet nga lloje të ndryshme pasurish që ndërlidhen me një shumëllojshmëri mjedisesh.

Përpos që trashëgimia natyrore dhe kulturore shërben për të lidhur brezat e rinj me brezat paraardhës, kjo pasuri nën trajtimin e duhur mund të vendos Suharekën si destinacion ndërkombëtar për turistë duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe përforcuar identitetin e një vendi dhe shoqërie. Vlerat mund të përkufizohen si cilësi relative sociale të që mund të ndryshojnë gjatë kohës. Në rastin e trashëgimisë kulturore, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë lokacioneve që perceptohen si bartëse të vlerave kulturore, duke mos anashkaluar edhe aspektin ekonomik. Disa prej vlerave mund të jenë të lidhura më ngushtë me aspektet thelbësore të monumentit apo lokacionit ndërsa vlera të tjera mund të jenë të lidhura me vendndodhjen gjeografike të burimit dhe marrëdhënien e tij me mjedisin rrethues. Mirëpo, buxheti i Komunës dhe i MKRS-ës është shumë i kufizuar për intervenimet e duhura për të restauruar të gjitha pasuritë e trashëgimisë kulturore përbrenda Komunës.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara, dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Komuna e Suharekës ka planifikuar Konceptin e Zhvillimit Hapësinor vijues për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore, i cili cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes propozimeve konkrete zhvillimore në territorin e komunës.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të propozuara të planifikuara dhe propozimet për zhvillim duke u bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara.

Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit trashëgimisë natyrore dhe kulturore, Plani Zhvillimor Komunal ka planifikuar mbrojtjen dhe zhvillimin e kontrolluar të zonave vijuese:

4.3.1.1. ZONA JUG-LINDORE — “Malet dhe Natyra”

Zona Jug-Lindje përbëhet kryesisht nga malet dhe pjesërisht ka tokë bujqësore dhe livadhe e kullosa të klasit VI, me blegtorinë si veprimtari kryesore ekonomike. Në kuadër të kësaj zone është edhe Parku Nacional “Malet e Sharrit” që konsiderohet si një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit të bazuar në atraksionet natyrore. Peizazhi i kësaj zone është dinamik me lartësi të ndryshueshme mbidetare prej 520 deri 1930m lartësi mbidetare, me një llojlojshmëri të atraksioneve natyrore, pamjeve dhe përjetimeve të mrekullueshme të peizazhit. Kjo zonë është po ashtu e njohur për ajrin e pastër, qytetarët e shfrytëzojnë për pushime dhe rekreacion zakonisht gjatë verës e posaçërisht personat me probleme të frymëmarrjes për qëllime shëndetësore. Shfrytëzimi ekstensiv i pyjeve ofron mundësi për format e ndryshme të turizmit të malor e bazuar në resurse natyrore i cili në anën tjetër është komplementar me mbrojtjen e mjedisit.

Shumica e veprimtarive ekonomike të cilat mund të zhvillohen në zonën e Jug-Lindjes janë të lidhura me shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës. Veprimtaritë që zhvillohen këtu interferojnë me veprimtaritë në zonën Veri-Perëndim nga Malet e Carralevës dhe të Pagarushës, për shkak se këto dy zona shkrihen njëra me tjetrën.

Kjo zonë ka një dendësi shumë të ulët të popullsisë; vetëm 5% të numrit të tërësishëm të banorëve të komunës së Suharekës jetojnë në këtë zonë e cila përfshinë afërsisht 25% të sipërfaqes së territorit.



Sub-qendër për këtë zonë është Mushtishti, edhe pse ai gjendet në pjesën kufitare me zonën Jug-perëndim.

4.3.1.2. ZONA VERI — “Kodrinat dhe Llojlojshmëria e Natyrës”

Zona Veri përfshinë pjesën veriore të komunës së Suharekës që kryesisht është zonë kodrinore. Edhe pse nuk ekziston ndonjë kufi i qartë me dy zonat tjera, pjesa veriore mbulon afërsisht 40% të territorit të komunës. Në këtë zonë janë një numër i fshatrave të vogla me afërsisht 18% nga numri i tërësishëm i banorëve të komunës.

Toka është e kualitetit VI dhe VII, kurse lartësia mbidetare nga 500 – 970m lartësi mbidetare. Trajatat tipike gjeografike të kësaj zone janë kodrinat, livadhet dhe pyjet. Struktura e vendbanimeve është e shpërndarë, posaçërisht në pjesën lindore. Të gjitha këto elemente fiziko gjeografike, si kombinim i pamjeve të fshatrave të rrethuara me kodrina, krijojnë një imazh të peizazheve skenike. Qendër me ndikim në këtë zonë është Bllaca, e cila sipas PZHK 2008-2018, ishte e planifikuar të bëhet sub-qendër. Meqenëse Duhla është një qendër lokale përgjatë rrugës magjistrale Prishtina-Suharekë-Prizren, si epiqendër e fshatrave të zonës veriore të zhvillohet në nivel të sub-qendrës.

4.3.1.3. ZONA QENDRORE — “Korridori rekreativo-ekologjik i Toplluhës”

Zona qendrore shtrihet përgjatë shtirjes së lumit më të madh i komunës dhe arteries kryesore hidrografike, lumit Toplluha. Duke marrë parasysh që përgjatë brigjeve të lumit nuk ka ndërtime, kjo pasuri natyrore është një mundësi e mirë për të zhvilluar një rrjetë ekologjik, i cili mund të zhvillohet brenda një periudhe afatgjate për ecje, çiklizëm, dhe hapësira rekreative.

Shumica e lumenjve të Kosovës janë të mbuluara, apo nuk gëzojnë qasje publike përgjatë shtrirjes së tyre dhe Suhareka ka mundësi të mirë që të zhvillojë një korridor të pandërprerë ekologjik, që ofron pamje të bukura dhe atraktive të mjedisit rrethues.

4.3.1.4. Zhvillimi ekonomik i propozuar

Vlerësimi i ndikimit të kornizës së zhvillimit të kësaj fushe në aspektin ekonomik ofron mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm efikas dhe reflektues në kërkesat dhe ofertat, korniza ofron më shumë më tepër nëse krahasohet me skenarin e bërjes asgjë por edhe nëse krahasohet me një standard të kohës, zhvillimet e analizuara dhe parashikuara shkojnë në drejtimin e plotësimit të standardeve të kohës për zhvillim të qëndrueshëm duke ofruar aktivitete gjithëpërfshirëse, shumëdimensionale dhe në funksion të zbatimit të politikave ekonomike.

Në aspektin social vlerësohet se zhvillimi ekonomik i paraparë me këtë kornizë do të krijoj bazat për zhvillim më të qëndrueshëm social dhe mirëqenie sociale duke përfshirë zbutjen e varfërisë dhe papunësisë por edhe rritjen e shansit të arsimimit dhe profesionalizimit deri te plotësimi i një kënaqësie më të madhe qytetare. Në këtë dimension në aspektin mjedisor vlerësohet se zhvillimi ekonomik i paraparë me këtë kornizë do të krijoj bazat që aktivitetet të zhvillohen në atë mënyrë që të jenë — miqësore ndaj mjedisit në përgjithësi. Ndikimi i ndotjeve të ajrit, ujit, tokës të jetë në kufijtë e të tolerueshmes, duke paraparë masat dhe standardet qysh nga aplikimi për zhvillim të caktuar duke krijuar të ashtu quajturën paketë të kushteve urbane dhe hapësinore.

Parashikimi i dëshiruar hapësinor për territorin e komunës së Suharekës në fushën e regjenerimit të zhvillimit ekonomik, duke përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë dhe fushat tjera bazohet në analizën e situatës komunale dhe vizionin, parimet dhe prioritetet strategjike që rezultuan nga procesi pjesëmarrës në hartimin e këtij dokumenti por edhe nga Strategjia e zhvillimit ekonomik të Suharekës. Në këtë drejtim komuna parasheh që:



Orientimi themelor i zhvillimit të qëndrueshëm, prodhues-ekonomik dhe miqësor ndaj mjedisit, në Komunën e Suharekës deri në vitin 2024, duhet të jetë i tillë që të mundësojë realizimin e Vizionit, qëllimeve dhe detyrave në zhvillimin e pikëpamje të nivelit të zhvillimit krahasuar me komunat me zhvillimi më të lartë në rajon dhe Kosovë.

Periudha e ardhshme në këtë pikëpamje duhet të jetë kthesë dhe kualitet i ri sa i përket zhvillimit të Komunës. Orientim themelor i zhvillimit të komunës së Suharekës gjatë periudhës së ardhshme duhet të jetë në shfrytëzimin e pozicionit, resurseve dhe infrastrukturës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Suhareka si komunë falë pozitës së përshtatshme gjeografike, ka kushte të favorshme që bujqësia të jetë edhe për një kohe të gjatë njëra ndër veprimtarit kryesore të ekonomisë. Zhvillimi i bujqësisë, në kushtet që lidhen me rrethanat e përgjithshme në Kosovë, kontributi i bujqësisë do të jetë mjaft i rëndësishëm për komunën, falë kushteve pedologjike, klimatike dhe sistemet e parapara për ujitje, që do të bëjnë të mundshëm që të ndryshojë struktura e shfrytëzimit të tokës së punueshme dhe të rritet vëllimi i prodhimit bujqësor. Është e domosdoshme që në bujqësi të bëhet integrimi, duke e lidhur kështu prodhimin me përpunimin.

Partneritetet publiko private në prodhimin bujqësorë, në industrinë përpunuese dhe në plasmanin e produktit paraqesin një nga parakushtet themelore zhvillim të bujqësisë në funksion të zhvillimit ekonomik.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për zhvillimin e propozuar ekonomik cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave. Zgjerimet e kufijve të tokës ndërtimore do të jenë të bazuara në llogaritje matematike dhe të normuara sipas NTPH duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të komunës për 8 vitet e ardhshme përmes tërësive të zgjidhjeve të propozuara të planifikuara dhe propozimet për zhvillim duke u bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara të komunës së Suharekës, vizioni është i bazuar në të gjitha deklaratat sektoriale por në mënyrë të veçantë do i sqarojmë ato më specifike për komunën dhe këto deklarata janë zbërthyer në katër strategjitë kryesore, ndërsa deklaratat tjera sektoriale janë zbërthyer te qëllimet objektivat, prioritetet strategjike etj., në vazhdimësi do prezantojmë këto katër strategjitë kryesore të ndërlidhura me ndërveprimet vijuese:

4.3.1.5. Agrikultura si pjesë e Konceptit të zhvillimit të konceptit është i bazuar në:

Zhvillimi i bio-agrikulturës, përpunimi i prodhimeve bujqësore, Fuqizimi i Agro-Zonës, Zhvillimi i silvikulturës, Qendër aftësimi/trajnimi zanatesh, Sipërfaqe aplikimi dhe hulumtimi, marketingu për prodhimet e përpunuara.

- Ky koncept bazohet në:
- Kualiteti i lartë i tokës bujqësore;
- Shoqata e fermerëve;
- Tradita.

Suhareka ka ekonomi të qëndrueshme dhe krijon vlera lokale përmes rafinimit të prodhimeve bujqësore. Bio-agrikultura është mirë e themeluar. Prodhimet kryesore të ushqimit të përditshëm prodhohen dhe shiten në komunë. Shumëllojshmëria a prodhimeve agrikulturore përfshinë:

- Frutat dhe perimet;
- Bimët mjekësore dhe erëzat;
- Blegtoria (shpezët, bagëtia e trashë dhe e imët);
- Prodhimet e qumështit;



- Prodhimet e bletarisë;
- Drithërat.

Prodhimet bujqësore prodhohen në kuadër të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Hapësirat e mirëfillta për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore mundësojnë prodhimtari efikase.

Pajisjet kolektive për rafinim dhe tretman special janë të themeluara në lokacione strategjike me qëllim të transportit më të shkurtë dhe prodhimit të menjëhershëm të të mirave. Niveli i lartë i kualitetit dhe prodhimtaria bujqësore është e lokalizuar në tokën posaçërisht të mbrojtur për bujqësi.

Profesionistët e rinj në Agrikulturë janë të trajnuar në shkollat e mesme profesionale për agrikulturë, të cilat gjithashtu ofrojnë hapësira për hulumtime dhe laboratorë. Përpos njohurive në prodhimtarinë bujqësore dhe rafinimin, shkolla fokusohet edhe në njohuri për marketing.

Shkolla profesionale ofron edhe pajisje për të mësuarit gjatë tërë jetës (arsimim pa marr parasysh moshën), seminare dhe kurse për grupe të ndryshme dhe njësi të përkohshme trajnimi.

Eksperienca e gjatë në fushën e bujqësisë së bashku me njohuritë moderne të stafit të shkollës profesionale, forcon pozitën e Suharekës në tregun e Kosovës. Masat e marketingut aktiv për prodhimet regjionale nënvizojnë strategjinë ekonomike.

4.3.1.6. Turizmi

Koncepti i zhvillimit të turizmit është zhvillimi i:Infrastrukturë Turistike, Ruajtjes së dukjes së qytetit dhe peizazheve, Mbrojtjes së ambientit, Qendrës Trajnimi, Përmbajtjeve për sport të bazuar në natyrë, Interesimit në natyrë, Eksperiencës kulturore, Interesimit për jetën në fshat, Rekreacionit, Shëndetit, Koncepteve të qëndrueshme turistike.

Ky koncept bazohet në:

- Peizazhet e bukura;
- Resurset Natyrore;
- Monumentet Kulturore.

Peizazhi i bukur i komunës është element kyç për turizëm të qëndrueshëm i koncentruar në “turizëm të butë”. Infrastruktura turistike zhvillohet paralelisht me tendencat për mbrojtjen e vendbanimit, peizazhit dhe mjedisit.

Koncepti i turizmit fokusohet në potencialet natyrore të komunës:

Strehimi dhe infrastruktura turistike (si restorantet, kafiteritë, baret etj.) për familjet me fëmijë dhe persona të cilët çmojnë elementet e aktiviteteve të bazuara në natyrën, janë të vendosura në lokacione të përshtatshme ose të ofruara në fshatra. Llojet e strehimeve janë bujtina me shtrat-dhe-kaftjall për familjet me buxhet të vogël, kampe pushimi për fëmijë, shtëpi të vogla për mysafirë dhe qendra për kurim (shëndetësi) dhe rekreacion e lokalizuar në parkun nacional. Strehime tjera janë të ofruara nga fermerët të cilët japin me qira dhomë ose shtëpi të vogla për persona që kanë interesim në traditën bujqësore dhe blegtorale.

Aktivitetet turistike janë të koordinuara nga koordinatori për turizëm në komunë, i cili punon në qendrën lokale informative për turizëm. Qendra për informim për turist ofron informata për mundësitë e akomodimit dhe zhvillon konceptet për infrastrukturën turistike shtesë dhe aktiviteteve të lira si ekskursionet ose ngjarje të ndryshme.

Seminaret dhe kurset e niveleve të ndryshme të trajnimit të stafit kualifikues, përkohësisht ofrohet në komunë me qëllim që të siguroj kualitet të shërbimeve turistike. Komuna përkrah sinergjitë mes turizmit, bujqësisë dhe ndërmarrjeve të vogla.



Energjia ripërtëritshme

Koncepti i zhvillimit energjisë së ri-përtëritshme është: Zhvillimi i “Parqeve Eolike” në Duhël dhe në Budakovë, ndërtimi i hidrocentralit pranë liqenit akumulues të Dragaçinës. Ky koncept bazohet në: Kapacitet prodhuese të Resurseve Natyrore.

Shembulli i komunës në vënien e masave për konceptin e energjisë efikente në bashkëpunim me kontraktues të specializuar, është mirë e themeluar dhe në funksion. Përmes kursimeve nga kostoja e energjisë, komuna mund të harxhoj më shumë mjete (para) në zhvillimin e masave të infrastrukturës.

Fokusi i komunës në aktivitetet e bazuara në energji është në ndërtesat e qeverisura nga komuna (si institucionet shëndetësore, shkolla, zyra lokale etj.). Të motivuar nga të arriturat dhe kursimet e komunës, ndërmarrjet private gjithashtu kanë implementuar konceptin e energjisë në industri dhe hotele. Përmes bartjes së njohurive për potencialin e mënyrave bashkëkohore për buxhetet e energjisë, po ashtu këto metoda depërtojnë edhe në ndërtesat e banimit.

Tema e energjisë ripërtëritëse dhe kursimeve të energjisë ka zhvilluar një fushë të re për ekonominë lokale si dhe për trendet e ardhshme për Kosovën. Ndërmarrjet e specializuara në këtë fushë ofrojnë njohuritë e veta për komunën dhe tërë vendin. Stafi është i trajnuar drejtpërdrejtë nga këto ndërmarrje në komunë dhe kanë arsimim edhe nga kurset speciale të organizuara nga ekspertët e kësaj fushe.

4.3.1.7. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Koncepti i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes: Agjencia për lokacione, Qendër për ndërmarrës të rinj, Zonat e biznesit dhe zonat industriale me infrastrukture adekuate, Furnizim Konstant

Ky koncept bazohet në:

- Peizazhet e bukura;
- Resurset Natyrore;
- Monumentet Kulturore.

Nisur nga pozita e mirë gjeografike e komunës mes Prishtinës dhe Prizrenit, dhe potencialit të fuqisë punëtore lokale, pozita ekonomike e Suharekës është mirë e themeluar.

Punësimi rajonal është mirë i balancuar nisur nga kërkesat e mëdha për punëtorët e prodhimtarisë dhe rafinimit bujqësorë.

Fuqitë ekonomike rajonale janë të lidhura me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe industrive dhe bizneseve me emetim të ulët. Fokusi i ndërmarrjeve lokale është i orientuar në prodhimtarinë bujqësore, shërbime dhe konsultimeve për energji ose zgjidhjeve energjetike.

Atraktiviteti ekonomik i lokacionit të Suharekës është i theksuar nga promovimi strategjisë së tregut e cila përfshinë konceptet për:

- Ndërmarrësit e rinj;
- Kosovarët nga diaspora;
- Ndërmarrjet me qëllim/dëshirë të zgjerimit;
- Asociacionet e tregtisë;
- Gratë.

Industritë dhe bizneset të cilat i përpunojnë resurset regjionale janë të përkrahura nga agjencia regjionale për marrëveshje që është përgjegjëse për hulumtim profesional të lokacioneve si dhe menaxhim të tyre. Agjencia i administron hapësirat e siguruara nga komuna për zhvillim ekonomik si dhe lokacionet private për investitorët e jashtëm.



Në kuadër të zonave të krijuara biznesore dhe industriale sigurohet infrastruktura dhe lidhjet efikase me rrjetin regional rrugor. Hapësira e parkut komunal të biznesit është e pajisur me furnizim vetanak të energjisë të bazuar në format e përsëritshme të energjive regionale. Kjo siguron furnizim të përhershëm me energji për ndërmarrjet.

Profesionistët e rinj trajnohen për zhvillim ekonomik dhe marketing me anë të seminareve dhe kurseve në shkollat profesionale. Përkrahje e ndërmarrësve të rinj bëhet përmes “qendrës lokale për nxitje të biznesit” (“start-up-centre”) ku ndërmarrjet mund të shfrytëzojnë infrastrukturën e përbashkët dhe të kenë përfitime të ndërsjella.

Kjo qendër ofron:

- shërbime në kuadër të zyrave;
- çmime të ulëta fillestare të qirasë;
- këshillime për kontabilitet;
- qendrën e përbashkët të plasimit të produkteve;
- këshilla juridike;
- këshilla mbi tatimet;
- hapësira për seminare.

4.3.2. Infrastruktura teknike

Zhvillimi i infrastrukturës teknike duhet të bazohet në planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ujitjes, drenazhimit, telekomunikacionit, dhe infrastrukturës për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në komunë. Projektet e infrastrukturës në të ardhmen duhet të planifikohen dhe realizohen në dinamikën që do të kontribuojë në përsheptimin e procesit të rigjenerimit ekonomik. Në bazë të përgjegjësisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përgjegjës për organizimin publik dhe zhvillimin e infrastrukturës publike brenda territorit administrativ të komunës së Suharekës, është Kryetari i komunës i cili është organi më i lartë ekzekutiv i pushtetit lokal në bazë të përgjegjësisë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi!

Shërbimet e transportit publik paraqesin segmentin shumë të rëndësishëm për zhvillimin e Komunës për të mundësuar lëvizjen – drejt vendeve të punës, arsim dhe edukim, shëndetësi, tregti, përmbajtje publike dhe rekreacion. Transporti publik është një faktor përmbajtësor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor dhe luan rol shumë të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis hapësirave dhe destinimeve të tyre. Përpos që ndikon pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirëson gjendjen socio-ekonomike të banorëve, përmirësimi i shërbimeve të transportit publik minimizon shpenzimet e investimeve kapitale për zgjerime të rrugëve, si dhe krijon vende të reja të punës në kornizën afatgjate kohore.

Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar disa qëllime dhe objektiva duke u bazuar në vlerësimin e shtrirjes dhe gjendjes së rrugëve ekzistuese, kategoritë e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror, intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive, modeleve të qarkullimit të trafikut, linjave transportuese ndër-komunale brenda komunës (urbane dhe rurale), shfrytëzimin e rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit, dhe të hapësirave ekzistuese për parkim.

Duke qenë se komuna është organi më i lartë ekzekutiv në nivelin e pushtetit lokal dhe duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë që ka zhvillimi i infrastrukturës së përgjithshme e në veçanti infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit, trajtimit të ujërave të ndotura dhe ujërave atmosferike, për cilësinë e standardit për jetën e popullsisë dhe zhvillimit socio – ekonomik në përgjithësi, komuna me organet e tjera të administratës lokale ka pa dyshim rolin vendim-marrës në këtë drejtim. Pra, kjo thekson interesin dhe përgjegjësinë e komunës për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për jetën e banorëve jo vetëm për pjesën e cila tani më është e



përfshirë me këtë rrjetë të infrastrukturës, por edhe për pjesët të cilat ende nuk janë përfshirë me këtë shërbim.

Rrjeta dhe cilësia e infrastrukturës së paraparë do të paraqet bazën e integritit hapësinorë dhe parakushtin e parë të arritjes së zhvillimit harmonik. Lidhja integrale e infrastrukturës në hapësirë, do të jetë prioritet përmbajtjesor i Planit Zhvillimor Komunal për hapësirën e Komunës së Suharekës. Drejtimet themelore të infrastrukturës do të iniciojnë polarizimin e potencialeve ekonomike si dhe koncentrimin e popullsisë. Drejtimet e parapara, në radhë të parë, cilësia e tyre, integrimi i të gjitha mundësive transportuese që posedon komuna e Suharekës dhe rëndësia funksionale duhet t'i kontribuojnë realizimit të drejtpeshimit hapësinor dhe të përgjithshëm të Komunës së Suharekës. Infrastruktura në Komunën e Suharekës duhet të sigurojë integrimin racional territorial të ekonomisë, integrimin e hapësirës me rajonet në fqinjësi dhe në kohë dhe hapësirë të caktuar, të sigurojë efekte përkatëse në zhvillimin e funksioneve të tjera.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara, dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, ekipet punuese të Komunës së Suharekës kanë planifikuar Koncepti i Zhvillimit Hapësinor vijues për infrastrukturën teknike, i cili cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes propozimeve konkrete zhvillimore në territorin e komunës.

1. Transporti dhe transporti publik

Duke marrë parasysh kontekstin e ri që ka krijuar ndërtimi i autoudhës Prishtinë – Merdare, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për transportin dhe transportin publik, ka paraparë:

- Hartimin e Planit të Mobilitetit;
- Zgjerimi i stacionit të regjional autobusëve;
- Ndërtimi i rrugës Zonë Industriale – Studençan;
- Ndërtimi i rrugës transit Zonë Industriale – kyçja në Autoudhë;
- Ndërtimi i rrugës transit në pjesën lindore të zonë urbane;
- Ndërtimi i rrugës se re Mushtisht (L. Bahqevc) – Sallgrazhdë – Greikoc;
- Ndërtimi i rrugës se re Greikoc – Korishë;

2. Energjia elektrike

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për energjinë elektrike, ka paraparë:

- Prodhimin e energjisë elektrike për mullinjtë të erës.
- Prodhimin e energjisë elektrike prej panelave solarë.
- Prodhimin e energjisë elektrike përmes hidrocentralit.

3. Energjia termike

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për energjinë termike, ka paraparë:

- Hartimin e studimit të fizibilitetit për ngrohje qendrore.

4. Rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit, ujitjes dhe drenazimit

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për ujësjellës, kanalizim, ujitje dhe drenazhim, ka paraparë:

- Ndarjen e kanalizimit të ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferik;
- Ndërtimi i akumulacionit ujor në Dragaqinë me kapacitet të vëllimit ujor prej 6.8 milion m³;
- Ngjitja e kapaciteteve me tre rezervuarë shtesë deri në 3,000m³;
- Ndërtimi i rrjetit të ujitjes së tokës bujqësore në pjesën jug-lindore të Komunës.



5. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave në Komunë

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për grumbullim dhe menaxhim të mbeturinave në Komunë, ka paraparë:

- Zgjerimi i rrjetit të grumbullimit të mbeturinave në të gjitha vendbanimet.

4.3.3. Infrastrukturën publike dhe sociale

Mbrojtja primare në shumicën e vendeve të zhvilluara tani ballafaqohet me sëmundje kronike çrregullimet gjatë zhvillimit, çrregullimet e sjelljes, aksidentet dhe një numër i madh i sëmundjeve infektive të cilat më pare ishin fatale. Mjeku familjar dhe ekipi i KPSH janë duke marrë gjithnjë e më tepër përgjegjësi më të madhe për promovimin e shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve përmes planifikimit të familjes, imunizimit, këshillave kundër pirjes së duhanit dhe faktove tjerë të mënyrës personale të jetesës.

Mjekësia familjare është trung i diturisë që bazohet në praktika familjare. Roli i mjekut familjar është të merret me familjen, individin, të bashkëpunoj me profesionistët tjerë shëndetësor dhe të punoj në ekipet e KPSH pasi është klinikist. Për të i realizuar këto shërbime synojmë një mjekë (specialist i mjekësisë familjare) dhe dy infermiere të trajnuar të mjekësisë familjare në 2000 banorë përkatësisht, 5 mjekë dhe 10 infermiere në 10,000 banorë. Në çdo lokalitet ku kemi 2000 - 2500 banorë synojmë të kemi AMF ndërsa vendbanimet me mbi 4,000 banorë, nevojitet të ndërtohet një QMF, që i shërben banorëve të saj dhe fshatrave rrethues. Pas analizës së situatës në nivel komunal dhe njohjes së rolit të komunës së Suharekës në sistemin edukativ që përveç tjerash shtrihet edhe në mirëmbajtje të infrastrukturës arsimore e përbërë edhe nga objektet dhe pajisjet e tjera për shkollë, transport dhe stafi arsimor, vendosjes së synimit të përbashkët nga të gjithë akterët për një shoqëri të edukuar dhe shkolluar mirë e cila në të njëjtën kohë është edhe komponent e rëndësishme e vizionit të komunës u konstatua se zhvillimet e ardhshme në këtë fushë duhet orientuar.

Ngritjen e kapaciteteve për arsimin bashkëkohor, përmirësimin e sigurisë së nxënësve, përmirësimin e cilësisë së arsimit, përfshirje të barabartë në arsim, ngritje e bashkëpunimit me prindër, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Punës, shtete e institucione të ndryshme të cilat hulumtojnë edhe kërkesat e tregut. Mbrojtja dhe siguri i lokacioneve për shkolla, përmirësim i infrastrukturës së shkollave ekzistuese dhe plotësim me infrastrukturë përcjellëse që vlen për komplet hapësirën e komunës së Suharekës ku funksion sistemi arsimor u theksua se duhet krijuar kushte dhe lejuar shkollimin privat dhe bazuar në standarde janë vlerësuar nevojat për ndërtimin e objekteve të reja shkollore me infrastrukturë përcjellëse, ndërtimi edhe i objekteve sportive me qëllim të përmirësimit të kushteve për punë dhe mësim duke përmbushur kriteret hapësinore të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prej 7m²/nxënës.

Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, Komuna synon që të modernizojë shërbimet administrative përmes shërbimeve digjitale dhe E-kiosqeve (dokumente) që ofrojnë shërbime 24-orë për banorët e Suharekës. Riorganizimi i shërbimeve administrative për banorët e Suharekës dhe ofrimi efikas i tyre është shumë i rëndësishëm për Komunën. Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar disa qëllime dhe objektiva duke u bazuar në vlerësimin e inventarit të ndërtimeve dhe hapësirave për veprimtari publike ekzistuese siç janë ato mjekësore, arsimore, postës, të administratës publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara, dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, ekipet punuese të Komunës së Suharekës kanë planifikuar Koncepti i Zhvillimit Hapësinor vijues për infrastrukturën publike dhe sociale, i cili cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes propozimeve konkrete zhvillimore në territorin e komunës.

6. Infrastruktura arsimore



Duke marrë parasysh kontekstin e ri, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për infrastrukturën arsimore dhe në harmonizim të plotë me U.A. MMPH Nr. 08/2017 dhe të dhënva nga terreni, normat minimale për sipërfaqen e parcelës dhe në përputhje me numrin e banorëve, të vendbanimeve. Të gjitha planifikimet bazohen në projeksionet e kërkesave, faktorëve socio ekonomik, karakteristikave të hapësirës/ zones, si dhe gjendjes dhe kapacitetit të shërbimeve ekzistuese duke ka paraparë:

- Ndërtimi i 3 çerdheve/kopshteve publik në zonën urbane;
- Ndërtimi i 4 shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në vendbanime rurale;
- Ndërtimi i 4 sallave sportive;

7. Infrastruktura shëndetësore

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për infrastrukturën shëndetësore dhe në harmonizim të plotë me U.A. MMPH Nr. 08/2017 dhe të dhënva nga terreni, normat minimale për sipërfaqen e parcelës dhe në përputhje me numrin e banorëve, të vendbanimeve ka paraparë:

- Ndërtimi i qendrës së re kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) në zonën urbane të Suharekës dhe shndërrimin e QKMF ekzistuese në QMF;
- Ndërtimi e 2 ndërtesave të QMF-ve në përputhje me normat;
- Nsërtimi i 3 ndërtesave të punkteve të mjekësisë familjare (PMF).

8. Shërbimet sociale

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për infrastrukturën e shërbimeve sociale i parasheh veprimet në harmonizim të plotë me U.A. MMPH Nr. 08/2017 dhe të dhënave nga terreni, për numri i banorëve, Ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare: 0.25 m²/banor, kërkesat e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme, Ndërtesat e institucioneve të komunitetit: 0.20 m²/banor. Të përcaktohen në bazë të nevojës, duke pasur parasysh aspiratat e komunitetit dhe konsiderata të tjera relevante.ka paraparë:

- Ndërtim i qendrës për punë sociale;
- Ndërtim i banimit social për 100 familje;
- Përfundimi i ndërtimit të shtëpive të pleqve.

9. Shërbimet administrative

Duke marrë parasysh kontekstin e ri të zhvillimeve të reja, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për infrastrukturën e shërbimeve administrative i parasheh veprimet në harmonizim të plotë me U.A. MMPH Nr. 08/2017 dhe të dhënave nga terreni, për numri i banorëve, Ndërtesat e institucioneve të administratës publike 0.62 m²/banor, duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme, indeksit të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh), ka paraparë:

- Krijimin dhe vendosjen e një e-kiosku pranë ndërtesës së Komunës.

4.3.4. Vendbanimet, banimi i planifikuar dhe trajtimi i vendbanimeve joformale

Duke marrë parasysh gjendjen faktike në vendbanimet dhe implikimet që reflekton kjo gjendje është konstatuar se vendbanimeve në komunën e Suharekës duhet ofruar Koncepti i urbanizimit kompakt. Synimi i këtij koncepti është që edhe nëpër fshatra zhvillimet të jenë të tilla që tentojnë shfrytëzim sa më racional të hapësirës përmes të dendësimit të ndërtimit dhe zhvillimeve brenda një hapësire të kufizuar e prezantuar përmes kufijve ndërtimor të propozuar në nivel të çdo vendbanimi. Në periudhën e ardhshme, procesi i transformimit dhe të pajisjes me përmbajtje urbane të fshatrave dhe popullsisë fshatare do të vazhdojë edhe me intensitet të shtuar, strukturat e territorit fshatar do të jenë gjithnjë e më të kompletuara.

Të bëhet zgjerimi i planifikuar i disa vendbanimeve në pronësi private por dhe komunale, që është prezantuar në hartën: Koncepti i zhvillimit të vendbanimeve. Duhet të bëhet furnizimi sa më shumë që



është e mundur me infrastrukturë urbane, i të gjitha vendbanimeve. Zhvillimi i ndërtimeve brenda kufijve të planifikuar ndërtimor, parashikohet zhvillimi dhe organizimi i prodhimit bujqësor brenda zonës së kadastrave të vendbanimit. Parashikohet zgjerimi me përmbajtje i industrisë në ato vendbanime që kanë leverdi për këtë: ndërtimi modern i objekteve të banimit dhe objekteve të tjera, renditja si duhet e veprimtarive shërbyese. Parashikohet që gjatë ndërtimit të shtëpive e lokaliteteve, të merren pëlqime sipas kushteve dhe lejeve ndërtimore dhe të respektohen më tepër normat specifike urbane për leje ndërtimore dhe angazhimi i organeve kompetente për krijimin e një klime urbanistike, sidomos për pjesët të cilat konsiderohen ende të paprekura.

Sigurimi që vendbanimet joformale janë trajtuar bazuar në udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga DPH dhe MIA sipas Ligjit L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14. Veprimet vijuese janë: Rregullimi i VBJ është çështje e planifikimit hapësinor. Sigurimi i pronës, qasje në infrastrukturë adekuate, pjesëmarrje në qeverisje, mund të sigurohet përmes Planifikimit hapësinor dhe Urbanistik. VBJ në komunën e Suharekës do të trajtohen në atë mënyrë që së pari do të identifikohen në PZHK, do të vihen si projekte me prioritet për komunën dhe pastaj të hartohet Profili dhe Analiza e gjendjes së atyre VBJ, që vijon me hartimin e PRRU për ato vendbanimeve apo me mënyra tjera të intervenimit dhe plotësime në vendbanim varësisht nga gjendja e tij. Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsye do të krijohet një bazë e të dhënave e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata e nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.

Për ndërtesat e konsideruara si ilegale, sipas ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale, komuna do të fillojë procedurën e legalizimit. Për procesin e legalizimit dhe lëshimin e lejeve valide për ndërtesë komuna do të kërkojë taksë. Përgatitja e profilit të gjendjes ekzistuese të VBJ në tërë territorin e saj do të duhej të shërbente për përcaktimin e prioritetëve për rregullimin e VBJ ndërsa do të shërbente.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara, dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, ekipet punuese të Komunës së Suharekës kanë planifikuar Koncepti i Zhvillimit Hapësinor vijues për vendbanimet, banimin e planifikuar dhe trajtimin e vendbanimeve joformale i cili cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes propozimeve konkrete zhvillimore në territorin e komunës.

10. Vendbanimet

Duke marrë parasysh kontekstin e ri, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për vendbanime, sipas U.A. 11/2015 neni 6 dhe dhe të trajtohen në Kornizë hapësinore njëherësh duke:

- Parandalimin e ndërtimeve jashtë kufjeve ndërtimor;
- Zhvillimin kompakt të vendbanimeve.

11. Banimi i planifikuar

Duke marrë parasysh kontekstin e ri, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për banim të planifikuar, sipas prognozave demografike të vendbanimeve të komunës së Suharekës për periudhën e PZHK 2019-2027, të kategorizuar sipas U.A. 08/2017 NTPH, ka paraparë:

- Ndërtimin e 15,000 njësive të reja të banimit;
- Ndërtim i banimit social për 100 familje.

12. Trajtimi i vendbanimeve joformale

Duke marrë parasysh kontekstin e ri, Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për trajtimin e vendbanimeve joformale, të kategorizuar sipas U.A. 08/2017 NTPH, ka paraparë:

- Hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme për 4 vendbanimet joformale;
- Rregullimin e statusit ligjor mbi pronësinë e tokës.



4.3.5. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Planifikimi i përdorimit të tokës për dhjetë vitet e ardhshme në komunën e Suharekës, për grupet punuese ishte sfidë e veçantë pasi që në hapësirë duhej të bëhej trajtimi, identifikimi i konflikteve dhe integrimi i të gjitha zhvillimeve me përcaktimin se, çfarë lloje të aktiviteteve të përdorimit të tokës duhet të bëhen, ku ato duhet të bëhen etj. Duke i përdorur standardet ndërkombëtare dhe GIS-in, u lehtësua procesi i vendimmarrjes në kuptimin e destinimit për shfrytëzim të hapësirës dhe në këtë drejtim, grupet punuese dhe spektri i ekspertëve të kyçur në këtë proces, kanë parashikuar se toka në komunën e Suharekës në masë të konsiderueshme do të vazhdojë të jetë e destinuar dhe e ruajtur për tokë bujqësore dhe pyjore. Pjesë të tjera të tokës, do të jenë të destinuara për vendbanime apo tokë ndërtimore, zona arkeologjike, varreza, gjelbërim, rrugë, deponi të mbeturinave, korridore, industri dhe fusha e sektorë të tjerë të nevojshëm.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara, dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, ekipet punuese të Komunës së Suharekës kanë planifikuar Konceptin e Zhvillimit Hapësinor vijues për shfrytëzimin e planifikuar të tokës siç janë, bujqësi, banim, komerciale, teknologjike, industriale dhe shfrytëzim i përzieri cili cakton logjikën hapësinore dhe integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave përmes propozimeve konkrete zhvillimore në territorin e komunës dhe në përputhje me U.A. MIA Nr. 08/2017

Me këtë Plan është përcaktuar edhe destinimi i sipërfaqeve me kushtet;

E reflektimit në nevojat e gjeneratës së tanishme por pa kërcënuar edhe gjeneratat që vijnë:

- Plotësimi të kërkesave ligjore;
- Parimeve të prezantuara në kapitullin II;
- Respektim të koncepteve zhvillimore;
- Zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik;
- Zhvillimit të qëndrueshëm Social duke respektuar edhe të aspektin demografik;
- Si dhe zhvillimit Mjedisor në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit;
- Respektimit të kapacitetit të ndotjes së mjedisit;
- Ruajtjes dhe avancimit të resurseve natyrore, që sa më shumë ato të ripërtërihen dhe të shfrytëzohen në mënyrë racionale;
- Sigurimit të mbrojtjes dhe funksionimit të papenguar të vlerave natyrore të mbrojtura së bashku me rrethinën e tyre, dhe të ruajtjes në masë të madhe të vendndodhjeve dhe vendbanimeve natyrore të llojeve të egra bimë dhe shtazore dhe të bashkësive të tyre;
- Sigurimit të mbrojtjes së hapësirës së ndërtuar;
- Sigurimit të kushteve për pushim dhe rekreacion të njeriut.

Të gjitha këto që u përmendën më lartë kanë formuluar bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit. Në këtë drejtim kemi destinuar sipërfaqet për këto shfrytëzime:

- Zonë banimi
- Zonë komerciale
- Zonë industriale
- Zonë për shfrytëzim të përzieri
- Zonë ushtarake-sigurisë
- Zonë teknologjike
- Zonë rekreative-turistike
- Zonë e komunikacionit-transportit
- Zonë e shërbimeve
- Zonë bujqësore



- Zonë pyjore
- Zonë-minierë sipërfaqësore
- Sipërfaqe ujore
- Zonë e mbrojtur
- Zonë e veçantë
- Zonë e veçantë e mbrojtur
- Zonë e mbrojtur ujore
- Zonë e ndikuar nga vërshimet
- Zonë e sigurisë ushtarake
- Zonë e brezit mbrojtës
- Zonë mbrojtur arkeologjike-historike
- Sipërfaqe e mbrojtur
- Zonë urbane
- Zonë rurale

4.3.6. Nyjet

Nyjet janë hapësira që mbështesin dhe promovojnë intensitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve me funksione të ndryshme të administratës, ekonomisë dhe shërbime sociale për banorët e vendbanimeve dhe për zonat e mbulimit apo të shërbimit rreth tyre.

Zgjerimi i shërbimeve ose zonës së mbulimit varet nga veçoria dhe kualiteti i hapësirave për vendosjen e shërbimeve të cilat duhet të arrihen në kohë të pranueshme të udhëtimit arritjes. E dimë se është më e pranueshme të udhëtohet më gjatë deri të një spital (zonë më e gjerë e shërbimit) se sa të arrihet shkurt deri te një institucion shëndetësor.

Kjo rezulton me një hierarki të qendrave me shkallë më të lartë apo më të ulët të përmbajtjeve dhe rrjedhimisht zonave më të vogla apo më të mëdha të shërbimit. Mirëpo çdo qendër me numër më të madh të shërbimeve përfshinë edhe shërbimet e qendrave të shkallës më të ulët dhe me një zanë më të vogël shërbimi apo mbulimi.

Qëllimi i vendosjes së një strukture të tillë qendrore të shërbimeve është sigurimi i shpërndarjes përmbajtjeve shërbyese në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në një distancë të pranueshme të udhëtimit për të gjithë banorët e komunës së Suharekës.

Për më tepër, përqendrimi i përmbajtjeve shërbyese në qendrat e caktuara (në vend se të shpërndahet pa ndonjë strukturë në vende të ndryshme), qon në efektin e sinergjisë për zhvillimin ekonomik të qendrave dhe rrethinës së tyre.

Bazuar në bilancin e numrit të banorëve gjatë 20 viteve të fundit, prognozën demografike për 8 vitet e ardhme, lidhjet me rrugë dhe pozitës së tyre qendrore, koncepti i zhvillimit hapësinor ka përcaktuar nyjet vijuese, sipas kategorizimit të tyre:

Qendër e rendit të mesëm – Suhareka

Qendra e rendit të lartë plotëson kërkesat afat-mesme të popullatës mbi 50,000 banorë brenda hapësirës së ndërmjetme të gravitimit duke përfshirë infrastrukturë të institucioneve të arsimit para-universitar, infrastrukturë të institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor- qendra të mjekësisë familjare; dhe hapësira komerciale.

Tabela 169 Vendbanimet e ndërmjetme të gravitimit për qendrën e rendit të mesëm urban – Suhareka

Vendbanimet	Bilanci in numrit të banorëve 1991-2011	Nr. i parashikuar i banorëve 2019 - 2027	
Suharekë	-0.72%	12,609	14,769



Reqan	5.75%	1,297	1,457
Peqan	-8.51%	2,556	2,932
Semetisht	-0.90%	1,719	1,990
Sllapuzhan	-5.00%	1,133	1,235
Staravuinë	-32.35%	275	307
Gjinoc	6.08%	2,269	2,309
Sopijë	18.00%	3,531	4,015
Dubravë	-7.04%	860	954
Gjithsejtë		26,249	29,968

Qendra e rendit të ulët – Duhël, Mushtisht dhe Studençan

Qendrat e rendit të ulët, plotësimin e nevojave bazike ditore të popullatës mbi 10,000 banorë dhe ofrojnë infrastrukture minimale (përfshijnë infrastrukture të institucioneve të arsimit para-universitar- shkolla fillore dhe të mesme të ulëta; dhe infrastrukture të institucioneve shëndetësore të nivelit parësor- punkte të mjekësisë familjare).

Tabela 170 Vendbanimet ndërmjetme të gravitimit për qendrën e rendit të ulët në veri – Duhël

Vendbanimet	Bilanci i numrit të banorëve 1991 - 2011	Nr. i parashikuar i banorëve 2019 - 2027	
Bllacë	2.59%	3629	3887
Javor	15.32%	532	601
Luzhnicë	-32.56%	172	172
Nishor	-15.13%	1629	1391
Kastërc	12.22%	469	487
Duhël	17.12%	1875	2047
Çadrak	-161.11%	181	197
Vërshec	9.43%	189	213
Greigec	-6.50%	624	685
Gjithsejtë		9300	9680

Tabela 171 Vendbanimet ndërmjetme të gravitimit për qendrën e rendit të ulët në lindje – Mushtisht

Vendbanimet	Bilanci in numrit të banorëve 1991 - 2011	Nr. i parashikuar i banorëve 2019 - 2027	
Vraniq	-2.73%	2,163	2269
Mushtisht	-47.79%	3,400	3400
Delloç	-269.38%	176	184
Maçitevë	-29.72%	457	488
Dvoran	-264.29%	154	162
Popolan	41.24%	274	274
Savrovë	-3.52%	1,136	1215
Bukosh	-11.30%	1,283	1,357
Budakovë	-6.60%	1,865	1,937
Krushicë e Poshtme	-11.65%	477	441
Mohlan	-11.70%	479	513
Papaz	3.22%	311	311
Krushicë e Epërme	-42.50%	191	183
Greikoc	-13.22%	2,671	2,803
Sallagrazhdë	-5.40%	1,409	1,417
Gjithsejtë		16,446	16,954



Tabela 172 Vendbanimet ndërmjetme të gravitimit për qendrën e rendit të ulët në perëndim – Studençan

Vendbanimet	Bilanci i numrit të banorëve 1991 - 2011	Nr. i parashikuar i banorëve 2019 - 2027	
Studençan	-4.92%	3653	3951
Samadrexhë	-3.35%	3516	3766
Neprebisht	-8.71%	823	847
Tërnjë	-4.94%	933	988
Reshtan	-5.72%	1223	1295
Dobërdelan	-14.52%	1219	1227
Gelancë	-27.24%	1238	1350
Leshan	-48.16%	1765	1906
Gjithsejtë		14370	15330

Duke e ditur se Nyjet janë zona me intensitet të lartë të ndërtimit dhe zhvillimit pos vendbanimeve të lartpërmendura edhe zona industriale e ekonomike hyn në këtë kategori por edhe disa zona tjera.

Korridoret

Korridoret i kemi trajtuar si korridore të infrastrukturës rrugore ku kemi tre korridore dhe korridore të zhvillimit ku kemi specifikuar korridorin Suharekë - Prizren

Korridoret paraqesin lidhjet ndërmjet njejeve, përgjatë të cilëve, natyrshëm mund të joshet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit. Në mënyrë që të mos krijohen koridore të reja të cilat krijojnë kosto më të lartë, bazë për përcaktimin e koridoreve janë trasetë ekzistuese për të cilat mund të lind nevoja e zgjerimit të tyre.

Në kontekstin e krijimit apo zgjerimit të korridoreve ekzistuese, ky plan përqendrohet në përshtatjen e tyre për ngarkesat dhe mundësitë e reja që mund të krijojnë zhvillimet e zonave të ndërtimit.

Në aspektin gjeografik, Komuna e Suharekës gjendet në mes të auto rrugëve të reja ndërkombëtare, Prishtinë – Morinë dhe Prishtinë – Shkup dhe mund të përfitojë shumë nga kjo pozitë për të nxitur vizitor në të ardhmen duke lidhur të dy autoudhët përmes Jezercit. Gjithashtu, Suhareka ka pozitë strategjike pasi gjendet rreth 50km larg Aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, rreth 180 km larg Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe rreth 120km larg Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit. Afërsia me aeroportët ndërkombëtare të tri kryeqyteteve, që mundësohet përmes koridoreve kryesore rrugore ndikon në zhvillim të përgjithshëm të Komunës.

Këto zhvillime të reja kërkojnë ri-planifikim të korridoreve sepse ndërtimi i auto udhës së re do krijojë ngarkesa të mëdha në rrugët që lidhin vendbanimet jugore dhe lindore me rrugën kyçe e re në pjesën perëndimore të zonës urbane të Suharekës.

4.3.6.1. Korridori 1 – Rruga që lidhë dy autoudhët e reja

Korridori që lidhë fshatrat Reqan, Bukosh, Budakovë dhe vazhdon në drejtim të Jezercit dhe Komunës fqinje të Ferizajt duhet të ruhet për mundësi zgjerimi dhe të përkrahet zhvillimi i aktiviteteve ekonomike në to.

Përpos shkurtimit të largësisë për udhëtarët Maqedoni – Shqipëri dhe anasjelltas, kjo rrugë do të ndihmonte në zhvillimin e turizmit malor dhe si dhe shitjen e rrushit, pijeve alkoolike, mjaltit dhe prodhimeve tjera bujqësore, të cilën auto udha Prishtinë – Morinë e ka kërcënuar në masë të konsiderueshme.

Bazuar në analizat demografike, vendbanimet në pjesën lindore kanë shënuar një rënie në numër të banorëve dhe kjo rrugë do të ndikonte në krijimin e kushteve të përshtatshme për ekonomitë familjare që të plasojnë dhe shesin produktet e tyre kalimtarëve të rinjë që do të përdornin këtë rrugë në të ardhmen edhe për shkak të peizazhit natyror rrethues.



4.3.6.2. Korridori 2 – Rruga transit Zonë Industriale – kyçja në autoudhë

Ky korridor transit fillon nga pjesa lindore e Zonës Industriale dhe përfundon në kyçje të autoudhës Prishtinë – Morinë.

Qëllimi i ndërtimit të kësaj rruge është që të zbus ngarkesën e madhe të trafikut që do të gjenerohet nga udhëtarët nga pjesa lindore në të ardhmen, për të u kyçur në autoudhën e re Prishtinë – Morinë.

4.3.6.3. Korridori 3 – Rruga transit Shirokë–Reqan-Biraq

Qëllimi i zgjerimit të kësaj rruge është që të zbus ngarkesën e madhe të trafikut që do të gjenerohet nga udhëtarët nga pjesa jugore në të ardhmen, për tu kyçur në autoudhën e re Prishtinë – Morinë.

4.3.6.4. Korridori Zhvillimor, Suharekë - Prizren

Ky korridor është zhvilluar gjatë viteve të fundit dhe me anën e këtij dokumenti do trajtohet dhe plotësohet me përmbajtje, ashtu që të sigurojmë funksionalitet dhe qëndrueshmëri.

4.3.7. Plotësimi dhe dendësimi

Plotësimi dhe dendësimi janë hapësira në të cilat planifikohet mbushja dhe dendësimi me zhvillime të caktuara, mënyrë kjo për të arritur integrimin hapësinor për të plotësuar nevojat e rritjes së popullsisë, në vendbanime. Plotësimi dhe dendësimi planifikohet në:

Suharekë; Studenqan; Duhël; Mushtisht; Samadraxhë.

4.3.8. Mbajtja nën kontrollë

Ky koncept i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ultë, në mënyrë tipike përmes përdorimit të një skaji urban i cili tregon kufirin për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore. Në këtë dokument janë caktuar zonat e ndërtimit dhe mundësitë e zgjerimit të tyre në 8 vitet e ardhshme. Përmes këtij koncepti krijohen zona kompakte ndërtuese, shpenzime më të arsyeshme në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, mirëmbajtje më e lehtë e infrastrukturës dhe hapësirave publike, si dhe ruajtje e tokave bujqësore.

4.3.9. Mbrojtja

Ky koncept shprehimisht ka për qëllim mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë. Përmes këtij koncepti synohet të bëhet ruajtja e zonave të mbrojtura në koordinim me nivelin qendror. Gjithashtu, synohet të bëhet regjistrimi dhe konservimi i trashëgimisë kulturore.

4.3.10. Zonat e rritjes

Ky koncept i referohet rihvillimit të zonave të zhvilluara ekzistuese në intensitetet më të larta dhe zhvillimit të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës. Zona Qendër e definuar sipas PZHU 2008-2018 synohet të zgjerohet si zonë kryesore e qytetit, duke krijuar mëtej nenzonat tjera banimore. Shfrytëzimi efektiv i tokës synohet të arrihet konform UA të MMPH 08/2017. Kufiri ndërmjet zonës së banimit dhe tokave bujqësore synon ofrimin e kushteve të përshtatshme për banim, duke u krijuar zona të reja ndërtimore dhe afërsi për punim të tokave bujqësore dhe zhvillim të bujqësisë në përgjithësi.

Analiza dhe shifrat për zgjerim

- *Siperfaqet gjelbruese dhe hapësirat publike për koke banori*



4.3.11. Koncepti i Zhvillimit Hapësinor - Skenarët e propozuar hapësinor

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor konceptin e zhvillimit Hapësinor përmes disa skenarëve të mundshëm të zhvillimit hapësinorë të komunës. Këta skenarë janë trajtuar duke u bazuar në analizat sipas fushave tematike të vizionit, qëllimeve, objektivave dhe përmbajtjeve tjera të lartpërmendura, dhe është tentuar të trajtohen me bazën sa ma reale të mundshme. Mundësitë reale, kërkesat dhe vlerësimet e lartpërmendura, dhe të me shtrirje dhe dimension të propozuar hapësinor, të tre skenarët e trajtuar do ti paraqesim me përshkrim të përmbledhur tekstual dhe harta kryesisht konceptuale, të cilët i kanë analizuar dhe i përmbajnë komponentët e kërkuara me udhëzim administrativ për përmbajtjet kryesore të skenarit siç janë: nyjet, korridoret, zgjerimet, kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen, masat mbrojtëse dhe zonat që do të mbrohen, infrastrukturën si dhe ndryshimet e propozuara dhe zhvillimet e reja.

Të tre skenarët në nivelin komunal përbëhen edhe nga "ZONA MALORE NË LINDJE" që është zonë kryesisht e mbrojtur dhe përdoret për rekreacion, "ZONA JUG-LINDORE"—zonë që përbëhet nga Malet dhe Natyra, ZONA VERI— "Kodrinat dhe Llojlojshmëria e Natyrës" dhe ZONA QENDRORE — "Korridori rekreativ-ekologjik i Toplluhës"

Dy skenarët në nivelin komunal, skenari 1 dhe skenari 3 përbëhen edhe nga Autoudha "Ibrahim Rugova", Rruga regjionale që kalon nëpër qytet, si dhe Rruga turistike që kalon përgjatë zonës malore në pjesën perëndimore;

Skenari i dytë përbëhen nga Autoudha "Ibrahim Rugova", Rruga regjionale që kalon nëpër qytet, dhe i mungon vetëm Rruga turistike që kalon përgjatë zonës malore në pjesën perëndimore;

Duhet theksuar sa është bërë një analizë komplekse, serioze e përgjithshme dhe ekipet punuese u dakorduan që elementet e përbashkëta të tre skenarëve mos të trajtohen nëpër skenar, pasi konsiderohen se ka pajtueshmëri që ato të janë pjesë e konceptit kryesorë, prezantojnë gjendjen ekzistuese, ose edhe ka edhe arsytet tjera, dhe pas analizës serioze vetëm të përmbajtjeve që dallojnë në skenar, dhe këto analiza ishin mjaft serioze në rrafshin profesional, politike por edhe nivelin e shoqërisë civile, duke marrë parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në hapësirën e komunës së Suharekës por edhe të gjitha implikimet që reflekton kjo gjendje në aspektin ekonomik, social dhe mjedisorë, duke u bazuar në konstatimet dhe ndërveprimet e përmbajtjeve janë dhanë disa konstatime të përmbledhura për tre skenarët.

Duhet theksuar edhe se skenarët e propozuar hapësinor kanë kaluar proceset e kërkuara publike dhe skenari i propozuar hapësinor, i cili zhvillohet tutje ka plotësuar të gjitha kërkesat e qytetarëve, institucioneve, OJQ-ve dhe akterëve të tjerë, por edhe kërkesat e Udhëzimit Administrativ, dhe është zgjedhur në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit. Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor përmes hartës për shfrytëzimin e planifikuar të tokës dhe hartave për planet zhvillimore sektoriale është baza kryesore për zhvillim të mëtejshëm të dokumentit por edhe do jetë bazë për Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planet e Veprimit.

**4.3.12. Skenari 1****SKENARI 1 - SUHAREKA ME ZHVILLIM TË FUQISHËM, VETËM TË ZONËS URBANE (MONOCENTRIK)**

Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Suharekës si zhvillim monocentrik, d.m.th qendra komunale (Suhareka) duhet të orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane complete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm, dhe kur në nivel global më shumë se gjysma e botës jeton në zonën urbane, është shumë normale zhvillimi i një skenari të tillë edhe për komunën e Suharekës.

Për **NYJET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky **skenar** bazohet në zhvillimin monocentrik me vetëm një kryesore e konsideron të rëndësishme, qytetin e Suharekës.

Për **KORRIDORET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky **skenar** bazohet në tre korridore kryesore të infrastrukturës rrugore vijuese: korridori që sigurohet përmes Autoudhës "Ibrahim Rugova", përmes Rrugës regjionale që kalon nëpër qytet, si dhe Rrugës së planifikuar turistike që kalon përgjatë zonës malore në pjesën perëndimore;

Në lidhje me **LOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN**, Skenari 1 ofron vetëm plotësimin dhe dendësimin vetëm në zonën urbane.

Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, Skenari 1 synon mbajtjen në kontroll të vendbanimeve rurale, ku jetojnë 75% e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, rritje të intensitetit të ndërtimeve.

Në lidhje me **MBROJTJEN**, Skenari 1 mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër, për shkak të kufizimeve të ndërtimeve nuk ofron mundësi të rritjes së rezidentëve që synojnë zhvillojnë bujqësinë dhe shërbimeve komunale në vendbanime rurale dhe pengon zhvillimin e bujqësisë.

Në lidhje me **ZONAT E RRRITJES**, Skenari 1 ofron vetëm një zonë të rritjes në qytetin e Suharekës, i cili do të ngarkonte shumë qytetin, gjersa do të anashkalonte shtimin natyror të popullsisë në vendbanime rurale, ku jetojnë 75% e banorëve.

Përparësitë e skenarit 1

Si përparësi kryesore e këtij skenari është se qendra komunale (Suhareka), orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane complete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm:

- Mundëson urbanizimin e komunës me vendosjen e shumicës së qytetareve në zonën urbane;
- Mundëson që shërbimet ndaj qytetarëve të ofrohen më lehtë;
- Përqendrimi i zhvillimeve e bën të mundshme mbrojtjen e natyrës dhe tokës bujqësore;
- Kostot e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Suharekës janë më të lira;
- Zhvillim dhe mbrojtje të tokës bujqësore.
- Ky skenar ka edhe përparësi tjera.

Mangësitë e skenarit 1


Ndër mangësitë kryesore të këtij skenari janë se nuk mundëson plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Suharekës, vlerësohet se ky skenar është kufizues për 75% të popullsisë që jetojnë në zonat rurale, duke ju kufizuar funksionimin e lidhjeve, shërbimeve, dendësimit si dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomik e mjedisore:



- Skenari 1 nuk ofron dhe përkrah as një alternative për qytetin e Suharekës, i cili pas koncentrimit të madh të popullsisë mund të shkaktoj ngarkesa dhe pritje të mëdha në pjesën qendrore të qytetit.
- Nuk mundëson zhvillimin të vendbanimeve tjera të mëdha të komunës .
- Ky skenar mund të pengojë edhe aspirata e Komunës për zhvillimin e bujqësisë, me koncentrimin e tyre në zonën urbane.
- Nuk vlerësohet të trajtohet më tutje edhe se vlerësohet që shkakton ndikime negative sociale por edhe kostot e skenarit janë më të mëdha.

Konstatim për Skenarin 1

Skenari 1 nuk do të zhvillohet më tutje pasi nga ajo që kemi prezantuar më lart për Suharekën është skenar i vështirë i cili do shkaktonte çrregullime të mëdha njerëzore dhe do kishte implikime të mëdha financiare.



Harta 31 Zhvillimi hapësinor sipas skenarit 1

**4.3.13. Skenari 2****SKENARI 2 - ËSHTË SKENARI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL I CILI NË DOKUMENTIN E KALUAR 2008-2018, ISHTE I TRAJTUAR SI KONCEPT KRYESOR I ZHVILLIMIT HAPËSINORË.**

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës e kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor konceptin e PZHK-së 2008-2018, përmes Skenarit 2. Ky skenar do të ishte si bazë e mundshme të zhvillimit hapësinorë të vendbanimeve dhe pas analizës serioze në rrafshin profesional, politik por edhe të shoqërisë civile, duke marrë parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në hapësirën e komunës së Suharekës por edhe të gjitha implikimet që reflekton kjo gjendje në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor është konstatuar se ky skenar vazhdon të siguroj:

1. Zhvillim dhe mbrojtje e tokës bujqësore;
2. Rritje e komunës në mënyrë të qëndrueshme;
3. Zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar;
4. Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër, shpejtë dhe lirë për qytetarët.

Skenari 2 do të ofronte zhvillimin e komunës me një koncept policentrik, ku pos zonës urbane - Suharekës, ofron edhe zhvillimin funksional por edhe me përmbajtje të nën-qendrës Mushtisht dhe nën-qendrave Samadrexhë-Studenqan si dhe Bllacë-Duhël, dhe kjo prezanton përmbajtjen kryesore për plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Suharekës. Vlerësohet si prioritet zhvillimi i shpejtë i qytetit të Suharekës, Mushtishtit, Samadrexhës, Studenqanit, Bllacës, Duhlës dhe disa vendbanimeve si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit si dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomike e mjedisore.

Koncepti i Skenarit 2 është konsideruar nga grupet punuese si koncept racional dhe efikas, për zhvillim të planifikuar Komunal. Si bosht orientues për arritjen e vizionit të Komunës së Suharekës, ky skenar mundëson zhvillimin ekonomik, social (demografik) e mjedisor të sinkronizuar, në kohë e hapësirë, të qendrës komunale edhe të nën-qendrave, të cilat do të jenë në pozitën e vendbanimit komplementar, në kuptimin se funksionet themelore të këtyre vendbanimeve i plotësojnë funksionet e vendbanimeve tjera, brenda ndarjes hapësinore policentrike, ashtu që këto të sigurojnë edhe lidhjen funksionale të rregullt dhe të mirë të mbarë hapësirës brenda kësaj komune dhe rajonit.

Specifikat e zhvillimit të vendbanimeve në komunën e Suharekës, kërkojnë që në të ardhmen konceptit të urbanizimit ti hyhet në mënyrë tepër elastike. Përveç urbanizimit për qendrat kryesore dhe nën-qendrat, lansohet koncepti edhe për urbanizimin kompakt të zonave rurale (fshatrave) tjera.

Edhe me këtë koncept qendra komunale (Suhareka) duhet të orientohet e ndërtohet me të gjitha elementet e strukturës urbane complete. Duhet të sigurojë mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm. Zhvillime të rëndësishme në trajtim urban duhet pritur edhe në Mushtisht, Samadrexhë, Studenqan, Bllacë e Duhël, të cilat do ti përgjigjen funksionit të Suharekës në aspektin hapësinor, komunal, regjional dhe nivel të Kosovës.

Për NYJET si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në zhvillimin i cili si nje kryesore e konsideron si të rëndësishme, qytetin e Suharekës por edhe Mushtishtin, Samadrexhën, Studenqanin, Bllacën, Duhlën dhe disa vendbanime tjera.



Për KORRIDORET si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në tre korridore kryesore të infrastrukturës rrugore vijuese: korridori që sigurohet përmes Autoudhës "Ibrahim Rugova" si dhe përmes Rrugës regjionale që kalon nëpër qytet.

Në lidhje me PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN, Skenari 2 ofron plotësimin dhe dendësimin në përputhje me UA 08/2017, jo vetëm në zonën urbane qytetin e Suharekës por edhe për Mushtishtin, Samadrexhën, Studenqanin, Bllacën, Duhlën dhe disa vendbanime tjera.

Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, Skenari 2 synon mbajtjen në kontroll të të gjitha vendbanimeve rurale, duke mos lejuar shtrirje të reja në funksion të mbrojtjes së tokës bujqësore.

Në lidhje me **MBROJTJEN**, Skenari 2 mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër ofron edhe mundësi të rritjes së rezidentëve që synojnë zhvillojnë bujqësinë dhe shërbimeve komunale në vendbanime rurale dhe kontribuon në zhvillimin e bujqësisë.

Në lidhje me **ZONAT E RRRITJES**, Skenari 2 ofron disa zona të rritjes në komunën e Suharekës, mirëpo rritja bëhet në drejtim të tokave me kualitet më të dobët, ky skenar do ndihmon edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, ndërsa përkrah edhe shtimin natyror të popullsisë në vendbanime rurale, ku jetojnë 75% e banorëve.

Përparësitë e skenarit 2

Si përparësi kryesore e këtij skenari është se komuna e Suharekës është se ofron:

- Shumicën e përmbajtjet dhe aktivitetet të kërkuara nga vlerësimi i gjendjes, vizioni, qëllimet, objektivat.
- Zhvillim dhe mbrojtje e tokës bujqësore
- Rritje të komunës në mënyrë të qëndrueshme
- Zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar
- Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër, shpejtë dhe lirë për qytetarët
- Komuna e Suharekës për 10 vite u zhvillua kryesisht me këtë koncept

Mangësitë e skenarit 2

Ndër mangësitë kryesore të këtij skenari janë se nuk ka përfshirë rrugën e planifikuar turistike që kalon përgjatë zonës malore në pjesën perëndimore;


Mangësi tjetër e këtij skenari është mos përfshirja e korridorit të zhvillimit, korridor që është krijuar nga zhvillimet e pa kontrolluara, por që paraqet një potencial për zhvillim, bëhet fjalë për korridorin që lidh Suharekën me Prizrenin.

Ky koncept nuk përmban edhe zonat e zhvilluara si industriale dhe ekonomike.

Ky koncept si nën-qendra ka paraparë për zhvillimin funksional por edhe me përmbajtje të nën-qendrës Mushtisht dhe nën-qendrave (Samadrexhë-Studenqan si dhe Bllacë-Duhël), dhe gjatë analizës së grupeve punuese dhe në punëtorive të mbajtura, është konstatuar për arsye praktike dhe funksionale ishte një mangësi trajtimi i nga dy vendbanimeve në kuadër të një nën qendre dhe duke u bazuar në zhvillimin e 10 viteve të fundit duhet të përkufizohen si nën-qendra: Mushtishti, Duhël dhe Studenqan.

Konstatim për Skenarin 2

Skenari 2 si i tillë nuk do të zhvillohet më tutje, edhe se nga ajo që kemi prezantuar më lart për Suharekën është skenar bazik, dhe i cili duhet plotësohet edhe me zhvillimet të cilat janë zhvilluar në 10 vitet e fundit dhe krijohen bazat e skenarit të ri, i cili do prezantonte bazën e zhvillimit të ardhshëm të komunës.



LEGJENDA / LEGEND

Qendrat / Centres

- Qendër kryesore / Main centre
- Sub-qendër / Sub-centre
- Potencial për Sub-qendër / Potential for Sub-centre
- Qendër lokale / Local centre

Rrugët e propozuara / Proposed roads

- Autostradë / Highway
- Rrugë regionale / Regional road
- Lidhja përmes rrugës regionale / Connection through regional road
- Rrugë kryesore lokale / Main local road
- Rrugë lokale / Local road
- Rrugë turistike / Touristic road
- Kyqja në autostradë / Highway junction

Rrugët ekzistuese / Existing roads

- Rrugë magjistrale / Main road
- Rrugë regionale / Regional road

Zonimi sipas topografisë / Topographic zoning

- Zonë malore / Highland area
- Zonë rrafshinore / Lowland area

Vendbanimet / Settlements

- Kufiri Komunal / Municipal Boundary

Financuar nga / Financed by		Austrian Development Cooperation	
Autore / Author		   	
PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL - SUHAREKË MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN - SUHAREKA			
KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR SPATIAL DEVELOPMENT CONCEPT			
1:100,000		01	
Janar / January 2008			

Harta 32 Zhvillimi hapësinor sipas skenarit 2

**4.3.14. Skenari 3****SKENARI 3 - ËSHTË SKENARI I ZHVILLIMIT POLICENTRIK HAPËSINORË, ME TRE KORIDORE INFRASTRUKTURE, NJË KORRIDOR ZHVILLIMOR DHE ZONAT E ZHVILLIMIT**

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor të Suharekës kanë analizuar konceptin e zhvillimit hapësinorë nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor, të parashtruar në Skenarin 3. Ky skenar do të ishte si bazë e mundshme të zhvillimit hapësinorë të vendbanimeve, dhe pas analizës serioze në rrafshin profesional, politik por edhe me shoqërinë civile, duke marrë parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në hapësirën e komunës së Suharekës por edhe të gjitha implikimet që reflekton kjo gjendje në aspektin ekonomik, social dhe mjedisorë është konstatuar se ky skenar siguron:

- Zhvillim dhe mbrojtje e tokës bujqësore;
- Rritje e komunës në mënyrë të qëndrueshme;
- Zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar;
- Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër, shpejtë dhe lirë për qytetarët.

Skenari 3 do të ofronte zhvillimin e komunës me një koncept policentrik, ku pos zonës urbane -qendrës Suharekë, ofron edhe zhvillimin funksional por edhe me përmbajtje të nën-qendrës së Mushtishtit dhe nën-qendrave Studenqan dhe Duhël. Zgjidhja e Skenarit 3, prezanton përmbajtjen kryesore për trajtim funksional të komunës, ndërsa sa i përket plotësimit dhe rrjetës urbane të vendbanimeve ofron funksione dhe përmbajtje, duke siguruar një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Suharekës. Vlerësohet si prioritet zhvillimi i shpejtë i qytetit të Suharekës por edhe Mushtishtit, Samadrexhës, Studenqanit dhe Duhlës si nënqendra dhe disa vendbanimeve tjera si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit si dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomik e mjedisore.

Informojë, nëpërmjet Zyrës për Informim, edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e zbatimit të planit, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes: Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, Mediave lokale, Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Koordinatori i Ekipit, bashkë me Ekipin ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktiviteteve që i kontribuojnë zbatimit të planeve.

Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të Fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që të:

1. Kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat;
2. Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet;
3. Definojnë masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet;
4. Zhvillojnë tubimet e rregullta publike;
5. Zhvillojnë takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Zbatimin të Planit në fshat, vendbanim apo lagje urbane.

Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të Planit Zhvillimor Komunal.

Kryetari i Komunës, duhet që (së paku) të organizojë dy takime në vit me Ekipin Punues. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse preferohet çdo tre muaj të ketë takime. Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore.

Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët, dhe institucionet.

Procesi i zbatimit mbështet në parimin e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunitat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të Transparencës, dhe në këtë mënyrë komunitat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal, dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

6.1.1.2. Informimi dhe komunikimi në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Suharekës

Informimi dhe Komunikimi në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Suharekës luan rol të jashtë zakonshëm, andaj Komuna e Suharekës dhe akterët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për zbatimin e Planit Zhvillimor.



Fusha e informimit dhe e komunikimit, në funksion të zbatimit të këtij dokumenti, do jetë një mbështetje e madhe e drejtuesve të institucioneve, dhe të vet institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbytjeve tjera të PZHK-së, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatoj kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushë edhe këtë kërkesë, nga kuadrin ligjor.

Në vijim, Komuna e Suharekës do të respektojë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës gjatë zbatimit të Planit Zhvillimor. Planin i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të zhvillohet procesi i zbatimit transparent të PZHK-së, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë aktet në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna do t'i shfrytëzojë të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshme në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe aktet e tjerë relevant.

Në këtë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të ketë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të gjithë aktet, duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve, botojeni atë dhe bëjeni le të shihet në gazeta. Postoni atë në Ueb faqen tuaj të Internetit dhe referojuni sa më shpesh që të jetë e mundur në mënyra të ndryshme dokumenteve të planifikimit. Këto udhëzime, do të ndihmojnë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të planit.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një "Memo vjetore", dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Kjo memo, i përkujton ata në lidhje me Planin Zhvillimor Komunal aktual dhe me këtë rast nga dhe anëtarët e grupeve të tjera të interes, mund të kërkojnë komente dhe sugjerime lidhur me informimin, komunikimin, zbatimin e dokumentit si dhe për çështjet tjera me interes.

Si shumë me interes për zbatim të Planit konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë aktet dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e planit. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

6.1.1.3. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve

Përkundër që në Komuna e Suharekës mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësorë gjatë përgatitjes së PZHK-së në kuptimin e gjithëpërfshirës edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, për kundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë por, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Në këtë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumentit, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur dhe digjitale të Planit, stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbytjen, detyrat si dhe me obligimet që dalin nga PZHK-ja.

Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për projektet, objektivat qëllimet dhe përmbytjet tjera të PZHK-së por edhe aktivitetet tjera që janë rezultat i Planit, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për



kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe projektet, objektivat, qëllimet dhe dimensionin hapësinor të dokumentit.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësoj komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj akterve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Planit, dhe mundëson informim dhe koordinimin efikas, cilësorë, dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë akterëve relevant. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Planit, i projekteve, objektiveve, qëllimeve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës, bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Punues për Zbatim për tu analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspektoratit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal. Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaftë i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimor në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera.

Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të planit.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria e Urbanizmit por, në funksion të zbatimit të planit një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Punues për Zbatim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror. Edhe Drejtoritë tjera komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë, pasi që shumë projekte, zhvillime të parapara me PZHK duhet të jenë pjesë e parashikimet buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre projekteve, objektiveve qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hapë më përpara në zbatimin e tyre.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal në këtë rast, por edhe çfarëdo dokumenti tjetër, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet fuqizohet dhe avancohet.

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planit duhet zgjeruar edhe me gjykatat për disa lëndë potenciale, edhe me zyret projektuese për tu sqaruar për zonat dhe kufijtë ku lejohen ndërtimet, e në këtë vij edhe projektimet edhe shoqëria civile për rolin, rëndësinë por edhe interesat që mbrojnë.

6.1.1.4. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror

Pasi që PZHK-ja është dokument multisektoral, lirisht mund të themi se edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushë veprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të PZHK-së.



Në këtë drejtim, aktivitetet dhe masat për zbatim, do jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të PZHK-së. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MIA-ja, MBPZHR-ja Ministria e infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministrinë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të PZHK-së.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të PZHK-së. Dihet se ministrinë e ndryshme si për shembull MIA-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit, duke i ditur edhe kompetencat për ujë, për Tokën dhe për ajër që i ka (në këtë rast) MIA-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MIA-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndëshkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj të planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve. Në këtë drejtim, për pos procesit të nxjerrjes së dokumenteve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspekton MIA.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të PZHK-së. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendrorë. Në këtë drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspeksioni i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjuetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të PZHK-së.

Pasi që planifikimi është multisektoral, gati të gjitha ministrinë dhe të gjitha agjensionet e tjera publike, kanë një fushë-veprimtari, kompetencë dhe ndikim që prekë edhe zbatimin e PZHK-së. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të PZHK-së edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e granteve që vijnë nga niveli qendror. Lirishtë, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtësore për zbatim të PZHK-së.

6.1.1.5. Mbështetja administrative

Komuna e Suharekës, duhet të ofrojë një mbështetje cilësore administrative për zbatim të PZHK-së, duke e synuar lirimin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj.

Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikimeve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për zbatimin e projekteve, objektivave dhe qëllimeve janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim por, edhe për transparencë në zbatim.

Për tu mundur zbatimi i PZHK-së, si mbështetje administrative duhet ofrohet mundësia e hartimit të Hartës Zonale të Komunës, më të cilën mund të epen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore, por për shkak mos trajtimit në nivel parcele, dhe mundësisë për trajtim jo të barabartë të parcelave dhe pronarëve të ndryshëm, në funksion të sigurimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe përmbajtjeve tjera urbane, duhet trajtuar edhe me PRRH.



Kështu mbështetja administrative përpos transparencës, përgjegjësisë shkon edhe në kompletimin me dokumentet tjerë të nevojshëm për zbatim të plotë të PZHK-së

6.1.2. Monitorimi i zbatimit

Brenda kapitullit **Dispozitat për Zbatim**, ekipet hartuese të Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës kanë sqaruar edhe përgjegjësit dhe kompetencat lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal në Kuvend Komunal, dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësit ligjore që ka lidhur me monitorimin e zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës, në këtë drejtim Drejtoria e Urbanizmit do filloj me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se monitorimi i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal është një aktivitet i vazhdueshëm me qëllim të sigurimit të informatave në mënyrë të rregullt dhe sistematike, në për mes treguesve sasior dhe cilësor të cilët do matin progresin e arritur në zbatimin e PZHK-së së Suharekës, me qëllim të vlerësimit se a janë arritur rezultatet e planifikuara por edhe identifikuar vështirësitë, sfidat dhe problemet.

Monitorimi trajton në mënyrë sistematike raportin ndërmjet gjendjes së zbatuar dhe asaj që është planifikuar me PZHK por edhe pritjeve bazuar në treguesit e paracaktuar.

Është mënyra sistematike e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale dhe burimet tjera/informacionit, në lidhje me zbatimin e planeve sektoriale për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të zbatimit.

Monitorimi, është procesi përmes së cilit, zbatuesit e Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës do të sigurohen që projektet, objektivat, qëllimet janë duke u zbatuar, janë në përputhje me ato të planifikuara në PZHK dhe brenda afateve të caktuara. Është një përpjekje sistematike për të krahasuar punën në zbatim por edhe performancën e PZHK-së me dhe standardet e caktuara për të vlerësuar nëse është bërë apo nuk është bërë progres. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen, dhe kryerjen e korrigjimeve të nevojshme për ta mbajtur Hartën brenda detyrimeve të tyre.

Në këtë drejtim mundemi të konstatojmë se mundet të bëhet edhe Anulimi apo shtyrja e zbatimi të ndonjë aktiviteti të Planit të Veprimit të PZHK-së për arsyet e caktuara objektive por edhe subjektive që janë rezultat i procesit të monitorimit të zbatimit, shtyrja ose anulimi bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Kuvendit të Komunës, dhe nëse bëhet një vendim për shtyrjen apo anulimin e një aktiviteti. Plani i Veprimit do të përditësohet me vendimin e ri dhe pas përditësimit drejtoritë komunale përgatisin Planin Sektorial Vjetor për zbatim të vitit vijues bazuar në Planin e Veprimit të përditësuar për Zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit është proces sistematik dhe i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizës së të dhënave, për një ndërhyrje të caktuar.

Monitorimi, vlerëson shkallën sipas të cilës plani: po zbatohet, në përputhje me planin e Veprimit për zbatim të PZHK-së ose edhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së.

Bazuar në përvojat e kaluara ekziston nevoja për zhvillimin të një sistemi qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit e sidomos PZHK-së në këtë rast, Komuna e Suharekës është e bindur se përpos një planifikim të qëndrueshëm dhe hartimit të dokumenteve cilësore, po aq është i rëndësishëm edhe aplikimi i tij në praktike dhe përkrahja më të madhe që komuna, institucionet dhe sektorët e tjerë kompetentë duhet bëjnë është për gjetjen e rrugëve adekuate për zbatim.

Komuna e Suharekës e konsideron këtë kapitull si një përpjekje për të ndërtuar një sistem dhe koncept të monitorimit dhe vlerësimit të planit në praktikën e përditshme dhe në procesin e planifikimit hapësinor.



Komuna e Suharekës ka edhe për qëllim që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por dhe të akterëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Do të përshkruhen në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të gjithë hapat që duhen ndjekur për të monitoruar zbatimin e PZHK-së, dhe njëkohësisht të përgatiten raportet e nevojshëm për Kuvendin Komunal, MIA-në dhe që i duhen çdo pale të interesuar për zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit të PZHK-së së Suharekës bëhet në baza ditore, ndërsa Raportimi i monitorimit kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore, tre mujore por për qëllime praktike më i rëndësishmi është ai gjashtë mujore dhe vjetore, por edhe për çdo vit radhazi, pasi që PZHK-ja është dokument i cili planifikohet për së paku 8 vite, intervalet tjera kohore për raportin e monitorimit mund të caktohen varësisht edhe nga zhvillimet brenda drejtorive por edhe asaj që është paraparë me plan zbatimit, një raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të PZHK-së përgatitet nga Ekipi Punues i cili udhëhiqet nga koordinatori. Koordinatori raportin përfundimisht e trajton dhe përmbyll brenda Autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit), raport i cili prezanton Monitorim dhe Vlerësim e zbatimit të PZHK-së, edhe atë në intervale kohore të arsyeshme gjashtë mujore për nevoja të brendshme të komunës, dhe vjetore i cili është për nevoja të brendshme të komunës por edhe për raportim në MIA.

Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së bazohet në: Projektet, aktivitetet, masat dhe përmbajtjet tjera të parapara në Planin e Veprimit për Zbatimin e PZHK-së, plan i cili duhet jetë bazë për përgatitjen e planeve vjetore sektorial për secilën drejtori në lidhje me zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit trajton edhe projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të cilat nuk janë paraparë me Planin e Veprimit për Zbatimin e PZHK-së, rrjedhimisht as me plan vjetor sektorial të zbatimit të PZHK-së, dhe të cilat mund të konsiderohen si zhvillime të momentit, të pa planifikuara.

6.1.2.1. Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit

Caktimi i stafit nëpër drejtori dhe i mjeteve për mbledhjen e të dhënave, që mund të ndryshon nga drejtorja në drejtori, por edhe nga projektet, masat dhe aktivitetet që do monitorohen (fillimisht do preferohej që një staf i cili është trajnuar për matjen e performances së Komunës të jetë pjesë e procesit të monitorimit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Komunës në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse sektoriale të komunës.

Drejtoritë komunale sektoriale brenda komunës së Suharekës përgatisin raportin monitorues të zbatimit të planeve zhvillimore sektoriale në baza vjetore si obligim ligjor dhe sipas nevojës bazuar në intervalet e lartpërmendura. Raportet vjetore duhet përgatitur për të gjitha drejtoritë, nga të gjitha këto raporte përgatitet Raporti Monitorues i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës dhe e dorëzon në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim. Pas integritetit nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtorja për Urbanizmit) dhe pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit nga Kuvendi i Komunës, në baza vjetore dorëzon në Ministri raportin informues për gjendjen e zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Raportet vjetore të monitorimit të zbatimit përfshijnë rekomandime për veprim (anulim ose shtyrje të ndonjë aktiviteti) dhe prezantohen para Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë me statistika financiare, në baza vjetore, së paku për tetë (8) vite.

Raportet vjetore të monitorimit bazohen në analizat e Informatave bazë: gjatë gjithë procesit duhet sigurohen informata, informatat duhet siguruar në të gjitha drejtoritë dhe instancat tjera, këto informata sigurojnë bazë të mirë për analizën dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së së Suharekës.

Raporti vjetore i monitorimit dhe raportet sektoriale bazohen në analizat e këtyre informatave bazë.

**Cilët janë treguesit?**

Për të pasur një monitorim të zbatimit të PZHK-së së Suharekës duhet siguruar që informatat bazë të pasqyrojnë treguesit adekuat për zbatim, ata tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ.

Çdo drejtori bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së përgatit Planin vjetor sektorial për Zbatimin e PZHK-së, dhe brenda këtij plani duhet definuar edhe treguesit e qartë për monitorimin e zbatimit të kushteve, zhvillimeve, të masave ose të projekteve të parapara.

Si i përcaktojmë treguesit për zbatim?

Duhet të Sigurohemi që ka një pajtim mbi treguesit para aplikimit të tyre (gjatë përgatitjes së planit sektorial vjetor për zbatim nga të gjithë amtarët e ekipit).

1. Miratoni treguesit që janë të qartë dhe të kontrollueshëm;
2. Miratoni treguesit që janë të matshëm, të afërt dhe konsistentë;
3. Miratoni treguesit që janë të rëndësishëm për kontekstin komunal;
4. Miratoni treguesit që janë të ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme, dhe që mund të azhurnohen lehtë;
5. Miratoni tregues që janë të krahasueshëm me programet apo planet tjera;
6. Ndërlidheni monitorimin me ndikimin në mjedis dhe studimet e revidimit;
7. Ndërlidheni monitorimin me auditimet tjera të aktiviteteve të qytetit, zonave rurale, fondit të ndërtimeve, etj;
8. Ndërlidhni problemet e zhvillimeve aktuale me sistemin e monitorimit që, të mund të zgjerohet apo ndryshohet edhe përdorimi i treguesve.

Për ilustrim:

Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së së Suharekës kemi potencuar se për vitin 2019 synohet të ndërtohet rruga e caktuar, treguesi do jetë normal numër dhe në fund të vitit bazuar në informatat bazë mund të themi se kemi realizuar komplet rrugën prej 7km, ose 7000m tregues që paraqet të gjitha përmbajtjet e rrugës, të dakorduar kur e kemi krye planin sektorial të zbatimit .

Caktimi i standardeve të monitorimit

Standardet e monitorimit i përcaktojmë në fazën e planifikimit të monitorimit dhe bëhen me marrëveshje të Ekipit Zbatues.

Cila do jetë metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Suharekës?

Duke e trajtuar metodologjinë si tërësinë e metodave që përdoren në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Zbatimit të PZHK-së së Suharekës në përgjithësi për dokumentin por edhe në fusha të caktuara sektoriale.

Lirisht mundet të thuhet se këto metoda bazohen në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së si dhe në Planet Sektoriale për Zbatim ku janë paraparë: projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore, kostot financiare dhe pritjet nga zbatimi i tyre, thjesht duke krahasuar gjendjen e planifikuar dhe gjendjen e realizuar.

Metoda e cila preferohet të shfrytëzohet është metoda e orientuara në rezultate dhe në gjendjen faktike në teren. Ekipi punues duhet përdorë metodat statistikore dhe mundet të përdorë edhe metodat tjera sipas nevojës dhe përcaktimeve edhe në plan pune për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit.

Metodologjia e punës do të ndjek hapat e njëjtë të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së dhe planeve sektoriale, duke ndjekur këta hapa:

Hapi 1 Identifikimi



Identifikimi i Qëllimeve, Objektivave, projekteve, aktiviteteve, masave, afateve kohore, kostove financiare të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik.

Hapi 2 Definimi i treguesve

Në varësi të asaj se çka është pjesë e planit të veprimit për zbatim të PZHK-së, dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik duhet përcaktohen tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ për më shumë në materialin e lart përmendur: Cilët janë treguesit dhe materialet tjera?

Hapi 3 Përcakto metodat e grumbullimit të të dhënave dhe afatet kohore

Grumbullimi i të dhënave:

- Grumbullimi i të dhënave bëhet bazuar në formularët e përgatitur për monitorim sipas specifikave të zhvillimeve dhe drejtorive;
- Treguesit kuantitativ dhe kualitativ mblidhen në baza ditore, dhe hedhja e tyre në data bazë bëhet në baza javore;
- Në rast se mund të duket e nevojshme mundë organizohen intervista, pyetësorë dhe metoda tjera të grumbullimit të informatave;

Grumbullimi i informatave bëhet edhe nga burimet tjera pos burimeve zyrtare të komunës.

Hapi 4 Identifikoni Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit

Në kuadër të planit të monitorimit përcaktohen edhe Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit për përgjegjësit e drejtorive, stafit brenda secilës drejtori për më shumë shih materialin më lartë: Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe materialet tjera?

Hapi 5 Krijo një Plan Vlerësimi dhe Format të Raportimit

Duke konsideruar se të dhënat bazë (treguesit dhe të dhënat tjera) duhet vlerësuar për të konstatuar dhe raportuar progresin e zbatimit, duhet hartuar një Plan transparent dhe profesional Vlerësimi dhe Format të Raportimit.

Hapi 6 Kompletimi i Raportit dhe raportimi në Kuvend komunale të Suharekës dhe në MIA

Kompletimi i Raportit përfundimtar duhet bëhet nga autoriteti kompetent komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor duke e integruar dhe strukturuar vlerësimet nga raportet e secilës drejtori lidhur me vlerësimin e zbatimit, raport i cili duhet prezantohet në Kuvend komunale të Suharekës dhe në MIA.



6.2. Vlerësimi i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës

6.2.1. Kuptimi i vlerësimit

Vlerësimi, do të thotë gjetja e vlerës në përqindje (%) të realizimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe cilësisë së zbatimit. Vlerësimi, thjesht i referohet procedurave të faktit të gjetur, të cilët janë grumbulluar dhe sistemuar gjatë procesit të monitorimit.

Vlerësimi përbëhet nga vlerësimet nëse janë apo jo zhvillimet, masat, aktivitetet, projektet në përputhje me rezultatet e planifikuara në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së, Planet sektoriale të Zbatimit dhe me standardet e pranura përgjithësisht profesionale.

Komuna e Suharekës do orientohet kryesisht në Vlerësimin e brendshëm i cili është bërë në nga stafi komunal, vetë bordi i drejtorëve, kryetari i komunës dhe përfituesit.

Mirëpo Komuna e Suharekës mundë të angazhoj edhe vlerësim dhe monitorim të jashtëm, ky vlerësim mund të bëhet nga një trupi jashtë strukturave të komunës

6.2.2. Autoritetet kompetente për Zbatim dhe Monitorimin e zbatimit të PZHK-së së Suharekës

Fillimisht duhet sqaruar se Kuvendi i Komunës së Suharekës është përgjegjës për alokimin e fondeve për zbatimin e PZHK-së.

Ekipi punues mundë të angazhohet në përgatitje të Raportit të Monitorimit, ky ekip përbëhet nga koordinatori i cili vjen nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor si dhe nga përgjegjësit e drejtorive, më tutje do të sqarohen se kush do përgatit raportin e monitorimit nga organet e caktuara duke e kuptuar se ekipi punues është bartës i këtij procesi.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet për zbatimin e PZHK-së së Suharekës, Monitorimin e zbatimit të PZHK-së si dhe përgatitjen e Raportit të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas Procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit, Drejtoritë komunale sektoriale zhvillojnë edhe aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre lidhur me përgatitjen e Raportit sektorial të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë Raportet sektoriale vjetore të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së në Ministri.



Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna mund të angazhojë kompani konsulente për kapitullin e monitorimit, të zbatimit dhe vlerësimit e cila do të përkrahë Ekipin dhe Autoritetet në këtë proces.

Raportimi nga Ekipi Komunal për Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë i atillë që do t'i mbajë drejtuesit e komunës të informuar për atë që po ndodh, dhe të sigurojë raportet e progresit në zbatimin e PZHK-së, Ky raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit, dhe i bënë ata pjesë të procesit, dhe aty ku mund të hasen probleme. Ekipi, duhet të jetë në gjendje për t'i adresuar shqetësimet apo për të propozuar ndryshime të mundshme.

6.3. Dispozitat përfundimtare

6.3.1. Hyrja në fuqi

- Ky Plan do të hyn në fuqi 15 ditë pasi që të miratohet nga Kuvendi Komunal.

6.3.2. Validiteti/ vlefshmëria

- Ky Plan do të jetë i vlefshëm së paku për 8 vjet.

6.3.3. Vlerësimi


- PZHK do të vlerësohen rregullisht, p.sh. një herë në vit.
- Gjithashtu do të konsiderohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banime dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.

Procedura e rregullt e rishikimit është 4 vite pas ditës së miratimit të këtij dokumenti nga Kuvendi Komunal.



Shtojca 1. Informata për Vendime dhe Miratime në Lidhje me PZHK-në

Shtojca 1.1. Vendimi për Inicim të procedurës për Hartimin e PZHK-së



Në bazë të nenit 12, nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), Nenit 40 shkronja (l) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 5, nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1 dhe nenet 10, 11, 15, të Ligjit Nr.04/L-174, për planifikim hapësinor "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013" dhe Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 datës 11.11.2015, nenit 28 paragrafi 2, shkronja (f) dhe 29, paragrafi 2, shkronja (d), të Statutit të Komunës së Suharekës, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 31.01.2017, merr këtë:

V E N D I M

Për iniciimin e procedurës për hartimin e planit zhvillimor Komunal

Neni 1

Me këtë vendim inicohet procedura e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) për Komunën e Suharekës.

Neni 2

Me këtë vendim përkufizohet Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) në afat të vlefshmërisë për periudhën 2017-2025.

Neni 3

Me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, nga neni 1 i këtij Vendimi planifikohet zhvillimi hapësinor në kontest të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të komunës së Suharekës me qëllim të mbulimit të tërë territorit të Komunës së Suharekës me Plan Zhvillimor Komunal.

Neni 4

Ky plan mbulon tërë territorin e Komunës së Suharekës dhe bazuar në PZHK-së 01-Nr-5821 datës 05.03.2008, ka territor prej 361 km² ose 36,099.00 ha.

Neni 5

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së), caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis (DUPM).

Neni 6

Mjetet për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, sigurohen nga buxheti i Komunës së Suharekës.

Neni 7

Projekti i PZHK-së para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik, paraqitja e PZHK-së në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.



Neni 8

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK-ja) do të hartohet për periudhën 8 (tetë) vjeçare.

Neni 9

Deri në miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, vlejnë dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal, aktual me numër 01-Nr-5821, i datës 05.03.2008, deri në miratimin e këtij akti të ri.

Neni 10

Dokumenti i Planifikimit (PZHK) sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare të komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe programi për hartimin Planit Zhvillimor Komunal.

Neni 12

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-2022

Më datë 01.02.2022



Kryetari i Kuvendit

Refik GEGA



Shtojca 1.2. Vendimi për pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Nr. Dreg. Dreg. Nr. Dreg. Nr.	01-M 5764-1/18 17.12.18
Nr. Dreg. Dreg. Nr. Dreg. Nr.	17.12.18 17.12.18 17.12.18

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentit Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	19.10. 2018
REFERENC-Ë:	18/5764/1-720/DMMU
PËR/ZA/TO:	Drejtorinë Urbanizmit dhe Planifikimit - Komuna e Suharekës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Matoshi, Minister i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka pranuar dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës, të dërguar nga ana e Juaj sipas kërkesës së protokolluar me nr.: 18/5764/1-720/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Përmantëni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 28.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 dhe dhe LPPA-së (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Drejtorisë të Mjedisit dhe Urbanizmit - Komuna e Suharekës për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës.

Mënyra e operimit është e përshkruar në vijim (Arsyetim) dhe është e obligueshme për palën.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, dokumentacionin dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës, kopjen e njoftimit për diskutim publik, kopjen e proces verbalit dhe listen e pjesëmarrësve në debat publik, komentet e qytetarëve si dhe grupeve të interesit lidhur me këtë dokument të dorëzuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit - Komuna e Suharekës, për Pëlqim Mjedisor

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: +381 38-200-32-307
<http://www.ks-gov.net/mmph> E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net





për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës, vlerëson që:

Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit - Komuna e Suharekës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep Pëlqimi Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës dhe njëherit të respektohen kriteret mjedisore dhe masat për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit të parapara në Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Planin Zhvillimor Komunal.

Në qoftë se, vie deri te ndryshimi i Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Suharekës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit - Komuna e Suharekës, duhet të hartoj Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe të aplikoj në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e të të njejt.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/5764/1 -ZSP/120/18 datë:19.10.2018

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VSM
3. Inspektoratit
4. Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm
5. Arkivit të MMPH-së
6. Kabinetit të Ministrit
7. Kuvendit të Kosovës





Shtojca 1.3. Vendimi i Kuvendit të Komunës për miratim dhe zbatimin e PZhK-së

DRAFT



Shtojca 1.4. Vendimi i miratimit të PZHK-së nga MIA

DRAFT



Shtojca 2. Shtojca Hartografike (Lista e Hartave planifikuese)

- 1.00. Harta e Zhvillimit hapësinor të Planifikuar;
- 2.00. Harta e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës;
- 3.01. Harta e Planit të Zhvillimit Ekonomik;
- 3.02. Harta e Planit të Infrastrukturës së Transportit;
- 3.03. Harta e Planit të Transportit Urban dhe Rural;
- 3.04. Harta e Planit të Energjisë Elektrike dhe Termike;
- 3.05. Harta e Planit të Ujësllësit dhe Kanalizimit;
- 3.06. Harta e Planit të Sistemit të Ujitjes dhe të Drenazimit;
- 3.07. Harta e Planit të Telekomunikacionit dhe Instalimeve të Ngjashme;
- 3.08. Harta e Planit të Hapësirave Publike dhe Sociale;
- 3.09. Harta e Planit të Hapësirave Sportive;
- 3.10. Harta e Planit të Hapësirave të Hapura Publike dhe të Gjellbra;
- 3.11. Harta e Planit të Menaxhimit të Varrezave;
- 3.12. Harta e Planit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore;
- 3.13. Harta e Planit për Mbrojtjen nga Rreziqet Natyrore;
- 3.14. Harta e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Riciklim;